

## Përmbledhje ekzekutive

*Sekcioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor (SMSL) dhe Shtylla e III e UNMIK-ut (Oganizata për Siguri dhe Bashëpunim në Evropë-OSBE) ka lëshuar një raport të shqyrtimit gjashtëmuor të sistemit juridik në Kosovë. Raporti mbulon peridhën prej 1 Shkurtit 2000 gjer më 31 Korrik 2000. SMSL ka monitoruar shtatëdhjetë e shtatë nga njëqind e gjashtëmbëdhjetë gjykimet e përfunduara në Gjykatat e Qarkut përmbrenda atyre datave (66%). Nga gjykimet e përfunduara në këtë periodë, njëqind e katërdhjetë të pandehur ishin dënuar dhe njëzetë e nëntë ishin liruar (83% të dënuar). Ky raport gjithashtu bënë referenca në një numër gjykimesh të cilat nuk ishin të përfunduara gjer më 31 Korrik 2000.*

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u) është mveshur më të gjitha fuqitë ekzekutive dhe legjislative, të cilat janë të ushtruara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP). UNMIK-u ka mandatin të administrojë sistemin e drejtësisë në Kosovë, dhe Departamenti Administrativ i Drejtësisë është përgjegjës për mbarëvajtjen e administrimit të sistemit gjyqësor dhe shërbimeve korrektuese. OSBE, si pjesë e UNMIK-ut ndan përgjegjësinë e dhënë nga Kombet e Bashkuara (KB) Këshilli i Sigurimit “për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe brengosjet e promovimit të jenë të adresuara përgjatë aktiviteteve të gjithëmbarshme të misionit.”

Ky raport publik siguron një shqyrtim të gjithëanshëm të sistemit të së drejtës nga perspektiva e ligjit të të drejtave të njeriut. Qëllimi i këtij raporti, në pajtim me *Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB 1244* dhe theksimet nga letra e e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të 12 Korrikut 1999 Këshillit të Sigurimit të KB, është të ndihmoj UNMIK-un të “zhvilloi mekanizmat që policia, gjykatat, tribunalet administrative dhe strukturat tjera gjyqësore (të operojnë) në pajtim me standardet ndërkombëtare të së drejtës penale dhe të drejtave të njeriut.”

Edhe pse standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut formojnë një pjesë të ligjit të aplikueshëm, ende ekziston konfuzion lidhur me aplikimin e tyre nga komuniteti ligjor i Kosovës. Për shembull, ekzistojnë shkelje të gjithëpërhapura të ligjit të aplikueshëm në teritorin e Kosovës, në relacion me arrestimin dhe paraburgimin. Individët e arrestuar janë mbajtur në paraburgim nga organet zbatuese të ligjit për periudha të zgjatura kohore para se të jenë dërguar para autoriteteve gjyqësore dhe të shumtën nuk janë informuar për të drejtat e tyre. Në fakt, disa persona janë mbajtur në paraburgim të vazhdueshëm përkundër urdhëresës së ligjshme për lirim nga autoritetet gjyqësore.

Janë modele të përbashkëta dhe praktika të keqaplikimit të ligjit vendor që shpesh rezulton në shkelje të të drejtave të njeriut. Këto modele, dhe praktika janë identifikuar në sistemin juridik në Kosovë, si tërësi. Për shembull, urdhëresat për paraburgim, rrallëherë sigurojnë fakte specifike përkitazi me rastet e individëve që kërkojnë privimin e lirisë para se individit të jetë shpallur fajtor për krimin. Mbrojtësit juridik dështojnë të përdorin dispozitat e ligjit vendor të cilat sigurojnë një mbrojtje aktive, duke i lënë shumë të pandehur pa përfaqësim efektiv.

Përmëtepër, ekzistojnë dispozita në ligjin vendor dhe Rregulloret e UNMIK-ut të cilat, vetvetiu, mund të jenë në konflikt me standardet e të drejtave të njeriut. Sipas ligjit vendor, nga gjykatat nuk kërkohet të sigurojnë që procesverbali gjyqësor saktësisht të tregoj procedurën ligjore. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/26, për vazhdimin e paraburgimit, sikurse edhe ligji vendor, dështojnë të sigurojnë rishqyrtimin e ligjshmërisë së paraburgimit.

Klima e gjatë dhe e vazhdueshme e konfliktit etnik ka influencuar shumë mbi paanshmërinë objektive të gjykatave, dhe ka shtruar brengosje përkitazi me anshmërinë aktuale në një pjesë të kolegjeve gjyqësore. Një përgjegje në këtë, ka qenë emërimi i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar për të punuar posaqërisht në këto gjykime serioze penale të cilat ndërlidhin të pandehurit nga grupet e minoriteteve. Kjo iniciativë duhet të përkrahet dhe duhet të vazhdoj, edhepse, në dritë të sistemit votues të shumicës në kolegje, ndikimi i gjykatësit ndërkombëtar gjatë votimit është i kufizuar. Problem tjetër është numri i pamjaftueshëm i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar, për të cilin shkak ky personel ndërkombëtar gjer tani nuk ka vepruar në të gjitha rastet e natyrës së ngjashme, posaqërisht në ato që lidhen me krime lufte dhe ato etnikisht të motivuara. Kjo ka rezultuar në trajtimin e jobarabartë të të pandehurve të caktuar para gjykatës dhe mohimin e lehtësirave themelore me të cilat në mënyrë adekuate përgatitet dhe prezentohet mbrojtja. Emërimi i mëtejshëm i gjykatësve ndërkombëtar dhe i prokurorëve duhet të trajtohet si prioritet afat-shkurtë.

Si plotësim brengosjeve si ato të minoriteteve, ekzistojnë edhe të tjera, përfshirë të miturit dhe viktimat e dhunës seksuale, përbrenda sistemit juridik penal i cili kërkon mbrojtje të shtuar. Disa të mitur ishin subjekt të periudhave të zgjatura të paraburgimit, pasi që nuk ka patur alternativa për vendosjen e tyre. Në rastet e dhunës seksuale, është dështuar nga disa gjykata që në mënyrë adekuate të ndjekin këto vepra. Si plotësim, në disa raste trajtimi i viktimës nga gjykatat shtrojnë brengosje për diskriminim.

Më 18 Janar 2000, në Gjykatën e qarkut në Gjilan, 36 gjykatësia dhe 4 prokurorë kishin dhënë betimin. Për gjashtë javët e ardhshme, ceremonitë e ngjashme ishin mbajtur në të katër regjionet tjera dhe kjo shënoi fillimin e sistemit të ri penal në Kosovë. Ishte ky një sistem i drejtësisë penale që filloi nga rastësia, me jo vetëm korniza të reja ligjore, por gjithashtu edhe me pjesëmarrës të rinj. Pjesa më e madhe nga infrastruktura e gjykatave ishte e varfër. Shumica e gjykatave ishte pa nxemje, pa ujë, pa rrymë, karriga, tavolina dhe madje letër.

Por problemi ishte më i madh, se infrastrukturor. Numër i theksueshëm i këtyre gjykatësve dhe prokurorëve, nuk kan punuar si të tillë që nga 1989, dhe në çdo rast, nuk kishin dituri pune përkitazi me ligjet esenciale për të drejtat e njeriut. Koncepti, siq është ai i parimit të “barazisë së armëve” nuk kishte vend në sistemin juridik vendor. Vërtetë, sa i përket mbrojtjes, kontestimi bërë shtetit ishte, në çdo rast historikisht i përcjellur me rrezik.

Që nga Nëntori 1999, kishte një numër i sesioneve trajnuese për gjykatësit dhe prokurorët, por disa, dhe sidomos ato të vonshmet, specifikisht për mbrojtësit. Në shtatëdhjetë e shtatë rastet e monitoruara nga SMSL, vetëm në dy raste referenca është bërë në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Më 31 Korrik 2000, gjykatat ende aplikojnë këto dispozita të ligjit vendor që shkelin standardet ndërkombëtare. Profesionit ligjor ka patur trajnim të pamjaftueshëm për ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut me qëllim që të jetë në gjendje të aplikojë në mënyrë të duhur këto ligje në praktikë.

UNMIK-u ka ndërmarrë hapa pozitiv me qëllim të adresimit të shumë qështjeve të identifikuar. UNMIK-u ia arriti që të ndërtoj një sistem gjyqësor funksional nga asgjëja për më pak se një vit. Prezenca e gjykatësit ndërkombëtar dhe prokurorëve ka asistuar në një numër rastesh për të iu shmangur disa brengosjeve të parashtruara më lart. Si plotësim, UNMIK-u, në një numër rastesh, ka siguruar udhërrëfyes për gjykata siq është ligji i aplikueshëm, përfshirë edhe standardet për të drejtat e njeriut, dhe aplikimin e tyre. UNMIK-u gjithashtu zhvillon shërbimet e përkrahjes për përkthime dhe interpretime për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar si dhe zhvillimin e përmbledhjes së terminologjisë ligjore. Përkundër kësaj, në kuptim të korrektesisë dhe efektivitetit, sistemi prezent ka hapësirë për përmirësime të mëtejme.

Statistikat në këtë shqyrtim janë fituar nga shkresat gjyqësore. SMSL, kur ka qenë e mundur, ka vërtetuar informatat përmes burimeve tjera, përfshirë procesverbalet e qendrave të paraburgimit, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre. Ky raport nuk do të ishte i mundur pa asistimin e personelit gjyqësor dhe profesionalistëve ligjor. OSBE dëshiron të shpreh falenderimin punetoreve të gjykatave të cilët, me durim dhe vullnet të mirë, kanë lehtësuar monitorët e SMSL në ushtrimin e detyrave të tyre. OSBE dëshiron ti falenderon komandirët e qendrave të paraburgimit, Policinë e UNMIK-ut, dhe KFOR-in për sigurimin e, përgjithësisht, qasjes së papenguar të paraburgosurve.

## SEKSIONI 1 : MONITORIMI

### **I. Mandati i Sekcionit të Monitorimit të Sistemit Ligjor**

*Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB 1244*, Këshilli i Sigurimit të KB autorizoi Sekretarin e Përgjithshëm të KB për themelimin e prezencës ndërkombëtare civile në Kosovë e cila do të sigurojë një administratë të përkohshme. Njëra nga përgjegjësitë kryesore të prezencës ndërkombëtare ishte “mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut”. (Par. 11 (j))

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në raportin e tij dërguar Këshillit të Sigurimit të datës 12 Korrik 1999, i ka përcaktuar rolin udhëheqës në ndërtimin e institucioneve përbrenda UNMIK-ut, *Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë* (OSBE) dhe ka indikuar, se njëra ndër detyrat e Shtyllës së Ndërtimit Institucional do të përfshijë monitorimin e të drejtave të njeriut.

Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm dërguar Këshillit të Sigurimit, më 12 Korrik 1999 udhëzoi UNMIK-un ‘që të zhvillojë mekanizëm të koordinuar, me qëllim që të mundësojë monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor dhe ka shtuar se duhet të bëhet raportimi në mënyrë të koordinuar në mënyrë që të mundësohet aftësia e përgjegjës. Posaçërisht:

“ UNMIK-u do të ketë bazën e monitorëve të të drejtave të njeriut dhe këshilltarëve të cilët do të kenë *qasje të papenguar* në të gjitha pjesët e Kosovës, për të bërë hetimet lidhur me cënimin e të drejtave të njeriut dhe për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe çështjet e promovimit, të jenë të adresuara përgjatë aktiviteteve të gjithëmbarshme të misionit. Monitorët e të drejtave të njeriut, përmes Zëvendësit të Përfaqësuesit Special për Ndërtimin e Institucioneve, do të raportojnë konstatimet e tyre Përfaqësuesit Special. Konstatimet e monitorëve të të drejtave të njeriut do të bëhen publike në mënyrë të rregullt dhe do të ndahen, siq përket, me mekanizmat e të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara, në konsultim me Zyren e Kombeve të Bashkuara të Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut. UNMIK-u do të sigurojë raportim të koordinuar dhe aftësi përgjegjëse.” (Para.87)

Në Letrën e Marrëveshjes, e datuar më 19 Korrik 1999, në mes të Nën-Sekretarit të Përgjithshëm për Operacionet Paqëruajtëse të Kombeve të Bashkuara dhe Përfaqësuesit të Udhëheqësit të Zyres së OSBE-së, qëndron se, Shtylla për Ndërtimin Institucional- (Shtylla III), OSBE duhet të zhvillojë mekanizmat që sigurojnë, që gjykatat, tribunat administrative dhe strukturat tjera gjyqësore, të veprojnë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të së drejtës penale dhe të drejtave të njeriut. Për më tepër, në pajtim me Rregulloren Nr. 2000/15 ‘Për themelimin e Departamentit Administrativ të Drejtësisë’ të datës 21 Marsit 2000, është arritur marrëveshja në mes të Departamentit Administrativ të Drejtësisë dhe OSBE-së, që OSBE-ja të jetë, organizata përgjegjëse për monitorimin e pavarur të sistemit gjyqësor dhe shërbimit korrektues.

Sidoqoftë, Sekcioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor të OSBE-së (SMSL) ka hasur në pengesa në veprimtarinë monitoruese, posaqërisht nga Departamenti për Punë Juridike KB (DPJ KB) i cili ka këshilluar qendrat e paraburgimit, përfshirë edhe ato të cilat nuk janë nën mbikqyrjen e saj, ti mohojnë SMSL qasjen listave të paraburgimit dhe të të paraburgosurve. Kjo duket të jetë mungesë e mirëkuptimit të Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të KB dhe mandatit të Shtyllës së Ndërtimit Institucional përbrenda DPJ KB. Përpjekjet për të zgjidhur çështjen me DPJ KB gjer më tani kanë dështuar. SMSL gjithashtu i është mohuar qasja dosjeve të gjykatës dhe gjykimeve të të miturve në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Kjo, në mënyrë të theksuar ka ndikuar në mundësitë e SMSL për të monitoruar efektisht rastet në relacion me krime lufte në at regjion, përfshirë edhe gjykimin e të miturit të akuzuar për Gjenocid.<sup>1</sup>

Shtylla për Ndërtimin Institucional i ka propozuar një Memorandum për Mirëkuptim, Shtyllës për Administrimin Civil. Gjer më 1 Shtator 2000, qasja disa të paraburgosurve dhe procesverbaleve të gjykatës ende mohohet.

## **II. Raportet me Shtyllat tjera**

Departamenti Për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e së Drejtës OSBE, pjesë e Shtyllës së Ndërtimit Institucional, vepron në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e KB siq janë OHCHR, UNHCR-i dhe UNICEF-i. Departamenti është lojtari kyq në të dyjat, Forcat e KB për Minoritetet dhe Forcat e UNICEF-it për Të Drejtën e të Miturve. Departamenti gjithashtu bashkëpunon si me organizatat lokale ashtu edhe me ato ndërkombëtare, siq janë Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit Të Kuq (ICRC) dhe Oda e Avokatëve Amerikan dhe Iniciativa Ligjore për Evropën Qendrore dhe Lindore (ABA-CEELI).

Përderisa Divizioni i Sundimit të së Drejtës të atij Departamenti aktivisht e mbështetë Departamentin Administrativ të Drejtësisë, në zhvillimin e gjyqësisë, Divizioni i të Drejtave të Njeriut ka pozitë unike në relacion me Shtyllën për Ndhimën Humanitare (Shtylla I) dhe Administratën Civile (Shtylla II). Edhe pse sipas strukturës, pjesë e UNMIK-ut, mandati i saj kërkon një rol kuazi-të pavarur në monitorimin e sistemit gjyqësor, të administruar nga Shtylla II.

Si pjesë e Shtyllës III, dhe e UNMIK-ut si tërësi, mandati i monitorimit të sistemit ligjor të OSBE-së përfshin raportimin e saktë dhe të menjëhershëm përbrenda Shtyllës III, Shtyllave tjera dhe agjensive tjera qeveritare (p.sh. UNICEF-it) në:

- i. statistikat vijuese në relacion me sistemin e së drejtës penale,
- ii. shkeljet sistematike të ligjit ndërkombëtar, dhe
- iii. shkeljet e rënda të standardeve të gjykimeve korrekte në rastet individuale të cilat duhet menjëherë të sanohen.

Përshtatshmerisht, SMSL në Seli, mirëmban marrëdhënjet konsistente dhe të bashkëpunimit me Shtyllat tjera dhe agjensitë ndërkombëtare.<sup>2</sup> Ai pranon kërkesat ditore

në relacion me gjendjen e sistemit të së drejtës penale, sikurse është statusi i rasteve në zhvillim, të të miturve në paraburgim para-gjykimin dhe personat e akuzuar. Shkeljet sistematike, trendet e observuara, problemet individuale dhe çështjet e identifikuara nga SMSL janë komunikuar përmes SMSL në seli, te departamentet tjera përbrenda Shtyllës III, Shtyllave tjera të UNMIK-ut, dhe agjensive tjera ndërqeveritare. Shumë nga këto departamente dhe agjensi janë të ngarkuara me përgjegjësin për gjetjen e zgjidhjeve konkrete dhe për sanimin e këtyre problemeve kritike (P.sh. nevojat e përkrahjes gjyqësore, çështjet e sigurisë, mosudhëheqjen gjyqësore dhe trajnimin e, *inter alia*, profesionalistëve ligjor).

### **III. E Drejta për Gjykim të Drejtë**

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë pjesë e ligjit të aplikueshëm përmes, *inter alia*, *Rregullores 1999/24*, e cila obligon personat që ushtrojnë shërbime publike në Kosovë, të mbështesin standardet e pranuar ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Si plotësim, SMSL shënon se Republika Federale e Jugosllavisë është nënshkruese e instrumenteve të shumta ndërkombëtare, përfshirë edhe *Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike* (MNDCP), e cila, si kthesë, obligon çdo entitet qeverisës në teritor që t'iu sigurojë njerëzve të Kosovës këto të drejta.

SMSL analizon ligjin vendor dhe praktikën për pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për korrektësinë në procedurën penale. Standardet ndërkombëtare janë të detajizuara, *inter alia*, në Nenin 9, 10, 14 të MNDCP dhe Nenin 5, 6 të *Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut* dhe standardet tjera jo-kontraktuese të KB. Ligji vendor, parësisht, *Ligji mbi Procedurën Penale të RFJ dhe Ligji Penal i Kosovës*, formojnë bazën për çdo analizë të SMSL. Analizat e 'Gjykimin të drejtë' sipas Ligjit Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut fillon prej momentit kur personi arrestohet dhe paraburgoset nga autoritetet e gjer në vendimin final për rastin.

SMSL monitorojnë rastet që zhvillohen përmes sistemit të së drejtës penale, prej momentit të arrestit dhe paraburgimit gjer në gjykim dhe ankesë. SMSL monitorojnë rastet e krimeve serioze, në kompetencën e Gjykatës së Qarkut, të cilat janë, parësisht, të shenjuara nga SMSL, si raste prioritare. Disa raste në Gjykatën Komunale mund të monitorohen nëse ato kyqin çështje prioritare, siq janë rastet që kanë të bëjnë me minoritetet, të miturit, femrat, etj.

Para se të pjesëmarrin në procedurën formale gjyqësore, dhe kur paraqitet praktike, monitorët e SMSL hulumtojnë rastin, që të sigurojnë se ata janë në gjendje që të adresojnë të gjitha çështjet përkitazi me të drejtat para-gjykimin. Këto hetime formojnë bazën për analizat e monitorëve të SMSL për procedurën gjyqësore. Monitorët e SMSL mbledhin këto informata nga shqyrtimi i dosjes, nëse ka qasje gjer tek ajo, dhe nga intervistat me të dyshimtin/të paraburgosurin, policinë/KFOR-in, mbrojtësin, prokurorin, gjykatësin hetues, dhe të tjerët. Monitorët e SMSL marrin pjesë në gjykime, dhe raportojnë me shpejtësi për parregullësitë procedurale dhe praktikën në procedurën para-gjykimin dhe gjykimin, në dritë të standardeve ndërkombëtare dhe vendore.

#### **IV. Rastet Prioritare**

Kjo si vijon, është një udhërrëfyes në prioritetet e SMSL gjatë gjashtë muajve të kaluar. Çështjet, përkitazi me qasjen dhe efektivitetin e mbrojtësit si dhe mosadministrimi i prokurorisë dhe ai gjyqësor janë të mbuluara në kontekst të rastit të monitoruar. Kjo është, natyrisht, një proces në vazhdimësi, pasi që SMSL përgjigjet në çështjet që ngritën mvarësisht nga zhvillimi i sistemit ligjor:

- i. Krimet e Luftës,
- ii. Krimet Etnikisht të Motivuar,
- iii. Trajtimi i të Miturve
- iv. Viktimat e Dhunes Seksuale
- v. Paraburgimi

SMSL monitoron mundësitë e paraburgimit kur janë në relacion me qështjen e “qasjes drejtësisë” SMSL nuk monitoron kushtet e paraburgimit apo keq-trajtimin pasi që ato janë të mbuluara nga zyrtarët e OSBE-së për të drejtat e njeriut dhe *Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq*.

#### **V. Mbledhja e të dhënave**

Në Shkurt 2000, Selia e SMSL zhvilloi sistemin e rast-tabelës në të cilën shënohen të gjitha rastet e aktakuzave në Gjykatën e Qarkut. Ky sistem ofron të gjitha thyerjet e rastit të të akuzuarit, dhe përfshin detajet vijuese; vepra për të cilën akuzohet, data e kryerjes së veprës, data e paraburgimit, data e ngritjes së aktakuzës, numri i dosjes gjyqësore-prokurorisë, etniciteti i të akuzuarit dhe viktimës, dhe emri i mbrojtësit. SMSL krijoi një sistem të posaqëm rast-tabelor, për monitorimin e krimeve të luftës dhe krimeve etnikisht të motivuara. Ky sistem shënon rastet e personave të akuzuar për vepra të këtilla.

Në bazë javore, monitorët sigurojnë SMSL në Seli me, siq vijon:

- Listën e personave në paraburgim,
- Orarin e gjykimeve
- Listën e personave të akuzuar, dhe
- Situatën më të re të të gjitha aktgjykimeve, dënimeve dhe ankesave të rasteve nga Gjykata e Qarkut.

SMSL, i siguron me shënime më të reja të rasteve dhe statusin e përgjithshëm të sistemit të së drejtës penale, departamentet tjera të Shtyllës III, sikurse edhe Shtyllën II, dhe agjensitë e interesuara, p.sh. për numrin e personave të paraburgosur, për numrin e të miturve të paraburgosur, numrin e aktakuzave për regjion, datat e gjykimeve, dhe thyerjen e rasteve dhe aktgjykimeve.

## VI. Raportimi i Monitorimit Të Sistemit Ligjor

Gjatë gjashtë muajve të kaluar, SMSL ka dhënë gjashtë raporte tematikore që adresojnë shkeljet sistematike të standardeve ndërkombëtare të drejtave të njeriut.<sup>3</sup> Këto raporte në mënyrë kritike kanë vlerësuar ligjet substanciale vendore dhe praktikën në teren dhe i kanë bërë një numër rekomandimesh PSSP. Përshtatshëm, SMSL gjithashtu ka dhënë raporte rastesh të individuale, duke ndriçuar rastet që burojnë nga veprimtaria gjyqësore apo e ndonjë autoriteti tjetër.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Gjykata arsyetohej se qasja duhet të mohohet pasi që Ligji mbi Procedurën Penale i RFJ, nuk i referohet OSBE-së.

<sup>2</sup> P.sh. OHCHR, UNHCR, UNHCHR, UNICEF, dhe KKKN.

<sup>3</sup> Shiko Raporti i SMSL #3, *Skadimi i periodës së paraburgimit për të Paraburgosurit e Tanishëm (8 Mars 2000)*; Raporti i SMSL #4, *Risitë përkitazi me Skadimin e Periodës së Paraburgimit për Të Paraburgosurit (18 Mars 2000)*; Raporti i SMSL #5, *Trajtimi i Minoriteteve nga Sistemi Gjyqësor (9 Maj 2000)*; Raporti i SMSL #6 *Joligjshmëria e Rregullores 1999/26 (29 Prill 2000)*; Raporti #7, *Qasja mbrojtësit efektiv: Arrestimi në Dëgjimin e parë në paraburgim (23 Maj 2000)*; Raporti i SMSL #8, *Qasja Mbrojtësit Efektiv: Dëgjimi në Hetuesi gjer në aktakuzë (20 Korrik 2000)*.

<sup>4</sup> Shiko Raportin e SMSL përkitazi me *Peter Muriuki (22 Qershor 2000)*, *Moses Omweno (14 Korrik 2000)* *Momqilloviqët (16 Gusht 2000)* dhe *Afrim Zeqiri (25 Gusht 2000)*.



**Lëndët e përfunduara në Gjykatat e Qarkut (1 Shkurt 2000 - 31 Korrik 2000)**

	<b>Gjykimet</b>	<b>Të monitoruara</b>	<b>Fajtor</b>	<b>Të pafajshëm</b>	<b>Aktakuzat e hudhura poshtë</b>	<b>Etniciteti</b>
<b>Prishtine</b> 44 të pandehur	26	18	28	10	6 persona	<b>Pand:</b> të gjithë k/sh, përveq 1 k/s (tent.vrasje) 1 k/m (drogë); <b>Viktimat:</b> të gjithë k/sh, Përveq 1 k/s (viktimë e vrasjes), 1 k/r (viktimë e dhunimit), 1 ndërkombëtar
<b>Gjilan</b> 37 të pandehur	30	28*	28	9	Asnjë	<b>Pand:</b> të gjithë k/sh, përveq 4 k/s, 1 k/r; <b>Viktimat:</b> të gjithë k/sh përveq 2 k/s & 1 ndërkombëtar
<b>Prizren</b> 48 të pandehur	33	17	35	2	11 persona	<b>Pand:</b> të gjithë k/sh, përveq 2 Shqiptarë.Kombëtar, 2 k/t; <b>Viktimat:</b> të gjithë k/sh, përveq 2 k/t
<b>Peje</b> 33 të pandehur	21	13	26	7	Asnjë	<b>Pand:</b> të gjithë k/sh përveq 5 Shqip.Kombëtar, 1 k/r; <b>Viktimat:</b> të gjithë k/sh përveq 3 k/r, 1 ndërkombëtar
<b>Mitrovice</b> 7 të pandehur	6	1	6	1	Asnjë	<b>Të gjithë të pandehurit/viktimat k/sh</b>

**PR:** Vrasje: 10 të dënuar, 5 të liruar( viktimat k/s), 4 aktakuza të hudhura poshtë;**Tent. vrasje:** 5 të dënuar, 2 aktakuza të hudhura poshtë; **Dhunimi** (përfshirë dhunimin e rëndë dhe tentim dhunimin): 2 fajtor, 1lirim;**Veprat me drogë:** 4 dënime; **Plaqkitja/Vjedhja /Të tjera:** 7dënime, 4 lirime.

**GJ:**Vrasje: 5 dënime, 1lirim;**Tent.vrasje:** 2 dënime, 1lirim ;**Dhunime:** 3 dënime, 5 lirime;**Vjedhje:** 5 dënime;**Armët:** 5 dënime; Tjera (**vep.më pak seroize**): 8 dënime, 2 lirime.  
Ky numër përfshin gjykimet që nuk kanë përfunduar para 31 Korrikut 2000.

**PZ:**Vrasje: 3 dënime;**Tent.vrasje:** 3 dënime, 1aktakuzë e hudhur poshtë;**Lëndime të rënda trupore:** 1dënim; **dhunim:** 3dënime, 1lirim; **Plaqkitje/Vjedhje:** 8dënime, 1lirim , 1aktakuzë e hudhur; **Armët:** 3dënime, 1aktakuzë e hudhur; **Tjerat(veprat më pak serioze):** 12dënime, 1aktakuzë e hudhur.Vërejtje:një person është dënuar për plaqkitje dhe dhunim të rëndë.

**PE:** Vrasje: 3dënime, 1lirim;**Tent.vrasje:** 5dënime, 5lirime;**Dhunim:** 2 dënime; **Plaqkitje/Tent.plaqkitje:** 8dënime; **Armët:** 5dënime;**Droga:** 2dënime;**Mundësim ikje:** 2dënime, 1lirim. Vërejtje: një person është dënuar për tent.vrasje dhe plaqkitje.

**MI:**Vrasje: 2dënime, 1 lirim;**Tent.vrasje:** 2 dënime;**Sulm:** 1dënim;**Armët:** 1dënim.

## **A. Mesatarja e Dënimeve:**

- i. Vrasja:**  
**PR:** 10 vite 3 muaj; **PZ:** 10 vite. 3 muaj; **Gj:** 11 vite.; **MI:** 10 vite. 6 muaj; **PE:** 8 vite.
- ii. Dhunimet:**  
**PR:** 2 vite. 3 muaj; **PZ:** 2 vite. 1 muaj **Gj:** 5 vite 5 muaj **PE:** 6 vite. 5 muaj
- iii. Plaqkitja:**  
**PR:** 1 vit.; **PZ:** 1 vit. 6 muaj; **PE:** 2 vite. 6 muaj
- iv. Posedim armësh:**  
**PR:** Të gjithë të liruar; **PZ:** 5 muaj; **Gj:** 8.4 muaj; **MI:** 3 muaj; **PE:** 1.8 muaj

## **B. Gjykata Supreme e Kosovës**

- i. Ankesat e paraqitura \***  
29 Ankesa të paraqitura: 22 të refuzuara- 7 të aprovuara
- ii. Propozime për vazhdim paraburgimi**  
71 të parashtruara  
71 të aprovuara
- iii. Kërkesë për përjashtim të gjykatësve**  
3 të parashtruara  
3 të refuzuara

\*GJSK nuk ka mundur të siguroj se ankesat a janë parashtruar nga avokatët apo prokurori

## **C. Statistikat tjera**

- i. Për këtë raport SMSL intervistoi 196 të paraburgosur;
- ii. SMSL monitoroi 77 nga 116 Gjykime të përfunduara në Gjykatat e Qarkut (66%);
- iii. 116 gjykime kyqnin 169 të pandehur;
- iv. 140 të pandehur ishin dënuar (83 % të dënuar);
- v. 29 të pandehur ishin të liruar;
- vi. Minoritetet: 9 të pandehur: 4 Serb Kosovar, 2 Rom Kosovar, 2 Turq Kosovar, 1 Musliman Kosovar (të gjithë ishin dënuar) (shumica e viktimave ishin Shqiptarë Kosovare); 9 Viktima: 3 Serb Kosovar, 4 Rom Kosovar, 2 Turq Kosovar (shumica e të pandehurve ishin Shqiptarë Kosovare)

## **SEKSIONI 2: SFONDI**

Dekadat e sundimit komunist, dhjetë vitet e represionit aktiv dhe intervenimi i NATO-s, kanë ndikuar jofavorshëm në Gjyqësinë e Kosovës. Në kohën kur UNMIK-u është themeluar dhe pozicionuar në Kosovë, nuk funksiononte sistemi gjyqësor. Shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve që vepronin para fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s, janë larguar përderisa të mbeturit në të shumtën e rasteve janë denoncuar për shkak se kanë shërbyer nën regjimin represiv të Beogradit.<sup>1</sup>

Pasi që Millosheviqi pranoi kushtet e *Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake*, e cila zyrtarisht i dha fund ndërhyrjes së NATO-s,<sup>2</sup> Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara miratoi *Rezolutën 1244* më 10 qershor 1999. Kjo rezolutë parashikon themelimin e Administrimit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) sipas së cilës njerëzit e Kosovës mund ta gëzojnë “autonominë substanciale dhe vetë-administrimin kuptimplotë” përbrenda Republikës Federale të Jugosllavisë. Përgjegjësitë e autoriteteve civile ndërkombëtare përfshijnë kryerjen e “funsioneve civile administrative ku dhe aq sa duhet.”

Në kohën pas “K-ditës,”<sup>3</sup> komuniteti ndërkombëtar bëri përpjekje të shumta për themelimin dhe vënien në veprim të gjyqësisë multi-etnike. Por, pas themelimit të Sistemit Emergjent Gjyqësor (SEGJ), në procesin që çonte te emërimi në gjykatat e rregullta u shfaqën vështirësi në të bindurit e anëtarëve të minoriteteve për të marrë pjesë apo për të mbetur në sistem. Lidhur me trashëgiminë e diskriminimit dhe dhunës, fushata e re e dhunës dhe e ndjekjes dhe e cenimit të të drejtave të njeriut ndaj minoriteteve dobësoi shumë mundësitë e UNMIK-ut për të themeluar një sistem gjyqësor që do të ofronte një garanci të kënaqshme të paanshmërisë për të gjithë Kosovarët.

### **I. Sistemi Emergjent Gjyqësor**

Më 28 qershor 1999, PSSP lëshoi një dekret emergjent duke themeluar *Këshillin e Përbashkët Këshilldhënës mbi Emërimet e Përkohshme Gjyqësore* (KPK). Mandati kryesor i KPK-së përmban rekomandimin për emërimin e përkohshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve në një Sistem Emergjent Gjyqësor (SEGJ) në Kosovë për një afat tre-mujor përsëritës. Propozimi primar i SEGJ-së ishte që të zhvillohen dëgjimet e para-gjyqësorit të pandehurve të paraburgosur pas arrestimit të tyre nga KFOR-i. Sipas sugjerimeve të KPK-së, midis qershorit 1999 dhe shtatorit 1999, PSSP ka emëruar gjithsej pesëdhjetë e pesë gjyqtarë dhe prokurorë publikë. Përbërja etnike ishte me sa vijon: 42 shqiptarë të Kosovës, 7 serbë të Kosovës, 4 myslimanë të Kosovës, 1 turk i Kosovës dhe 1 rom i Kosovës.

Gjykatat e përkohshme të qarkut dhe zyret e prokurorëve janë vendosur në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë dhe Pejë. Njësitë Lëvizëse vepronin jashtë Gjykatës së Qarkut të Prishtinës dhe mbulonin ato rajone që nuk kishin shërbimin e gjykatave të tjera.

Në korrik 1999, gjyqtari i parë serb i Kosovës braktisi SEGJ-në dhe shkoi në Serbi. Në shtator 1999, një prokuror serb i Kosovës dha dorëheqje nga posti i tij dhe një tjetër

gjqtar serb i Kosovës iku, pasi që ishte sulmuar, gjoja nga shqiptarët e Kosovës. Në tetor 1999, tre gjyqtarët e mbetur serbë të Kosovës dhe një prokuror publik dhanë dorëheqje. Ata u ankuan se mungesa e sigurisë, zbatimi i ligjit të pamiruar nga gjyqtarët dhe prokurorët shqiptarë të Kosovës, diskriminimi dhe pagesa e pamjaftueshme i motivoi ata për të ikur. Pas këtyre dorëheqjeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë të përmendur, në SEGJ ishin vetëm edhe tre sllavë myslimanë dhe një i përkatësisë turke.<sup>1</sup>

Më 25 korrik 1999, PSSP aprovoi *Rregulloren 1999/1 të UNMIK-ut*, sipas së cilës ligji i aplikueshëm në Kosovë duhet të jetë ligji që ishte në fuqi para intervenimit të NATO-s më 24 mars 1999. Kjo rregullore kërkonte që ligji i aplikueshëm të jetë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut, *Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-ve*, dhe Rregulloreve të tjera të UNMIK-ut.

Anëtarët e shumicës së komuniteteve juridike shqiptare të Kosovës u shqetësuan dhe kundërshtuan ligjin e aplikueshëm të fuqizuar nga UNMIK-u; përkatësisht ligjet “serbe” të regjimit represiv të Millosheviqit deri në intervenimin e NATO-s. Gjyqtarët dhe prokurorët vullnetarisht aplikuan procedurën penale të *Ligjit Penal të RFJ-së* dhe kur mund të zbatohet, *Ligjin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Ligji Penal i RSFJ-së)*, meqë të dy ligjet ishin në fuqi para se t’i hiqet Kosovës statusi i krahinës autonome nga autoritetet e Beogradit më 22 mars 1989. Mirëpo, shumë gjyqtarë dhe prokurorë shqiptarë nuk përfillën *Rregulloren 1999/1* dhe në vend të saj zbatuan *Ligjin Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (Ligji Penal i Kosovës)*, i cili është anuluar dhe zëvendësuar me *Ligjin Penal të Republikës Jugosllave Socialiste të Serbisë (Ligji Penal i Serbisë)* kur Kosova u bë pjesë e Republikës së Serbisë në vitin 1989-90. Megjithëse Ligji Penal i Kosovës dhe Ligji Penal i Serbisë janë të ngjashëm në shumë pikëpamje, zbatimi i ligjit të pamiruar zgjoi shqetësim të rëndë lidhur me ligjshmërinë e procedurës.<sup>4</sup>

Mungesa e burimeve materiale, qoftë pajisjeve të zyrës, orendive apo mjeteve të tjera themelore, gjithashtu i kontribuan kësaj krize. Paga e ulët dhe vonesat e pagesës së gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë, prokurorëve publikë, mbrojtësve të emëruar nga gjykata dhe nëpunësve të gjykatës ishte edhe një vështirësi më tepër. Nëpunësit e gjykatës së Prishtinës mbajtën grevë dy-ditëshe në tetor 1999 për atë që ata e konsideronin si pagë të pamjaftueshme që u ipej gjyqtarëve (300DM).

Në dhjetor 1999 PSSP nxorri *Rregulloren 1999/24*, e cila anuloi *Rregulloren 1999/1* dhe rivendosi ligjet e aplikueshme në periudhën e *Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës*. Përkundër këtij sfondi, SEGJ-ja përfundoi punën, u emëruan dhe dhanë betimin gjyqtarë dhe prokurorë të ri në sistemin e rregullt të ri gjyqësor prej janarit 2000 e më tutje.

## **II. Krijimi i Sistemit të Rregullt Gjyqësor**

Në bazë të *Rregullores së UNMIK-ut 1999/7* të 7 shtatorit 1999 u formua *Komisioni Këshilldhënës Gjyqësor (KKGJ)* me mandat të rekomandimit të kandidatëve për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve afatgjatë. KKGJ-ja ishte poashtu e autorizuar për referimin e masave disiplinore, duke përfshirë largimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve

publikë. Përderisa KPK ndërpreu aktivitetet e tij më 10 shtator, KKGJ-ja filloi të vepronte më 27 tetor 1999.

KKGJ-ja publikoi pozitat gjyqësore në tërë Kosovën. Duke filluar nga nëntori 1999, KKGJ-ja pranoi më shumë se 700 kërkesa dhe zhvilloi afro 560 intervista individuale. Përkundër përpjekjeve të UNMIK-ut për të gjetur dhe rekrutuar minoritetet në sistemin ligjor, vetëm disa prej tyre parashtruan kërkesë për dy shkaqe: siguria nuk mund tu garantohej dhe e dyta, Beogradi i kishte instruktuar gjykatësat Serb që të mos pjesëmarrin.

Gjatë seancave të tij më 11 dhe 12 dhjetor, KKGJ selektoi 301 gjyqtarë profesionalë, prokurorë publikë dhe gjyqtarë porotë. Rekomandimet iu dërguan PSSP-së më 13 dhjetor 1999. Emërimi përfshinte njëmbëdhjetë serbë të Kosovës, pesë sllavë myslimanë, tetë romë dhe gjashtë turqë, të cilët (të gjithë) u emëruan si gjyqtarë porotë. Ceremonitë e para të betimit u mbajtën në janar 2000, por një numër i vogël i gjyqtarëve të emëruar nga minoritetet mori pjesë në ceremoni. Edhe pse 301 gjyqtarë dhe prokurorë publikë janë emëruar, vetëm 245 gjyqtarë dhe 42 prokurorë publikë kanë dhënë betimin. Nga gjyqtarët profesionalë që kanë dhënë betimin, vetëm tetë ishin të përkatësisë së minoriteteve, përfshirë këtu dy serbë të Kosovës.<sup>5</sup> Në mesin e gjyqtarëve porotë vetëm 13 ishin nga minoritetet, asnjë serb i Kosovës. Nga prokurorët publikë, vetëm dy ishin të përkatësisë së minoriteteve të Kosovës.<sup>6</sup> Trembëdhjetë gjyqtarë dhanë dorëheqje dhe katër nuk filluan punën fare. Poashtu një prokuror dha dorëheqje. Kështuqë, më 31 korrik 2000, kishte 230 gjyqtarë, 235 gjyqtarë porotë dhe 41 prokurorë publikë.

Në gusht 2000, PSSP emëroi 125 gjyqtarë të tjerë, 309 gjyqtarë porotë dhe 17 prokurorë publikë. Ndërsa, më 1 shtator 2000 nuk ka të dhëna për përbërjen etnike.

Në Shkurt 2000, një gjykatës ndërkombëtar dhe një prokuror u emëruan në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. *Regullorja e UNMIK-ut 2000/34* ka shtrirë fuqinë për emërimin e gjykatësve ndërkombëtar dhe prokurorëve në gjykatat në tërë Kosovën. Me 1 Shtator 2000, ishin gjashtë gjykatës ndërkombëtar dhe dy prokuror ndërkombëtar.

### III. Gjykatat

Secili nga pesë rajonet e Kosovës ka nga një Gjykatë të Qarkut. Gjykata e Qarkut është kompetente për të gjykuar rastet penale të cilat bartin dënimin prej më tepër se pesë vjet burgim. Gjykata komunale është kompetente për të gjykuar rastet penale të cilat bartin dënimin deri në pesë vjet burgim. Në Kosovë aktualisht veprojnë shtatëmbëdhjetë gjykata komunale. Gjykata për kundërvajtje është kompetente për të gjykuar rastet penale të cilat bartin dënimin deri në dy muaj burgim. Në Kosovë veprojnë aktualisht nëntëmbëdhjetë gjykata për kundërvajtje. Gjyqi Suprem i Kosovës përfaqëson gjykatën më të lartë apeluese në Kosovë.

---

<sup>1</sup> SMSL Raporti nr.2: Zhvillimi i Sistemit Gjyqësor Kosovar (10 Qershor deri më 15 Dhjetor 1999), Vrojtimit dhe Rekomandimet e OSBE Misioni në Kosovë, Sekcioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor, 17 Dhjetor 1999 ( në [www.osce.org](http://www.osce.org)).

---

<sup>2</sup> Marëveshja Ushtarake Teknike në mes të Forcave Ndërkombëtare të Sigurimit(KFOR) DHE Qeverisë së Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë, 9 Qershor 1999.

<sup>3</sup>Përgjithësisht, periudha prej 12 Qershorit 1999 kur KFOR-i hyri në Kosovë.

<sup>4</sup> *Id.* Fq.3. Deri më 15 dhjetor 1999, janë zhvilluar mbi njëqind dëgjime të paraburgimit para-gjyqimit. 35 gjykime penale janë përfunduar, dhe të gjitha janë zhvilluar ose sipas Ligjit Penal të Kosovës ose sipas Ligjit Penal të RFJ-së, e asnjë sipas Ligjit “të aplikueshëm” Penal të Serbisë.

<sup>5</sup> Gjykatësat Serb të Kosovës ishin betuar në Gjykatën Komunale në Kamenicë. Me 1 Shtator 2000, për siq thanë, shkaqe sigurie, kan refuzuar të punojnë.

<sup>6</sup> *UNHCR/OSBE Vlerësimi i Situatës së Minoriteteve në Kosovë* (Periudha që mbulon Nëntorin 1999 gjer në Janar 2000), f.6.

### **SEKSIONI 3: LIGJI I APLIKUESHËM**

Problemi kryesor në sistemin e gjyqësisë penale të Kosovës vazhdon të jetë mungesa e qartësisë në ligjin e aplikueshëm, posaçërisht në aplikueshmërinë e tij.

#### **I. Bazat e Ligjit të Aplikueshëm**

Baza aktuale e ligjit është *Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB-ve* siç thuhet në *Rregulloren 1999/24 të UNMIK-ut*. Ajo pohon se ligj i aplikueshëm janë rregulloret e lëshuara nga PSSP, dhe ligji në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989 (me përparësi të Rregulloreve në raste konflikti). Pos kësaj, Rregullorja thotë se:

“2. Nëse gjykata kompetente apo një organ a person që kërkohet të zbatojë dispozitë të ligjit, konstaton se çështja e subjektit apo situata nuk përfshihet nga ligjet e vendosura në seksionin 1 të kësaj rregulloreje, por përfshihet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989 i cili nuk është diskriminues dhe i cili përputhet me seksionin 3 të rregullores në fjalë, gjykata, organi apo personi duhet, si përjashtim, ta zbatojë atë ligj.

3. Në ushtrimin e detyrave të tyre, të gjithë personat që marrin përsipër detyra publike apo që mbajnë zyre publike në Kosovë duhet t’i kenë parasysh standardet ndërkombëtarisht të njohura të të drejtave të njeriut, të reflektuara posaçërisht në:

Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të 4 nëntorit 1950 si dhe protokolet;

4. Asnjë person që merr përsipër detyra publike apo mban zyre publike në Kosovë nuk duhet të bëjë diskriminime ndaj asnjë personi për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, religjionit, mendimit politik apo tjetër, prejardhjes natyrale, etnike apo sociale, bashkëpunimit me komunitetin kombëtar, pasurisë, statusit të lindjes apo tjetër. Në procedurën penale, i pandehuri duhet të përfitojë nga dispozitat më të favorshme të ligjeve penale që ishin në fuqi në Kosovë midis 22 marsit 1989 dhe datës së rregullores në fjalë.”

Në një letër dërguar Kryetarit të Odës së Avokatëve të Beogradit, datuar më 14 qershor 2000, PSSP vërtetoi se Seksioni 3 i Rregullores 1999/24 u përket gjyqtarëve dhe se kjo do të thotë se ata duhet të mos zbatojnë çdo dispozitë të ligjit vendas që nuk përputhet me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Burimet e shumta të ligjit në Kosovë të krijuara nga UNMIK-u do të thonë se në gjyqësi te avokatët vazhdon të ekzistojë konfuzion i kuptueshëm për atë se cili ligj të zbatohet në rastet e veçanta. Ky konfuzion vërehet më së shumti kur është fjala për zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut. Problemet kyqe që gjeti SMSL-ja kanë të bëjnë me: së pari, mungesën e qartësisë për atë se cili ligj ka përparësi në rast konflikti; e dyta, problemet e zbatimit të drejtpërdrejtë të ligjit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë mungesën e njohjes së atij ligji dhe mënyrës së zbatimit të tij; dhe e treta, problemet e të

siguruarit se të gjitha autoritetet janë obligohen nga ligji – gjë që është parim kryesor për të gjitha vendet demokratike, siç thuhet në parimet e OSBE-së.<sup>1</sup>

## II. Epërsia e Ligjeve

*Rregullorja 1999/24* ka mundësuar katër burime të mundshme të ligjit të aplikueshëm në Kosovë:

- i. Ligji në Kosovë siç ekzistonte më 22 mars 1989
- ii. Rregulloret e UNMIK-ut
- iii. Ligji i zbatuar në Kosovë midis 22 marsit 1989 dhe 12 dhjetorit 1999 (data kur *Rregullorja 1999/24* hyri në fuqi) nëse ky është më i favorshëm për të pandehurin penal **apo** mbush një zbrastësirë ku nuk ekziston ligj i marsit 1989
- iv. Standardet dhe ligjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Me aq shumë burime potenciale të ligjeve, është shumë me rëndësi të ketë qartësi në atë se cili ligj ka përparësi. Ky nuk është, megjithatë, rasti i ligjit aktual në Kosovë. Edhe pse Rregulloret kanë përparësi ndaj ligjit të vitit 1989, hierarkia në mesin e burimeve të tjera të ligjit nuk është bërë e qartë.

Problemi kryesor qëndron në atë se epërsia e ligjeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mbi ligjet e vendit nuk është shprehur qartë në *Rregulloren 1999/24*. Kjo është kështu, pavarësisht nga fakti se prioriteti i ligjit të të drejtave të njeriut mbi të gjitha ligjet tjera është bërë i qartë përmes letrës së PSSP-së të cekur më lartë. Problemi qëndron në sigurimin se kjo epërsi kuptohet nga komuniteti juridik i Kosovës dhe zbatohet. Në mënyrë që të ndihmohet në këtë zbatueshmëri, planifikohet një grup punues për të identifikuar ato dispozita të LPP-së së RFJ-së që janë në kundërshtim të qartë me ligjet përkatëse ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

## III. Zbatimi i Ligjeve të të Drejtave të Njeriut

Edhe pse shumë, nëse jo shumica e vendeve, e trajtojnë si suprem në kushtetutat e tyre ligjin e të drejtave të njeriut, zbatimi i epërsisë së tillë në praktikë është i vështirë. Shumica e trajtimeve ndërkombëtare, që zbatohen drejt për së drejti në Kosovë, janë formulime të standardeve, të cilat mund të zbatohen vështirë në rastet individuale. Organi më i zhvilluar i ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut është ajo mbështetje në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), që ka zhvilluar zbatimin praktik të standardeve të KEDNJ-së. Megjithatë, zbatimi i drejtë për drejtë i kësaj praktike gjyqësore në gjykatat kombëtare shkakton probleme në tërë kontinentin, madje edhe në ato vende që kanë qenë nënshkruese të Konventës që nga viti 1950.

Problemi i fundit i përket drejtë për së drejti Kosovës, posaçërisht për shkak se shumica e nëpunësve të gjyqësisë dhe avokatëve njohin një sistem gjyqësor, në të cilin ligji i të drejtave të njeriut kurrë nuk është aplikuar, dhe ku përdorimi i praktikës gjyqësore është i panjohur. Kjo situatë është e ngjashme me atë të Bosnës, ku KEDNJ aplikohet drejtë për së drejti, por se atje Oda e të Drejtave të Njeriut ka mundësi të shpallë vendime mbi pajtueshmërinë e legjislacionit të veçantë me KEDNJ-në. Një organ qendror drejtues i



tillë nuk ekziston në Kosovë (edhe pse Gjykata Kushtetuese që është paraparë në Kosovë me marrëveshjen e Rambujesë do ta kishte kryer këtë detyrë). Ombudspersoni do të mund të shpallë udhëzime mbi pajtueshmërinë e ligjeve me standardet ndërkombëtare, por mbetet të shihet nëse kjo do të trajtohet si obligative nga gjyqësia apo të zbatohet njëjtë. Kjo mungesë e udhëzimit qendror e bën edhe më të vështirë për gjyqtarët, pa njohjen e ligjit të të drejtave të njeriut dhe mënyrës së zbatimit të tij, për të shpallur çfarëdo vendimi mbi përputhshmërinë e dispozitave të ligjit të vendit. Ka nevojë tejet të madhe që PSSP-ja të lëshojë një udhëzim të qartë lidhur me këtë.

Ekzistojnë tri mënyra sipas të cilave gjyqtarët duhet t'a zbatojnë ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut në gjykatat e Kosovës.

#### **(a) Mosaplikimi i ligjeve të papajtueshme**

Mënyra më e qartë është kur gjykata nuk zbaton një dispozitë të ligjit të vendit, e cila nuk përputhet me standardet ndërkombëtare. Edhe pse ligji ekzistues në Kosovë përgjithësisht përputhet me standardet ndërkombëtare, disa dispozita nuk përputhen. Siç do të flitet më gjërë në këtë raport, midis neneve, të cilat duket të mos përputhen me KEDNJ-në përfshihet <sup>2</sup> është neni 74 i LPP-së së RFJ-së, i cili e lejon gjyqtarin hetues të ndërhyjë në komunikimin e të paraburgosurit me avokatin e tij/saj. Neni 152 i LPP-së së RFJ-së e lejon policinë t'i paraburgos dëshmitarët në vendin e ngjarjes deri në gjashtë orë deri sa të arrijë gjyqtari hetues. Ky nen është në kundërshtim me KEDNJ-në meqë paraburgimi me qëllim të sjelljes para gjyqtarit hetues si dëshmitar nuk është, dhe nga esenca, arsye e bazuar për paraburgim sipas nenit 5(1) të KEDNJ-së.

Vetë rregulloret e UNMIK-ut mund të jenë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Rregullorja që qartë është në kundërshtim me KEDNJ-në dhe KNDCP-në është *Rregullorja 1999/26*, Mbi Zgjatjen e Periudhës së Paraburgimit, në atë se nuk e lejon në mënyrë adekuate rishqyrtimin e pavarur dhe kundërshtues të paraburgimit nga gjykata<sup>2</sup>. Një kundërshtim tjetër i mundshëm me KEDNJ-në është fuqia për paraburgim që u jepet zyrtarëve që zbatojnë ligjin sipas *Rregullores 1999/2*, që duket të jetë “paraburgim preventiv” për shkaqe sigurie, formë kjo e paraburgimit që qartazi ndalohet në nenin 5(1) të KEDNJ-së dhe praktikën e saj gjyqësore.<sup>3</sup>

Pavarësisht nga këto kontradikta të dukshme të standardeve ndërkombëtare, SMSL-ja nuk ka monitoruar asnjë rast në të cilin gjykata nuk i ka zbatuar dispozitat e ligjit vendas ku ato bien në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

#### **(b) Përdorimi i të drejtave të njeriut si udhëzues në zbatimin e ligjit ekzistues**

Përdorimi më praktik i ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut është që, në të përditshmen, të përcaktohen vendime të tilla, ku ose provat përjashtohen ose paraburgimet autorizohen. Praktika gjyqësore e KEDNJ-së, për shembull, qartazi kërkon që autoritetet t'u ofrojnë ndihmë juridike pa pagesë personave që nuk kanë mjete, në të gjitha rastet penale ku liria e individit mund të jetë në pyetje.<sup>4</sup> Neni 67(1) i LPP-së së RFJ-së siguron se i pandehuri ka të drejtë për mbrojtës “gjatë tërë zhvillimit të procedurës penale.” Një gjykatë që zbaton KEDNJ-në do t'a interpretonte këtë dispozitë ashtu që të sigurojë angazhim të menjëhershëm të mbrojtësit. Megjithatë, në shumë raste gjykatat

kanë dështuar të sigurojnë përfaqësimin, pavarësisht nga fakti se të pandehurit janë ballafaquar ndoshta me burgim dhe, në disa raste, me deportim.

Dështimi i gjykatës për të siguruar mbrojtësin është theksuar me ndjekjen e grave të huaja në Kosovë për prostitucion, shumica e të cilave u ankuan se janë viktime të kontrabandës. Në Mitrovicë, dy gra të huaja janë arrestuar, pos të tjerëve, pas bastisjes së një lokali. Këto gra u ankuan se janë sjellur në Kosovë me qëllime të rrejshme, se kontrabandistët u kanë marrë pasaportat dhe i kanë shitur në prostitucion. Pavarësisht nga kjo, këto gra janë ndjekur për prostitucion dhe dënuar me 30 ditë burg dhe dëbim nga Kosova me ndalim të kthimit për tri vite. Gjykata nuk u ka siguruar mbrojtës këtyre grave. Në një rast tjetër me rastin e bastisjes së një lokali në Prizren, tetë gra të huaja janë arrestuar dhe ndjekur për prostitucion, dënuar me dhjetë ditë burg dhe urdhëruar të dëbohen nga Kosova, përfshirë këtu ndalimin e kthimit për tri vite. Të gjitha këto që u përmendën kanë ndodhur brenda 48 orëve pas arrestimit të tyre. Gjykata nuk ka emëruar asnjë mbrojtës për t'i ndihmuar ndonjëherë nga këto gra. Pas ankesës, këto dënime janë refuzuar dhe lënda është kthyer në gjykatë.

Departamenti Administrativ i Drejtësisë po lëshon një qarkore për Gjykatat e Kosovës lidhur me mbrojtësit e emëruar nga gjykata, që thekson standardet dhe masat e KEDNJ-së për angazhimin e mbrojtësve në rastet që përfshijnë burgimin e mundshëm nëse drjtësia e kërkon një gjë të tillë.<sup>5</sup> Në këtë mënyrë, ligji i të drejtave të njeriut duhet të zbatohet nga gjykatat si udhëzim në zbatimin e ligjit ekzistues. Standardet e të drejtave të njeriut mund të ndihmojnë për të vendosur nëse një person është paraburgosur për kohë shumë të gjatë apo për arsye të drejtë apo nëse gjykimi është i drejtë, duke përfshirë atë se cilët dëshmitarë duhet të dëgjohen apo nëse prova, siç është testi i poligrafit, duhet të përjashtohet. Aryeja e gjykatave për ngurrimin e përdorimit dhe rekomandimit të ligjit të të drejtave të njeriut është mungesa e njohjes së ligjit, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga mënyra e aplikimit të tij praktikisht. Në veçanti, ajo që nevojitet është trajnimi në praktikën gjyqësore të KEDNJ-së dhe praktikimi i këtillë në rrethanat e veçanta të secilit rast.

### **(c) Plotësimi i zbratësirave në ligj**

Ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut mund të zbatohet drejtpërdrejtë për të plotësuar zbratësitë në ligj. Përkrahja e gjërë që ofrohet nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut mund të përfshijë shumë më shumë se çdo dispozitë e definuar ngushtë apo specifike e ligjit të vendit. Gjyqësia që ka njohuri të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe është e sigurtë në përdorimin e tij, mund të mbulojë zbratësi të mëdha në ligjin ekzistues në mënyrë që të mbrojtë të drejtat e qytetarëve të vet.

Një shembull ku një zbratësi e tillë duhet të mbulohet është mungesa e dispozitës në ligjin vendas të Kosovës e cila lejon kundërshtimin e çdo paraburgimi nga gjykata, posaçërisht të paraburgimeve të bëra nga ana e KFOR-it dhe UNMIK-ut. Me një të drejtë të tillë disponon drejtpërdrejtë neni 5(4) i KEDNJ-së dhe neni 9(4) i KNDCP-së. Kështu, çdo gjykatë do të ketë të drejtë, në bazë të epërsisë që ia jep ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut, të dëgjojë secilin rast që kundërshton paraburgimin e personit, dhe të urdhërojë lirimimin e të paraburgosurit. Kjo, në të vërtetë, ka ndodhur pranë kolegjit të gjyqtarëve në Gjykatën e Qarkut në Gjilan kur janë ballafaquar me paraburgimin e

paligjshëm nga KFOR-i. Kolegji i gjyqtarëve e shpalli paraburgimin të paligjshëm, duke bazuar vendimin e tyre në KEDNJ-në.

#### IV. Zbatimi i Ligjit nga të gjitha autoritetet

Të gjitha autoritetet në Kosovë, duke përfshirë PSSP-në dhe KFOR-in, obligohen nga ligji i aplikueshëm që përfshin standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

UNMIK-u obligohet nga ligji i aplikueshëm, dhe si organ i KB-ve, nga standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo është bërë e qartë nga *Rezoluta dhe Rregullorja 2000/38* duke vendosur Institucionin e Ombudspersonit. SMSL-ja nuk ka hasur në asnjë rast në të cilin UNMIK-u ka refuzuar zbatimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Megjithatë, përmes *Rregullores 2000/47 të UNMIK-ut*, UNMIK-u ka krijuar imunitet, në rrethana të caktuara, nga çfarëdo procesi ligjor subjekt i daj padisë në përmes procedurave gjyqësore – imunitet ky që nëse shprehet në çdo procedurë gjyqësore do t'ua vështirësonte personave mbrojtjen e të drejtave të tyre kundër autoriteteve qeveritare.

Është e pakontestueshme se PSSP, i cili bart të gjitha fuqitë ekzekutive dhe legjislativë në Kosovë, duhet t'i nënshtrohet standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ombudspersoni ka fuqi të hulumtojë administratën e përkohshme civile apo cilëndo institucion qendror apo lokal<sup>6</sup>. Megjithatë, ndonjë vendim i PSSP-së nuk është kundërshtuar deri më tani me gjyq.

Sa i përket KFOR-it, si forcë e sigurisë e autorizuar nga KB-të, e përbërë kryesisht nga vendet që janë parti të shumicës së traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, obligohet nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut në të gjitha aspektet e veprimeve të tij. Raporti i fundit i Kolegjit mbi Operacionet Paqësore të KB-ve theksoi “*rëndësinë esenciale të sistemit të Kombeve të Bashkuara që mbështesin dhe promovojnë masat dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ligjin ndërkombëtar humanitar në të gjitha aspektet e aktiviteteve të tij paqësore dhe të sigurisë;*” (Alineja 6) (theksimi është shtuar). Në të vërtetë, kjo është bërë e qartë më 4 korrik 1999, nga Sergio Vieira de Mello, më vonë ushtrues i detyrës së PSSP-së në Kosovë. Në një dokument të titulluar “*Deklaratat mbi të Drejtën e KFOR-it për Arrestim dhe Paraburgim,*” Z. de Mello pohoi se KFOR-i kishte “*mandatin dhe përgjegjësinë për t'u kujdesur si për sigurinë ashtu edhe për rendin publik ... deri sa vetë UNMIK-u të mund t'a marrë përgjegjësinë e plotë.*” Deklarata posaçërisht nënvizon se në kryerjen e këtyre detyrave standardet e njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut do t'i përkasin KFOR-it.

*Rregullorja 2000/47* pohon se KFOR-i “*duhet t'a respektojë ligjin dhe rregulloret e aplikueshme deri aty ku nuk konfrontohen me përmbushjen e mandatit të dhënë [atyre] sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit.*” Megjithatë, *Rezoluta 1244*, veçanërisht si rezolutë e KB-ve, nuk i jep KFOR-it të drejtën e shkeljes së standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Sa i përket marrëdhënive me UNMIK-un, imunitetet që i sigurohen KFOR-it sipas *Rregullores 2000/47* krijojnë pengesa përmbajtësore në mbrojtjen efektive të të drejtave.<sup>7</sup>

Gjatë një Tryeze të Rrumbullakët të mbajtur në Prishtinë në korrik 2000, nën udhëheqjen e Institutit Juridik të Kosovës- OSBE, një përfaqësues i departamentit juridik të KFOR-it tha se KFOR-i obligohet nga ligjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo deklaratë, megjithatë nuk është përcjellur përgjithësisht në të gjitha fushat e aktiviteteve të KFOR-it. Veçanërisht, ata kanë argumentuar se *Rezoluta 1244 e KB-ve* u ka dhënë autoritetin për të paraburgosur persona për afat të pacaktuar pa të drejtë të masave mbrojtëse. SMSL-ja ka vazhduar të dokumentojë rastet e personave të mbajtur “sipas urdhërit të Komandantit të KFOR-it” (të njohura si “mbajtjet” COMKFOR) pa asnjë mundësi të kundërshtimit për paraburgimin e tyre në gjyq. Për më tepër, këto paraburgime duket se bazohen në personat që janë “kërcënim i paqes dhe sigurisë”. Në të vërtetë, *Rregullorja e UNMIK-ut 1999/2* parasheh paraburgimin e përkohshëm apo kufizimin e lirisë së lëvizjes së individit i cili mund të paraqesë kanosje të paqes dhe rendit publik.<sup>8</sup> Kanosja e rendit publik, megjithatë, nuk mund nga dhe në esencë, të jetë arsye e mjaftueshme për të arsyetuar paraburgimin sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.<sup>9</sup>

## V. Shembuj të Qasjes Jokonsistuese në Ligj nga Gjykatat e Qarkut

Seksioni vijues përshkruan një numër të rasteve në të cilat gjykatat e qarkut kanë zbatuar jokonsistueshëm ligjin, në disa raste në kundërshtim me ligjin e vendit dhe atë ndërkombëtar. Kjo nuk është asesi listë e përfunduar.

### (a) Deklaratat pranë Gjyqtarit Hetues

Në disa raste të dëshmitarëve serbë të Kosovës, Gjyqtarët Hetues dështojnë ri-leximin e deklaratës së dhënë nga dëshmitarët. Disi, dëshmitari thjeshtë kërkohet që t’ a nënshkruajë deklaratën e tij/saj, të shtypur në shqip, pa vërtetuar saktësinë e saj në gjuhën që e kupton dëshmitari. Kjo është në kundërshtim me dispozitat e gjykimit të drejtë të përmbledhura në nenin 6 të KEDNJ-së.

### (b) Dëshmia e përmbledhur për procesverbal

SMSL-ja ka monitoruar një numër rastesh në të cilat kryetari i kolegjit ka lexuar në procesverbalin e gjykatës një *përmbledhje* të dëshmisë së dëshmitarit/pandehurit, në vend të shkresës *fjalë-për-fjalë*. LPP-ja e RFJ-së duket se e lejon këtë.<sup>10</sup> Meqenëse i pandehuri ka të drejtë të rishqyrtimit të saktë të çështjeve, vetëm procesverbali *fjalë-për-fjalë* mund t’i mbrojë të drejtat e të pandehurit për ankim, siç përshkruhet në nenin 14(5) të KNDCP-së. SMSL-ja shënoi se në rastin *Peter Muriuki et al* kishte procesverbal *fjalë-për-fjalë* të gjykimit.

### (c) Deklaratat e “lexuara” në procesverbal

Në një numër rastesh ku kryetari i kolegjit i ka bashkangjitur deklaratat në procesverbal pa ia lexuar të pandehurit apo njohtuar të njëjtin për përmbajtjen e deklaratave. Kjo poashtu përfshin praktikën e thirrjes së dëshmitarit për “të dhënë dëshminë e njëjtë si para gjyqtarit hetues”, pa lexuar deklaratën para gjyqit në mënyrë që t’ a dëgjojë i pandehuri. Kjo praktikë mund t’ia mohojë të pandehurit të drejtën e gjykimit të drejtë dhe publik.

**(d) Rregullorja 2000/17**

Me sa duket ka keqkuptim gjithpërfshirës të *Rregullores 2000/17* nga Gjykatat e Qarkut. SMSL-ja ka hasur në një numër rastesh në të cilat kryetari i kolegjit pranon deklaratat e dëshmitarit sipas kësaj rregulloreje. Kur dëshmitari nuk mund të marrë pjesë në dëgjimet hetuese, rregullorja lejon **deklaratat e dëshmitarëve të marra nga autoritetet përkatëse që zbatojnë ligjin** të pranohen pranë gjyqtarit hetues në **hetimin paraprak, e jo në gjykim**. Në të vërtetë, Seksioni 3 e bën të qartë se i pandehuri mban të drejtën e egzaminimit të këtyre dëshmitarëve në gjykim siç garantohet në standardet ndërkombëtare.

**(e) Largimi i të Pandehurve të tjerë nga Gjykata**

Në rastet kur ekzistojnë më shumë se një i pandehur, SMSL-ja ka vërejtur se disa kolegje gjyqtarësh kërkojnë që të pandehurit tjerë t'a lëshojnë gjykatën gjatë dëshmimit të të pandehurit tjetër. Kjo siç duket lejohet nga LPP-ja e RFJ-së për shkak se kryetari i kolegjit është i obliguar t'a "njohtojë" të pandehurin për dëshminë e të pandehurve të tjerë<sup>11</sup>. Por në rastet e monitoruara nga SMSL-ja, kryetari i kolegjit ka dështuar t'u rrëfejë dëshmitarëve të tjerë këtë dëshmim. Kjo dispozitë në LPP-ne e RFJ-së shkel të drejtën e të pandehurit "për t'u gjykuar në praninë e tij."<sup>12</sup>

**(f) Përkthimi joadekuat i gjykatës**

Gjatë monitorimit në rastet e gjykatave të qarkut, SMSL-ja ka vërejtur gjërësisht probleme me përkthimet dhe interpretimet në gjykata<sup>13</sup>. Kjo është përkundër faktit se ligji vendas siguron barazinë e gjuhëve në procedurën gjyqësore. Në qershor 2000, DAGJ-ja e KB-ve ka lëshuar një udhëzim për gjykata, që përkujton gjykatat për obligimin e tyre lidhur me këtë<sup>14</sup>.

Mbrojtësit që përfaqësonin Millosh Jokiqin (*? iloš Jokic*), serb i Kosovës i gjykuar për gjenocid, dështuan të marrin pjesë në ditën e parë të gjyqimit të tij. Në mungesën e tyre, kolegji i gjyqtarëve diskutoi me prokurorin se çka të bëhet. Kjo bisedë zgjati rreth 45 minuta dhe përfundoi kur kolegji caktoi një datë tjetër të gjyqimit, duke thënë se nëse avokatët dështojnë të marrin pjesë në dëgjimin e ardhshëm, gjykata do t'a emërojë një mbrojtës lokal. Përveç pyetjes që iu bë të pandehurit se a dëshiron të ketë mbrojtësit e njëjtë në dëgjimin e ardhshëm, asgjë nga të përmendurat më lartë nuk janë përkthyer në gjuhën serbe. Kur SMSL-ja paraqiti këtë çështje tek Kryetari i Gjykatës së Qarkut, u informua se meqë gjykimi në të vërtetë nuk kishte filluar, nuk kishte as "procedurë" të tillë dhe në këtë mënyrë, as obligim të përkthimit.

Në gjykimin e *Jokiqit* kolegji poashtu parafranoi dëshminë e dëshmitarit. Në disa raste dëshmia e dëshmitarit nuk është përkthyer për gjyqtarin ndërkombëtar derisa kryetari i kolegjit ka parafrazuar dëshminë.

Në gjykimin e parë të *Momçilloviqëve* (*Momc ilovic*), përkthyesit e gjykatës ishin të ulur me prokurorin dhe mbrojtësin. Gjatë tri ditëve të dëshmimit, përkthimi në serbisht shpesh është përmirësuar nga gjykata, dhe në raste të veçanta, nga personat në publik. SMSL-së iu bë e qartë se kishte raste të rëndësishme kur të pandehurit nuk mund të dëgjonin

përkthimin. Në gjykimin e dytë, u gjet një mënyrë tjetër. Shtylla III pajisi gjykatën me mjete të përkthimit simultant. Përkthyesit e gjykatës ishin poashtu të ri. Kjo rrjedh nga mungesa e përgjithshme e përkthyesëve të kualifikuar në fushën juridike, edhe pse DÇJ-ja e KB-ve ka punësuar vonë një numër të përkthyesëve ndërkombëtarë. Kur mjetet nuk punonin, prapsepapë, dëshmitarët e vazhduan dëshmimin e tyre, gjë që nuk u përkthye fare për të pandehurit apo gjyqtarin ndërkombëtar. Në raste tjera, përkthyesit do të ndalnin përkthimin e pyetjeve/fjalimeve të mbrojtësit sepse ai fliste shumë shpejt. Nuk u përkthye ajo që u tha dhe gjykimi vazhdoi.

### **REKOMANDIMET E SMSL-së**

1. Ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut (dhe posaçërisht KEDNJ-ja dhe praktika e saj gjyqësore) kanë përparësi mbi të gjitha ligjet tjera. Në pajtim me këtë rekomandim që UNMIK-u dhe KFOR-i të veprojnë pa përjashtime në pajtim me këto ligje.
2. PSSP-ja duhet t'a lëshojë një Direktivë Administrative e cila pohon:
  - i. se ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut është superior mbi të gjitha ligjet tjera;
  - ii. se gjykatësit dhe prokurorët publikë janë të obliguar të mos i zbatojnë dispozitat e LPP-së së RFJ-së të cilat janë në kundërshtim me këto standarde;
  - iii. bashkë me këto obligime, gjyqtarët dhe prokurorët publikë duhet t'i aplikojnë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për t'i përfshirë çështjet që nuk i përfshin LPP-ja e RFJ-së.
3. Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të organizojë më shumë trajnime të gjithëmbarshe në zbatimin e ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut në kontekstin e drejtësisë penale si për gjyqtarët dhe prokurorët vendas ashtu edhe për ata ndërkombëtarë. Në veçanti, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët publikë të emëruar duhet t'a kryejnë një kurs juridik trajnimi para se të marrin pozitën e tyre zyrtare.
4. Është rekomanduar që Departamenti i Drejtësisë duhet t'i ndryshoj Instrukcionet Administrative mbi mbrojtësin e emëruar nga gjykata ashtu që të sigurohet se mbrojtësit janë të emëruar në të gjitha rastet ku një person mund të ballafaqohet me deportim.
5. Është rekomanduar që Departamenti i Drejtësisë duhet të lëshojë një Udhërrëfyes Administrativ dhe Qarkore që ndriqon si në vijim:
  - i. gjykatat duhet të pajisen me mjete të duhura për të siguruar një procesverbal fjalë për fjalë të të gjitha procedurave ligjore;
  - ii. në pajtim me të drejtën e egzaminimit të dëshmitarëve, të pandehurit nuk duhet të largohen nga dhoma e gjykimit gjatë marrjes së dëshmisë;
  - iii. në pajtim me të drejtën e gjykimit në praninë e tij, deklaratat e marra nga dëshmitarët pa praninë e mbrojtësit apo të pandehurit nuk duhet të pranohen dhe nuk mund t'a krijojnë bazën e një vendimi;

- iv. të gjitha deklaratat e bëra nga palët gjatë dëgjimeve të hetimit dhe në gjykim duhet të pasqyrohet tërësisht në procesverbal.

---

itit 1990 dhe posaçërisht alinetë:

(5.3) – detyra e autoriteteve qeveritare dhe publike për t’iu përmbytur kushtetutës dhe të vepronë në mënyrë të pajtueshme me ligjin;

(5.5) – aktiviteti i qeverisë dhe i administrimit si dhe ai i gjyqësisë do të ushtrohet në pajtim me sistemin e krijuar me ligj.

(5.6) – forcat ushtarake dhe policia do të jenë nën kontrollin dhe përgjegjësinë e autoriteteve civile;

(5.7) – të drejtat e njeriut dhe liritë themelore do të garantohen nga ligji dhe në pajtim me obligimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar.

<sup>2</sup> Shiko Raportin e SMSL 6 Zgjatja e Limitit Kohor dhe të Drejtat e të Paraburgosurit: Joligjshmëria e Rregullores 1999/26 (29 Prill 2000).

<sup>3</sup> *Shiko Jecius v Lithuania*, GJEDNJ, App. 34578/97, 31 korrik 2000.

<sup>4</sup> *Shiko Benham v UK* 22 E.H.R.R. 293, ku GJEDNJ vërtetoi se interesi i drejtësisë kërkon dispozitën shtetërore të avokatit në të gjitha rastet ku liria e individit mund të ishte në rrezik.

<sup>5</sup> *Shiko Draftin e Drejtësisë së UNMIK-ut 2000/17: Udhëzime mbi Zgjatjen e Kushteve për Mbrojtësin e Emëruar nga Gjykata*---i panëshkrar.

<sup>6</sup> Rregullorja 2000/38 Mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, Seksionit 3 .

<sup>7</sup> Rregullorja 1999/47 Mbi statusin, privilegjet, dhe imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut, Personbeli dhe tyre në Kosovë, 18 Gusht 2000.

<sup>8</sup> Rregullorja 1999/2 Mbi preventimin e Qasjes nga Individët dhe Largimi I tyre për Sigurimin e Qetësisë dhe rregullit publik, 12 Gusht 2000.

<sup>9</sup> *Irlanda v BM*(1979-80) 2 EHRR 25 DHE *Jecius v Lithuania* ECHR 31 Korrik 2000.

<sup>10</sup> *Shiko Nenin* 222 LPP RFJ.

<sup>11</sup> *Shiko nenin* 319 të LPP-së të RFJ-së.

<sup>12</sup> *Neni* 14(3)(d) ICCPR.

<sup>13</sup> *Shiko Nenin*7 LPP RFJ.

<sup>14</sup> *Shiko Drejtësia e UNMIK-ut 2000/8: Përdorimi i Gjuhëve në Procedurat Gjyqësore*, 28 qershor 2000.

#### **SEKSIONI 4: NDALIMI I ARRESTIMIT DHE PARABURGIMIT ARBITRAR**

Neni 9 dhe 14 i KNDCP-së dhe neni 5 dhe 6 i KEDNJ-së përbëjnë strukturën e mbrojtjes së personave që janë subjekt i çfarëdo forme të arrestimit dhe paraburgimit. Neni 9(1) thotë: “Secili ka të drejtë të lirisë dhe sigurisë. Askush nuk duhet të jetë subjekt i arrestimit dhe paraburgimit arbitrar. Askujt nuk duhet t’i privohet liria përveç për arsye të caktuar dhe në pajtim me procedurën e caktuar që është vendosur me ligj.” Kjo dispozitë pasqyrohet në nenin 5(1) të KEDNJ-së.

Sipas KNDCP-së dhe KEDNJ-së të gjithë personat e paraburgosur duhet të kenë të drejtë t’ua kontestojnë ligjshmërinë e arrestimit dhe paraburgimit të tyre në çdo kohë.<sup>1</sup> LPP-ja e RFJ-së nuk siguron një mekanizëm me anë të të cilit të paraburgosurit do t’ua kontestonin ligjshmërinë e paraburgimit të tyre. SMSL-ja ka raportuar më herët se dështimi për të siguruar një mekanizëm *habeas corpus* është një mangësi serioze në ligjin e vendit. Si rezultat, personat mbahen aktualisht në paraburgim të vazhduar nga UNMIK-u dhe KFOR-i pa kompensim, përkundër faktit se ata mund të jenë subjekt i arrestimit apo paraburgimit arbitrar.

Pos kësaj, sipas KNDCP-së dhe KEDNJ-së personi për të cilin është vërtetuar se ka qenë viktimë e arrestimit apo paraburgimit arbitrar, ka të drejtë të plotfuqishme të kompensimit.<sup>2</sup> Në pajtim me këtë standard ndërkombëtar, LPP-ja e RFJ-së poashtu përmban autorizimin për kompenzim për personat që janë arrestuar apo paraburgosur në mënyrë të paligjshme.<sup>3</sup>

#### **I. Paraburgimet e paligjshme nga UNMIK-u dhe KFOR-i**

SMSL-ja ka vrojtuar raste në të cilat personat kanë qenë të paraburgosur nga UNMIK-u, autoriteti ekzekutiv, dhe KFOR-i, në kundërshtim me procedurat e përshkruara në LPP-në e RFJ-së. Këto raste të paraburgimit arbitrar paraqesin nevojën e menjëhershme për një mekanizëm të drejtë në bazë të të cilit të gjithë personat e paraburgosur në Kosovë mund t’ua kontestojnë ligjshmërinë e arrestimit dhe paraburgimit të tyre.

##### **(a) “Ekstradimi” i Moses Omweno**

Më 2 qershor 2000, *Moses Omweno* është arrestuar në Niarobi nga autoritetet e Kenisë në bazë të një kërkese nga policia e UNMIK-ut. *Omweno* ishte ish-nëpunës i Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në Prishtinë, e cila ka parashtruar një ankesë kundër tij në policinë e UNMIK-ut për vjedhje. *Omweno* është mbajtur në Nairobi *incommunicado* deri më 6 qershor 2000, kur u largua nga kompetenca pa dëgjim gjyqësor në kundërshtim me ligjin vendas të Kenisë dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. *Omweno* është sjellur nga Kenia në Kosovë në përcjellje të policisë së Kenisë dhe një përfaqësuesi të IOM-it, pa pasaportë. Më 8 qershor 2000, *Omweno* arriti në Prishtinë ku u arrestua dhe u paraburgos nga policia e UNMIK-ut. Gjatë paraburgimit, policia e UNMIK-ut e morri *Omweno*n tri herë në pyetje pa e informuar mbi të drejtat e tij. Në kundërshtim me LPP-në e RFJ-së, prokurori publik zgjeroi aktakuzën përtej bazës nga fletëarresti kundër *Omwenos* duke përfshirë dy akuza të reja për vjedhje. Gjatë procesit të



“ekstradimit” të *Owmenos*, policia e UNMIK-ut nuk u konsultua me zyrën juridike të policisë së UNMIK-ut, DÇGJ-në e KB-ve apo Zyrën e PSSP-së. Me kërkimin e largimit të *Owmenos* nga Kenia, policia e UNMIK-ut ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së të RFJ-së mbi ekstradimin.

Më 14 korrik 2000, SMSL-ja lëshoi një raport me titull “*Ekstradimi*” i *Moses Tengeya Omweno*. Në bazë të përfundimeve në atë raport, SMSL-ja konkludoi se mënyra në të cilën *Omweno* ishte “ekstraduar” nga Kenia në Kosovë, paraburgimi i tij pasues dhe zgjerimi i aktakuzës kundër tij kishte të bëjë me shkeljen e ligjit vendas dhe ndërkombëtar. SMSL-ja përfundoi se, në këtë rast, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nuk kishte kompetencë dhe se paraburgimi i tij ishte i paligjshëm. SMSL-ja bëri rekomandim të PSSP-ja se kompensimi më i qëlluar dhe më efektiv ishte urdhëri zbatues për lirimin e menjëhershëm të *Owmenos*. Ky rekomandim është bërë në bazë të faktit se ligji i aplikueshëm nuk siguron një mekanizëm për kontestimin e ligjshmërisë së arrestimit dhe paraburgimit si dhe rrethanave të veçanta të rastit.

Atëbotë, *Omweno* mbeti në paraburgim, por Gjykata e Qarkut në Prishtinë u informua për raportin e SMSL-së dhe konkludimet në të. Si rezultat, më 20 korrik 2000, gjyqtari hetues ndërmori një takim me bashkëshorten e *Owmenos* me ç’rast ai e udhëzoi se *Omweno* mund të lirohet me dorëzani nëse ai ka mundësi për një gjë të tillë dhe se duhet të pretojë se do të mbetet në Prishtinë. Znj. *Omweno* tha se ajo duhet t’i diskutojë këto mundësi me bashkëshortin e saj. Më 21 korrik 2000, gjyqtari hetues e informoi Znj. *Omweno* se bashkëshorti i saj duhet të mbetet në Prishtinë në pritje të gjykimit. Më vonë, megjithatë, gjyqtari hetues ndërpreu paraburgimin e *Owmenos* pa një kusht të tillë, por në bazë të asaj se *Omweno* premtonte se do t’i përgjegjet çdo thirrjeje të gjykatës. Gjatë dëgjimit, gjyqtari hetues i tha *Owmenos* se ai po hetonte pafajshmërinë e *Owmenos* dhe se mendonte se *Omweno* do të jetë i akuzuar. Ndërprerja e paraburgimit ishte një urdhër për lirim, që nuk krijonte konkludime gjyqësore mbi ligjshmërinë e paraburgimit të *Owmenos*.

SMSL-ja është informuar se gjyqtari hetues inicoi këtë “dëgjim”, i cili nuk përputhet me dispozitat e LPP-së të RFJ-së mbi dorëzanimin apo ndërprerjen e paraburgimit. “Marrja në pyetje për dorëzani” ishte një *ad hoc* dhe kompensim i paqëlluar për rastin e *Owmenos*, meqë ishte i pamjaftueshëm që të shërbejë si një mekanizëm për kontestimin e ligjshmërisë së paraburgimit siç obligohet nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut.

#### **(b) “Mbajtjet” COMKFOR**

Në rastin e *Shaban Beqirit* dhe *Xhemal Sejdiut*, u urdhërua nga një gjyqtar, që të dyshimtit të lirohen më 16 nëntor 1999. Megjithatë, prej 16 nëntorit 1999 deri në ditën e gjykimit të tyre më 25 korrik 2000, *Beqiri* dhe *Sejdiu* janë mbajtiur në paraburgim me urdhërin e COMKFOR-it. Në ditën e gjykimit të tyre, *Sejdiu* dhe *Beqiri* janë sjellë në gjykatë me pranga. Në bazë të një kundërshtimi nga mbrojtësi dhe një deklaratë nga prokurori publik se ai nuk ka kërkuar që të akuzuarit të paraburgosen, kolegji i gjyqtarëve vendosi që, në bazë të *Rregullores 1999/24* dhe KEDNJ-së, vetëm gjykata ka autoritet ligjor për të privuar lirinë e një personi. Pas kësaj, KFOR-i liroi *Beqirin* dhe *Sejdiun*.

Në këtë dhe raste të tjera, KFOR-i ka vazhduar paraburgimin e individëve, si subjekt i hetimit penal pavarësisht nga urdhëri i ligjshëm i një gjyqtari për lirim. Si rezultat, “mbajtjet” COMKFOR janë praktikuar gabimisht për të uzurpuar vendimin e ligjshëm të gjyqësisë të sjellur “*në pajtim me procedurat e vendosura me ligj*” dhe me këtë kanë paraburgosur persona arbitrarisht.

Në pajtim me COMKFOR-in, fuqia e tyre për të paraburgosur vjen nga *Rezoluta 1244*, e cila i jep KFOR-it përgjegjësinë për, pos tjerash, “vendosjen e sigurisë dhe rendit publik *derisa prania ndërkombëtare civile do të mund t’a marrë përgjegjësinë për këtë detyrë.*” (Alineja 9(d)).

Mund të kontestohet se UNMIK-u nuk është ende në gjendje të marrë “tërë përgjegjësinë” për sigurinë dhe rendin publik në Kosovë. Megjithatë, policia e UNMIK-ut, mbizotërueshëm, ka përparësi në tërë krahinën, dhe ekziston sistem gjyqësor që funksionon. Si rezultat, duket të ketë pak, nëse ka, arsyetim për vazhdimin e të ashtuquajturave COMKFOR “mbajtje”. Mirëpo, në raste të veçanta ku “mbajtjet” praktikohen, sipas standardeve ndërkombëtare, duhet të ekzistojë një mekanizëm me anë të të cilit i paraburgosuri mund t’a kontestojë ligjshmërinë e paraburgimit të vet.

## **II. E drejta e Sjelljes së Menjëhershme Para Autoritetit Gjyqësor**

Njëra nga masat kundër arrestimit dhe paraburgimit arbitrar është e drejta e sjelljes së menjëhershme para gjyqtarit apo para një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për ushtrimin e fuqisë gjyqësore.<sup>4</sup> Arsyeja prapa kësaj të drejte është për të siguruar se gjyqësia e pavarur dhe e paanshme mban kontrollin mbi privimet e lirisë nga zbatuesit dhe për të parandaluar shkeljen e të drejtave të tjera themelore, siç është e drejta e trajtimit human.<sup>5</sup> Në mënyrë që të përmbushet kjo e drejtë, sjellja e të akuzuarit para autoritetit gjyqësor është e domosdoshme. Pos kësaj, zyrtari i autorizuar me ligj për të ushtruar autorizim gjyqësor duhet të jetë i pavarur nga zbatuesit dhe palët.<sup>6</sup> Si rrjedhim, autoritetet zbatuese të ligjit nuk mund t’a kryejnë funksionin e zyrtarit të autorizuar me ligj për të ushtruar autorizim gjyqësor. Poashtu, prokurori publik që është njëri nga palët në rast nuk mund t’a kryejë këtë funksion meqë ai nuk posedon paanshmërinë e duhur.<sup>7</sup> Nuk është shkelje e të drejtës për kontrollim gjyqësor të paraburgimit, nëse personi është paraburgosur nga zbatuesit dhe është liruar ‘menjëherë’ para se të sillet para autoritetit gjyqësor.

Edhe pse nuk ka afat kohor të definuar qartë për të siguruar të drejtën e sjelljes së menjëhershme para gjyqtarit, judikatura ndërkombëtare përmban disa udhëzime. *Komiteti i KB-ve për të Drejtat e Njeriut* duke siguruar një interpretim autoritativ të nenit 9(4) të KNDCP-së, ka pohuar se “vonesat nuk duhet t’i tejkalojnë disa ditë.”<sup>8</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerësoi se paraburgimi policor në Irlandën Veriore i një të dyshimit për terrorizëm për një afat prej 4 ditë e 6 orësh ishte shkelje e të drejtës për sjellje të menjëhershme para autoritetit gjyqësor.<sup>9</sup> Edhe pse gjykata pranoi rrethanat e posaçme me të cilat ballafaqohen autoritetet në Irlandën Veriore, gjykata vlerësoi se lejimi i rrethanave të tilla për të arsyetuar periudhën e zgjatur të paraburgimit para

dëgjimit në gjykatë do t'a "dëmtonte mu në esencë të drejtën e kontrollit të menjëhershëm gjyqësor."

#### **(a) Ligji vendas mbi arrestimin dhe paraburgimin**

Sipas LPP-së së RFJ-së paraburgimi duhet të urdhërohet, nëse ekziston njëra prej katër arsyeve specifike për paraburgim, në rend të parë nga gjyqtari hetues e pastaj nga kolegji i gjyqtarëve apo kolegji i Gjykatës Supreme.<sup>10</sup> Autoritetet zbatuese të ligjit mund t'a arrestojnë dhe paraburgosin një person nëse ekzistojnë arsyet për paraburgim. Megjithatë LPP-ja e RFJ-së obligon autoritetet zbatuese të ligjit t'i sjellin personat e arrestuar dhe të paraburgosur para gjyqtarit hetues *përbrenda 24 orëve nga marrja*. Nëse kjo dështon, autoritetet zbatuese të ligjit duhet t'ia demonstrojnë gjyqtarit hetues rrethanat të cilat *pamundësuan* paraqitjen e personit. LPP-ja e RFJ-së lejon qartë autoritetet zbatuese të ligjit t'a sjellin të paraburgosurin para gjyqtarit hetues të një gjykate të instancës më të ultë të vendit ku krimi është kryer nëse "ajo gjykatë mund të arrihet më lehtë."<sup>11</sup>

Si përjashtim, autoritetet zbatuese të ligjit mund të "urdhërojnë" paraburgimin. Në mënyrë që autoritetet zbatuese të ligjit të paraburgosin për këtë shkak, ata duhet të kenë frikë të bazuar se personi do të ikë, apo duhet të dijnë se ekzistojnë rrethana të caktuara që arsyetojnë frikën se një krim tjetër mund të ndodhë apo se personi mund t'i shkatërrojë "gjurmët e krimit." Ky paraburgim mund të zgjasë më së shumti 3 ditë, që llogaritet nga momenti i marrjes.<sup>12</sup> Ky urdhër për paraburgim duhet të përputhet me dispozitat e paraburgimit të përshkruara më lartë, ashtu që "*paraburgimi duhet të urdhërohet përmes vendimit me shkrim...*" dhe fletarresti duhet t'i prezentohet personit që i përket, në momentin e marrjes apo jo më vonë se 24 orë nga paraburgimi i tij. Sipas ligjit, mund të bëhet një ankesë kundër këtij urdhëri të shkruar për paraburgim dhe udhëzon saktësisht autoritetet zbatuese të ligjit që të sigurojnë se të paraburgosurit i ipet ndihmë juridike për paraqitjen e kësaj ankese. Pos kësaj, sipas LPP-së të RFJ-së autoritetet zbatuese të ligjit duhet t'a informojnë menjëherë prokurorin publik për paraburgimin e urdhëruar nga policia.<sup>13</sup>

Në të gjitha rastet e arrestimit dhe paraburgimit, LPP-ja e RFJ-së e vlerëson të obligueshme dispozitën mbi urdhërin për arrest ose në momentin e arrestimit ose përbrenda 24 orëve pas paraburgimit.<sup>14</sup> Individit i paraburgosur ka të drejtë t'a kundërshtojë urdhërin për arrestim përbrenda 24 orësh pas shpalljes së këtij urdhëri.

#### **(b) "Rregulla 72 orë"**

SMSL-ja ka vërejtur se për policinë e UNMIK-ut dhe KFOR-in mbajtja e personave për 72 orë para se t'i sjellin para autoritetit gjyqësor, është procedurë e zakonshme, më tepër se një përjashtim sipas LPP-së së RFJ-së. Kjo praktikë quhet "rregulla 72 orë".

Kjo praktikë është në kundërshtim me LPP-në e RFJ-së sipas së cilës obligohet që i paraburgosuri të sillet para gjyqtarit hetues brenda 24 orësh. SMSL-ja nuk ka njohuri për ndonjë rast ku procedurat e LPP-së së RFJ-së janë përcjellur. Në fakt, në maj 2000 policia e UNMIK-ut lëshoi një deklaratë të rregullës mbi arrestimin dhe paraburgimin,

Buletini 15, i cili udhëzon se “kur një i dyshimtë sillet në burg, rasti duhet t’i paraqitet prokurorit publik brenda 72 orësh nga arrestimi.” SMSL-ja ia ka bërë të ditur Policisë së UNMIK-ut se ky seksion nuk përputhet me LPP-në e RFJ-së, dhe as nuk pajtohet me kërkesat e të drejtës për sjellje të menjëhershme para autoritetit gjyqësor në ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.

Për më tepër, SMSL-ja ka vërejtur se ka dështim sistematik tek organet zbatuese ligjore dhe gjykatave për të ndihmuar lëshimin e urdhërit për arrestim brenda 24 orësh pas paraburgimit siç parashihet nga ligji i aplikueshëm. LPP-ja e RFJ-së siguron të drejtën e individit të arrestuar për kundërshtimin e urdhërit për arrestim pranë kolegjit të gjyqtarëve. Kjo dispozitë, nëse zbatohet, do të ndihmonte në mbrojtjen nga arrestimet arbitrare, ku individit është paraburgosur pa dyshim të bazuar se ka kryer vepër penale. SMSL-ja shënon se lëshimi i urdhërit për arrestim, megjithatë, nuk i përmbush kërkesat e të drejtës së sjelljes para autoritetit gjyqësor. Pos kësaj, autoritetet zbatuese të ligjit vazhdimisht dështojnë të sigurojnë një urdhër me shkrim për paraburgim, siç referohet në LPP-në e RFJ-së. Si rrjedhim, dispozita e ligjit të aplikueshëm që lejon kundërshtimin e vendimeve të tilla, nuk mund të shfrytëzohet praktikisht. SMSL-ja megjithatë, veçon më tej se urdhëri i shkruar për paraburgim nga autoritetet zbatuese të ligjit nuk ndeshet me kërkesat e nenit 5(3) të KEDNJ-së dhe nenit 9(4) të KNDCP-së.

Për hir të faktit se policia UNMIK-ut ka përparësi në shumicën e anëve të Kosovës dhe se ekziston një sistem funksionues gjyqësor, duke përfshirë edhe gjykatat komunale, SMSL-ja mendon se praktikimi i mbajtjes së personave për 72 orë nuk është më i nevojshëm dhe nuk përputhet me LPP-në e RFJ-së. Si pasojë e kësaj, praktika nënshtron personat e paraburgosur, me shkeljen e të drejtës së tyre që të trajtohen “sipas procedurave të përshkruara në ligj.” SMSL-ja mendon se kjo praktikë duhet të merr fund menjëherë dhe se policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i duhet t’i sjellin personat e arrestuar dhe të paraburgosur para gjyqtarit hetues brenda 24 orëve pas marrjes. Vetëm me dëshminë e rrethanave të veçanta policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i duhet të kenë mundësi të paraburgosin një person deri në 72 orë pa e sjellur para autoritetit gjyqësor.

### **(c) Paraburgimi i zgjatur policor**

Gjatë kohës së SEGJ-së, ishte e zakonshme që personat e arrestuar të mbahen në paraburgim më tepër se 72 orë para se të silleshin para autoritetit gjyqësor. Për shembull, Zymer Thaçi është arrestuar më 25 shtator 1999 nga policia e UNMIK-ut dhe është paraburgosur në burgun e Prishtinës më 26 shtator 1999. Pas gati një muaji në paraburgim, më 22 tetor 1999, Thaçi atëherë u soll para gjyqtarit hetues. Fatkeqësisht, SMSL-ja ka vrojtuar se shkeljet e procedurave të përshkruara në ligj dhe e të drejtës së sjelljes së menjëhershme para autoritetit gjyqësor kanë vazhduar prej shkurtit.

### ***Arben dhe Arsim Bajrami***

Më 8 prill 2000, Arben dhe Arsim Bajrami, të cilët ishin arrestuar me Peter Muriukin për vjedhje në një OJQ në Ferizaj, ku edhe u paraburgosën nga policia e UNMIK-ut në Ferizaj e pastaj u dërguan në Gjilan. Ata u intervistuan nga policia e UNMIK-ut dy herë

pa praninë e një avokati. Gjatë këtyre intervistave, Arben Bajrami pohoi se ishte qëlluar me shuplakë nga polici ndërkombëtar i UNMIK-ut dhe Arsim Bajrami pohoi se ishte rrëmbyer për qafe, dhe përplasur për muri dhe kërcënuar nga oficer i SHPK-së. Prej 8 prillit 2000 deri më 19 prill 2000, të paraburgosurit nuk janë parë nga një gjyqtar hetues as në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë as në Gjykatën e Komunale në Ferizaj ku edhe ndodhi krimi. Më 19 prill 2000, ishte caktuar një dëgjim para gjyqtarit hetues në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, por policia e UNMIK-ut nuk i solli të paraburgosurit në kohë. Në kohën kur të paraburgosurit u sollën në gjykatë, mbrojtësi i tyre është dërguar në shtëpi. Deri më 21 prill 2000, pas 13 ditësh në paraburgim, Arben dhe Arsim Bajrami nuk janë parë nga ndonjë zyrtar gjyqësor.

Pavarësisht nga fakti se qartazi sipas LPP-së së RFJ-së të paraburgosurit mund të sillen para gjyqtarit hetues të gjykatës së instancës më të ulët ku është kryer krimi për të siguruar se të paraburgosurit dalin para autoritetit gjyqësor menjëherë, Arben dhe Arsim Bajrami janë mbajtur 13 ditë në paraburgim pa u sjellur para gjyqtarit në Gjykatën Komunale të Ferizajit në kundërshtim me ligjin. Gjatë kohës së tyre në paraburgim, atyre nuk u ishte siguruar vendim me shkrim lidhur me urdhërin e policisë për paraburgim e as urdhër me shkrim për arrestim. Përgjatë kësaj kohe, Arben dhe Arsim Bajrami nuk mundën t'a kontestojnë ligjshmërinë e paraburgimit të tyre.

### *I paraburgosuri S*

Më 18 qershor 2000 i paraburgosuri S ishte arrestuar dhe paraburgosur për posedim armësh nga KFOR-i që solli të dyshimtin me helikopter në Burgun e Qarkut në Prishtinë. Gjatë kësaj kohe, i paraburgosuri S raportoi se ai ishte marrë disa herë në pyetje nga ushtarët e KFOR-it dhe policia e UNMIK-ut. Pos kësaj, ai tha se policia e UNMIK-ut nuk e ka njohtuar familjen e tij lidhur me arrestimin e tij dhe vendin e paraburgimit deri katër ditë pas arrestimit të tij. Të paraburgosurit S nuk i ishte siguruar urdhër me shkrim për arrestimin e tij. Më 4 korrik 2000, i paraburgosuri S është parë nga gjyqtari hetues në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Në kohën kur u pa nga gjyqtari, I paraburgosuri S kishte kaluar 16 ditë në paraburgim. S u lirua nga paraburgimi më 11 korrik 2000 nga gjyqtari hetues, pasi që prokurori pezulloi hetimet.

SMSL-ja është informuar nga policia e UNMIK-ut dhe prokurori i rastit se urdhëri verbal për paraburgim nga prokurori ishte arsyeja e vazhdimit të paraburgimit përtej afatit kohor policor të paraburgimit. LPP-ja e RFJ-së nuk parasheh urdhër për paraburgim nga prokurori, e aq më pak një verbal. Pos kësaj, një urdhër verbal i prokurorit ndaj policisë nuk përputhet me kërkesat e të drejtës së sjelljes para autoritetit gjyqësor. Kjo e drejtë detyron, siç u cek më lart, praninë e të pandehurit para një zyrtari të autorizuar dhe paanshmërinë e atij zyrtari, e as me ndonjë palë të rastit siç është prokurori. SMSL-ja shënon se rasti i të paraburgosurit S nuk është i vetmi, në rastet tjera urdhëri verbal nga prokurori është përdorur për të zgjatur paraburgimin policor, për shembull të të paraburgosurit A i cili është aktualisht në paraburgim, është paraburgosur prej 8 marsit 2000 deri më 15 mars 2000, 6 ditë, para se të sillej para gjyqtarit hetues për këtë gjë.

## ***6 meshkuj shqiptarë të Kosovës***

Më 20 qershor 2000, 6 meshkuj shqiptarë të Kosovës janë arrestuar në Prishtinë pasi që janë ndalur nga policia e UNMIK-ut dhe oficerët e SHPK-së. Këta të dyshimtë janë ndjekur për sulmimin e një zyrtari publik, vepër kjo nën kompetencën e gjykatës komunale. Sipas dy nga të paraburgosurit, ata kurrë nuk janë informuar për arsyen e arrestimit të tyre. Këta të dy pohojnë se janë rrahur nga oficerët e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), që të dy gjatë arrestit dhe ndamas në paraburgim. Disa nga të paraburgosurit janë liruar më 28 qershor 2000 dhe të tjerët më 29 qershor 2000 – 8 dhe 9 ditë pas paraburgimit të tyre – pa u sjellur para gjyqtarit hetues.

Për disa nga këta të dyshimtë, mbrojtësi informoi SMSL-në se policia e UNMIK-ut nuk ka informuar prokurorin kompetent për arrestimin dhe se nuk ishte bërë fare ndonjë urdhër me shkrim për paraburgimin e tyre. Kjo u vërtetua nga kryetari i Gjykatës Komunale i cili tha se gjykata nuk është informuar lidhur me arrestimin dhe paraburgimin e tyre deri më 30 qershor 2000, kur të dyshimtit ishin të paraburgosur për 8 dhe 9 ditë dhe u liruan. Atë ditë, prokurori i Gjykatës Komunale pranoi një kërkesë për hetime të rastit dhe të dyshimtit u thirrën të paraqiten para gjyqtarit hetues. Sipas LPP-së së RFJ-së autoritetet zbatuese të ligjit duhet t'a njohtojnë menjëherë prokurorin kompetent lidhur me paraburgimin e "urdhëruar" policor. Në këtë rast, prokurori kompetent nuk është njohtuar deri pas 8 ditë paraburgimi.

### ***I paraburgosuri R***

Gjatë natës së 8 korrikut 2000 dhe mëngjesit të 9 korrikut 2000, i paraburgosuri R është arrestuar në Viti nga KFOR-i për shkëljen e orës policore dhe gjoja kundërshtimin e arrestit. Prej asaj dite deri më 27 korrik 2000, kur ai u lirua, është mbajtur në burgun e qarkut në Kampin Bondstill (Bondsteel). Edhe pse KFOR-i raportoi te SMSL-ja se i paraburgosuri R ishte përcjellur për në Gjilan për t'u sjellur para gjyqtarit hetues, ai në fakt kurrë nuk është parë nga një autoritet gjyqësor dhe nuk i ishte siguruar urdhëri për arrest. Si rrjedhim, i paraburgosuri R kaloi rreth 18 ditë në paraburgim pa parë asnjëherë ndonjë autoritet gjyqësor. Në fakt, SMSL-ja nuk kishte mundësi t'a identifikonte ndonjë shkresë të lëndës apo një kërkesë e prokurorit për hetim kundër të paraburgosurit R në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, Gjykatën Komunale të Vitisë apo Gjykatës Komunale në Gjilan.

Këta persona ishin subjekt i paraburgimeve meqë ishin paraburgosur nga policia e UNMIK-ut dhe KFOR-I për periudhë të zgjatur në kundërshtim me LPP-në e RFJ-së dhe pa u sjellur para autoritetit gjyqësor. Pos kësaj, SMSL-ja ka vërejtur se ka persona që janë subjekt i paraburgimeve të tilla të paligjshme në kohën kur po shkruhet ky raport. Për shembull, dy të paraburgosur po mbahen aktualisht nga KFOR-i në Pejë. Dy të paraburgosurit janë arrestuar më 2 gusht 2000 për vjedhje veture. Më 24 gusht 2000, SMSL-ja vizitoi të paraburgosurit, të cilët deri atë ditë nuk janë parë nga gjyqtari hetues. Në atë kohë kishin kaluar 22 ditë që të paraburgosurit mbaheshin të mbyllur pa u sjellur para autoritetit gjyqësor.

Në vazhdim, lidhur me këto raste, disa Komandirë të Burgjeve të Qarkut thanë se ata do t'i mbajnë personat për kohë të pacaktuar deri sa të ketë urdhër për t'i liruar nga policia apo gjykata. Përkundër kësaj, Komandirët e Burgjeve të Qarkut të cilët mbajnë personat më tepër se 24 orë pa urdhër të ligjshëm me shkrim për paraburgim ose nga policia në rrethana të veçanta për 3 ditë ose një autoritet i caktuar gjyqësor ka për obligim t'i lirojë menjëherë këta persona.

### **III. Angazhimi i mbrojtësit gjatë paraburgimit dhe njohtimi mbi të drejtat**

Para sjelljes para autoritetit gjyqësor, standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut sigurojnë masa të tjera kundër arrestimit dhe paraburgimit arbitrar, veçanërisht të drejtën për ndihmë nga mbrojtësi ligjor. Parimet Themelore të KB-ve mbi Rolin e Avokatëve u japin të drejtën personave për mbrojtës ligjor në të gjitha fazat e procedurës penale, duke përfshirë edhe kohën e marrjeve në pyetje.<sup>15</sup> Në përkufizimin e afatit kohor për angazhimin e mbrojtësit, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerëson se një vonesë e angazhimit prej 48 orësh është e tepruar.<sup>16</sup> Afati kohor prej 48 orësh pasqyrohet në Parimin 7 të *Parimeve Themelore mbi Rolin e Avokatëve*. Kjo e drejtë është thelbësore në mënyrë që të parandalohen shkeljet e të drejtave themelore të njeriut të të tjerëve siç është e drejta e mbrojtjes efektive si gjatë procesit para-gjykimin ashtu edhe atij të gjykimin. Përpos kësaj, personat e arrestuar dhe të paraburgosur kanë të drejtë të informohen menjëherë për arsyen e arrestimit,<sup>17</sup> për të drejtën e heshtjes<sup>18</sup> dhe të të drejtën për t'a informuar anëtarin e familjes apo shokun vetë apo përmes autoriteteve lidhur me arrestimin e tyre dhe vendin e paraburgimit.

Në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, LPP-ja e RFJ-së nuk siguron angazhim të menjëhershëm të mbrojtësit.<sup>19</sup> Siç u përmend më lartë, megjithatë, LPP-ja e RFJ-së udhëzon autoritetet zbatuese të ligjit t'i sigurojnë të paraburgosurit qasje në ndihmë ligjore për t'ia dhënë mundësinë e kundërshtimit të paraburgimit të urdhëruar nga policia. Poashtu, LPP-ja e RFJ-së obligon autoritetet zbatuese të ligjit t'a njohtojnë familjen e të arrestuarit dhe paraburgosurit brenda 24 orësh nga arrestimi.<sup>20</sup>

Në rastet e të paraburgosurit S, 6 shqiptarëve dhe Arsim e Arben Bajramit, familjet e personave të paraburgosur angazhuan mbrojtës privat gjatë kohës kur ata po mbaheshin në paraburgim. Megjithatë, asnjëri nga mbrojtësit nuk ishte i pranishëm në asnjërin marrje në pyetje të të paraburgosurve. Në fakt, gjatë gjykimin të Peter Muriukit, Arben dhe Arsimi Bajramit, një oficer i SHPK-së dëshmoi se gjatë dëgjimit të Arben Bajramit, Arbeni qartë ka kërkuar praninë e mbrojtësit gjatë dëgjimit të vet. Kjo kërkesë u mohua. Oficeri i SHPK-së poashtu dëshmoi se gjatë dëgjimeve, sipas tij, Peter Muriuki poashtu kërkoi një avokat dhe kontaktimin e punëdhënësit të tij. Kjo kërkesë u mohua poashtu. Gjatë kohës së paraburgimit policor, të paraburgosurit u janë nënshtruar testeve të poligrafit<sup>21</sup>. Si rrjedhim, çështja primare e ngritur në gjykimin e Peter Muriukit, Arben e Arsim Bajramit ishte zhvillimi i hetimeve të policisë në bazë të mbledhjes së deklaratave të dëshmitarëve okularë të dhëna në polici. Me thirrjen e policëve si dëshmitarë, prokuroria pyeti rreth kredibilitetit të deklaratave të të pandehurve dhe dëshmitarëve lidhur me sjelljen e policisë. Dispozita mbi mbrojtësin me kërkesën e të pandehurit gjatë

dëgjimit do t'a kishte mbrojtur kundër kësaj dhe së fundi siguruar më shumë drejtësi në procedurë. Më 21 gusht 2000, Peter Muriuki, Arben e Arsim Bajrami u shfajësuan nga krimi I vjedhjes dhe u liruan nga paraburgimi.

Sipas Buletinit 15 të policisë së UNMIK-ut, I cili u botua pas paraburgimit të Arben e Arsim Bajramit, policia e UNMIK-ut duhet t'a informojë personin për arsyen e arrestimit, të drejtën e heshtjes dhe mosdhënies së deklaratave, të drejtën e informimit të familjes apo punëdhënësit për paraburgimin, të drejtën e kontaktimit të avokatit para dhënies së çdo deklaratave autoriteteve të arrestimit. Edhe pse Buletini siguron këto të drejta, SMSL-ja ka vërejtur se ka pasur dështime në zbatimin e këtyre rregullave pas paraqitjes së tyre, për shembull, familja e të paraburgosurit S nuk kishte qenë e informuar për arrestimin e tij dhe vendin e paraburgimit deri pas 4 ditësh nga paraburgimi I tij. Pas kësaj, SMSL-ja shënon se ende është praktikë e zakonshme për policinë e UNMIK-ut dhe KFOR-in t'I marrë në pyetje të paraburgosurit pa prezencën e mbrojtësit. Megjithatë, UNMIK-u aktualisht po përpiqet t'a adresojë çështjen e mbrojtësit që nga momenti I arrestimit.

#### **IV. Supozimi I pafajsisë dhe e drejta e gjykimit përbrenda afatit të arsyeshëm kohor apo e lirimimit në pritje të gjykimit**

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut sigurojnë supozimin e lirimimit në pritje të gjykimit në pajtim me parimet themelore mbi supozimin e pafajsisë dhe të drejtën e lirisë dhe sigurisë së personave. Sipas nenit 9(3) I KNDCP-së dhe nenit 5(3) personat e arrestuar apo të paraburgosur kanë të drejtë “të gjykimit përbrenda afatit të arsyeshëm kohor apo të lirimimit në pritje të gjykimit.” Kjo është interpretuar ashtu që do të thotë se autoritetet duhet të veprojnë me përshtatshmëri dhe shpejtësi të posaçme kur një I pandehur është subjekt I privimit të lirisë para se të vërtetohet se është fajtor për vepër penale. Lidhur me të dyshimtit e mitur, standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut obligojnë që “arrestimi, paraburgimi apo burgimi I fëmiut duhet të ndërmerret si masë e fundit... dhe për kohën më të shkurtër.”<sup>22</sup>

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pohuar se autoritetet duhet të paraqesin “arsye përkatëse dhe të mjaftueshme” për t'a arsyetuar paraburgimin.<sup>23</sup> Komiteti I të Drejtave të Njeriut interpreton KNDCP-në si lejim të paraburgimit, por vetëm kur është e ‘nevojshme’, që duhet të interpretohet ngushtë. Si KEDNJ-ja ashtu edhe KNDCP-ja pranojnë se paraburgimi mund të urdhërohet në bazë të nevojës së parandalimit të ikjes, ngatërrimit të rrjedhës së drejtësisë, parandalimit të krimit dhe ruajtjes së rendit publik. Judikatura e Gjykatës Evropiane siguron udhërrëfyesit mbi faktorët specifik të nevojshëm për urdhër paraburgimi me cilëndo nga këto katër arsye. Në urdhëresën për paraburgim, autoritetet janë të obliguara sipas KEDNJ-së t'I “shqyrtojnë të gjitha faktet argumentuese pro dhe kundër ekzistimit të një kërkesë të përgjithshme të interesit publik, duke u arsyetuar me të drejtë në drejtim të parimit të supozimit të pafajsisë, shmangjen nga rregulla për respektimin e lirisë individuale dhe I vendosë ato jashtë tyre....”<sup>24,</sup>

Gjatë kohës së paraburgimit të paraburgosurit kanë të drejtë t'a kundërshtojnë paraburgimin në mënyrë që të sigurohet se paraburgimi është absolutisht I nevojshëm për përparimin e procedurës penale, se gjykimi mbahet brenda afatit të arsyeshëm kohor dhe



se hetimi është zhvilluar me ekspeditivitet. Në mënyrë që të mbrohet efektivisht e drejta e kundërshtimit, autoritetet mund të sigurojnë shqyrtime periodike të paraburgimit, dhe më tej, mund t’I japin të drejtë të paraburgosurit të inicojë rishqyrtim sipas vullnetit të tij/saj. Për më tepër, aty ku ka pasur mjaft ndryshime në rrethanat e të paraburgosurit, duhet të zhvillohet një proces përmes të të cilit kundërshtohen arsyet për paraburgim të vazhduar.

Forumi pranë të cilit është kundërshtuar paraburgimi duhet të marrë formën e gjykatës dhe duhet të garantojë proces gjyqësor<sup>25</sup>. Në bazë të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut është e qartë se ky proces mund të jetë kontraditor, duke garantuar barazinë e autoriteteve dhe elementeve të ndryshme kushtetuese të një gjykimi të drejtë<sup>26</sup>. Këto elemente përfshijnë dëgjimin oral para një tribunali të pavarur dhe të paanshëm; qasjen në përfaqësim efektiv ligjor.<sup>27</sup>; dhe të drejtën e prezentimeve të personit apo përmes përfaqësuesit ligjor; dhe vendimin plotësisht të arsyetueshëm që bazohet në urdhërin për vazhdimin e paraburgimit.

#### **(a) Ligji vendas mbi paraburgimin**

LPP-ja e RFJ-së pohon se “*askush nuk mund të konsiderohet fajtor për veprë penale derisa kjo gjë të mos jetë vërtetuar me aktgjykim me formë të prerë.*”<sup>28</sup> Sipas LPP-së së RFJ-së paraburgimi duhet të mbahet sa më shkurt dhe vendos obligimin “të procesohet me shpejtësi të veçantë nëse I pandehuri gjendet në paraburgim.”<sup>29</sup>

Në rastet e të miturve, LPP-ja e RFJ-së obligon autoritetet të “procesojnë me shpejtësinë më të madhe ashtu që procedura të përfundojë sa më shpejtë<sup>30</sup>.” Sipas LPP-së së RFJ-së paraburgimi I të dyshuarve të mitur duhet të urdhërohet si *një përjashtim* me ç’rast arsyet për paraburgim para-gjyqësor ekzistojnë<sup>31</sup>. Si përparësi ndaj paraburgimit, LPP-ja e RFJ-së kërkon që gjykata të urdhërojë vendosjen e të miturve në ambient alternativ.<sup>32</sup> Nëse urdhërohet paraburgimi, LPP-ja e RFJ-së kërkon që një paraburgim I tillë duhet të urdhërohet për një muaj dhe më së shumti deri në tre muaj për arsye të justifikueshme<sup>33</sup>. Pos kësaj, sipas LPP-së së RFJ-së obligohet që gjykimi I filluar I një të mituri, të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur.<sup>34</sup> Vonesat në procedurat para dhe gjatë gjykimit të të miturve duhet saktësisht të monitorohen dhe në disa raste të autorizohen nga Kryetari I Gjykatës<sup>35</sup>. Gjatë gjykimit të një të mituri, gjykata obligohet të “jetë e kujdesshme, e ndërgjegjshme për zhvillimin mendor, ndjeshmërinë dhe karakteristikat personale të të miturit, ashtu që zhvillimi I procedurës penale mos të ketë efekt të pafavorshëm në zhvillimin e të miturve.”<sup>36</sup>

Nën nenin 191(2) të LPP-së së RFJ-së paraburgimi mund të urdhërohet nëse njëra nga katër arsyet vijuese për paraburgim ekziston:

- i. kur fshihet apo nuk mund të vërtetohet identiteti I tij apo kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë rrezikun e ikjes;
- ii. kur ekziston frika e bazuar se do t’I asgjësojë gjurmët e veprës penale apo kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë hetimin duke ndikuar në dëshmitarë, në bashkëpjesëmarrës ose në personat që fshehin veprën penale;

- iii. kur rrethanat e posaçme e arsyetojnë frigën se do t'a përsërisë veprën penale ose do t'a përfundojë veprën e tentuar penale, ose do të bëjë vepër penale me të cilën kërcënon;
- iv. kur është fjala për veprën penale për të cilën sipas ligjit mund të jepet dënimi prej dhjetë vjet burgim ose dënimi më I rëndë dhe nëse për shkak të mënyrës së ekzekutimit, të pasojave apo rrethanave të tjera të veprës ka shkaktuar ose ka mundur të shkaktojë një shqetësim të atillë të qytetarëve që për zhvillimin pa pengesa të procedurës penale ose të sigurisë së njerzëve është **i nevojshëm** caktimi I paraburgut.<sup>37</sup>

Një urdhër I paraburgimit duhet të bëhet përmes vendimit me shkrim I cili shërben si bazë ligjore dhe një vërtetim në të cilin argumentohet saktësisht arsyeja e caktimit të paraburgimit.<sup>38</sup>

Kundër një urdhëri të paraburgimit para aktakuzës nga gjyqtari hetues mund të paraqitet ankimi te kolegji I gjyqtarëve të cilët duhet të vendosin mbi ankesën përbrenda 48 orësh. Pas periudhës fillestare të paraburgimit prej një (1) muaji, paraburgimi mund të zgjatet për më së shumti edhe dy (2) muaj. Ekziston e drejta e ankesës kundër këtij vendimi. Nëse paraburgimi është caktuar në rastet kur një person ndjeket për vepër penale që mban dënimin prej mbi pesë (5) vjet, kolegji I Gjykatës Supreme të Kosovës mund t'a zgjasë paraburgimin për tre (3) muaj të tjerë. Sipas Rregullores 1999/26, kjo periudhë mund të zgjatet deri në 12 muaj para lëshimit të aktakuzës.<sup>39</sup>

Sipas LPP-së së RFJ-së, kur pushojnë shkaqet në bazë të të cilave ka qenë caktuar paraburgimi, ky I fundit do të hiqet.<sup>40</sup> Nëse paraburgimi nuk hiqet nga gjyqtari hetues përbrenda periudhës së caktuar me ligj dhe aktakuza nuk është ngritur, I paraburgosuri ka të drejtë të lirimimit të menjëhershëm.

Pasi që aktakuza është ngritur e deri në fund të gjykimit, paraburgimi mund të caktohet apo hiqet në bazë të vendimit të kolegjit pas dëgjimit të prokurorit publik dhe duhet të rishqyrtohet nga kolegji çdo dy muaj. Kundër këtyre vendimeve mund të paraqitet ankesë.<sup>41</sup>

Gjatë kohës së paraburgimit, në LPP-në e RFJ-së nuk parashihet e drejta e përfaqësimit personal në ankimin ndaj urdhërave për paraburgim apo në kërkesën për dorëzani. Këto ankesa gjithmonë mbahen pa praninë e mbrojtësit dhe të paraburgosurit.

#### **(b) Periudhat e zgjatura të paraburgimit**

Duke pasur parasysh faktin se UNMIK-u ka pasur përsipër ri-vendosjen e sistemit gjyqësor në Kosovë që nga korriku 1999, paraburgimet e zgjatura kanë qenë çështje e rëndësishme shqetësuese lidhur me të drejtën e të pandehurve gjatë SEGJ-së. Megjithatë, SMSL-ja ka vërejtur se disa persona vazhdojnë të mbahen për periudha të zgjatura në paraburgim pa aktakuzë apo gjykim gjë që ndikon ashpër në të drejtën e të paraburgosurve për gjykim pa vonesë të paligjshme apo atë të lirimimit. SMSL-ja ka konstatuar se rastet e zgjatjes së periudhës së paraburgimit rëndon në mënyrë

joproportionale serbët e Kosovës. SMSL-ja ka vërejtur se në disa raste të të miturve, gjykatat kanë dështuar të veprojnë me shpejtësinë e kërkuar duke marrë parasysh rastin se duhet siguruar se paraburgimi I të miturve mbahet sa më shkurt.

## **Serbët e Kosovës**

Edhe pse disa serbë të Kosovës të cilët ishin paraburgosur për rreth një viti janë gjykuar, disa kanë mbetur në këtë moment ende në paragjykim. Për shembull, Slobodan Joksimović (Slobodan Joksimovic ) është paraburgosur që nga 9 korriku 1999. Edhe pse gjykimi I Joksimovićit është datuar të mbahet në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 1 qershor 2000, është shtyer për afat të pacaktuar. Raste tjera të serbëve të Kosovës janë shtyer për afat të pacaktuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Për shembull, gjykimet e Lubomir Stoliqit (Ljubomir Stolic ) për tentativë vrasjeje, I cili ishte paraburgosur që prej 11 korrikut 1999 dhe Milosh Skulliçit (Miloš Skulic ) për vrasje, I cili ishte paraburgosur më 23 qershor 1999 dhe paditur, janë shtyer për afat të pacaktuar.<sup>42</sup>

Shtatë serbë të paraburgosur të Kosovës janë paditur tash vonë në Gjykatën e Qarkut në Prizren pak para se t'a mbushnin një vjet paraburgimi, kur do t'a kishin të drejtën e lirimit. Gjykimi I të shtatëve duhet akoma të caktohet. Nëntë të dyshimtë të tjerë të përkatësisë së minoriteteve, janë të paraburgosur në Burgun e Qarkut në Mitrovicë nën kompetencën e Gjykatës së Qarkut në Prizren. Këta të nëntit janë ende nën hetime dhe po e arrijnë kufirin njëvjeçar të paraburgimit para aktakuzës në shtator dhe tetor 2000.

Në njërin nga këto raste të serbëve të Kosovës, I dyshimti D, I cili ishte paraburgosur që nga tetori 1999, policia e UNMIK-ut ka kërkuar lirimin e tij. Referenca e policisë së UNMIK-ut bazohet në faktin se hetimi I tyre I rastit nuk ka zbuluar dëshmi që e përkrahin akuzën, posaçërisht që asnjëri nga dëshmitarët nuk mundi t'a identifikojë fotografinë e të dyshimitit si autor krimi. D ka qenë I paraburgosur për 10 muaj<sup>43</sup>. Në një rast të ngjashëm, I dyshimti M është paraburgosur më 24 shtator 1999. Më 29 tetor 1999, prokurori I Gjykatës së Qarkut në Prizren është informuar nga policia e UNMIK-ut se asnjë dëshmitar nuk mund t'a pohonte identitetin e të dyshimitit si kryes të krimit nga fatografia. Pas një vonese prej shtatë muajsh në paraburgim, gjykata ndërpreu hetimet dhe M u lirua më 20 prill 2000 në bazë të faktit se dëshmitarët nuk mundën t'a përkrahin ndjekjen. Në rastin e të dyshimitit M Gjykata e Qarkut në Prizren ka shkelur qartë obligimin e tyre për të vepruar me shpejtësi kur I pandehuri është në paraburgim.

## **Të miturit**

Më 13 shtator 1999, dy të mitur u arrestuan si bashkë-ekzekutor të vrasjes gjoja të kryer nga një I rritur I bashkë-dyshimti. Rregulla e përgjithshme në LPP-në e RFJ-së është që të miturit duhet të gjykohen ndamas nga madhorët duke përdorur procedurë të posaçme për të miturit.<sup>44</sup> Megjithatë, në këtë rast, gjykata vendosi se rastet duhet të bashkangjiten me qëllim të gjykimit nën dispozitën e veçantë të rregullës sipas LPP-së së RFJ-së<sup>47</sup>. Edhe pse është caktuar që gjykimi të mbahet më 23 dhjetor 1999, ai u shtye për shkak të çështjes së dënimit të mundshëm të duhur për të dyshimtin madhor pas heqjes së dënimit me vdekje nga Rregullorja 1999/24. Çështja e dënimit të mundshëm për të rriturin nuk

kishte të bëjë me situatën e të miturve në rast. Megjithatë, gjykata nuk I ka ndarë rastet në mënyrë që t’I gjykojë të miturit në dhjetor. Për më tepër, dy të miturit mbetën në paraburgim, në burg të të rriturve, për nëntë muaj, deri më 28 qershor 2000, kur u gjykuan bashkë me bashkë-të-pandehurin. Nuk kishte arsye të justifikueshme për vonesën e gjykimit të të miturve në këtë rast duke pasur parasysh faktin se dispozita për bashkangjijtjen e rastit të të miturit dhe të rriturit është zgjedhje e gjykatës. Si rrjedhim, gjykata dështoi që, sipas LPP-së së RFJ-së dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, t’I sjellë këta të paraburgosur të mitur në gjykim brenda kohës mundësisht më të shkurtër.

Një tjetër I mitur, serb I Kosovës I cili mund të jetë se vuan nga një formë e të metës mendore, është paraburgosur për shkak të ndjekes për gjenocid që nga 27 shtatori 1999 pavarësisht nga fakti se hetimet kundër tij kanë përfunduar më 23 dhjetor 1999. Edhe pse gjykimi është caktuar për datën 10 korrik 2000, ai është shtyer deri më 14 gusht 2000 me kërkesën e prokurorit ndërkombëtar. SMSL-ja është informuar nga Kryetari I Gjykatës se ai nuk është pajtuar me këtë pezullim. SMSL-ja mësoi se në fillim të gjykimit, prokurori ndërkombëtar përmirësoj ndjekjet nga gjenocidi në “shkaktim I rrezikut të përgjithshëm.” Në këtë kohë, I mituri kishte kaluar gati një vit në paraburgim. Pos kësaj, më 16 gusht emri I të miturit u botua në një deklaratë shtypi të UNMIK-ut<sup>48</sup>.

Botimi I emrit të të miturit ishte shkelje e ligjeve vendase dhe ndërkombëtare, të cilat kërkojnë t’a ruajnë identitetin e të miturve. Për më tepër, në këtë rast kishte vonesë të paarsyeshme të gjykimit duke marrë parasysh faktin se në mes të përfundimit të hetimeve kundër këtij të mituri dhe gjykimit ku ndjekjet dukshëm janë redukuar ishte një periudhë prej tetë muajsh. Si pasojë, gjykata nuk përfilli obligimet e tyre për të vepruar “sa më shpejtë” lidhur me këtë të mitur siç obligohet nga ligji vendas dhe ai ndërkombëtar.

Në një rast tjetër, një I mitur është paraburgosur më 27 shtator 1999 pasi që kishte pranuar se kishte qëlluar një tjetër të ri joqëllimisht në rast vetë-mbrojtjeje. I është raportuar SMSL-së, pas këtij fakti, se gjatë periudhës së tij në paraburgim para gjykimit, I mituri ka tentuar të bëjë vetëvrasje, por nuk kishte pranuar trajtim të duhur. Procedura e gjykimit që zgjati rreth 4 muajsh, përfshinte rekonstruimin e vendit të ngjarjes në mes të qytetit, ku të miturit duhej të rrinin me pranga në rrugë dhe t’a ri-luajnë krimin për rreth 5 orësh. Me rastin e përfundimit të gjykimit më 27 qershor 2000 dhe të dëgjimit të dënimit të propozuar me 7 vite burgim, I mituri u shqetësua dukshëm dhe filloi të godasë e qëllojë orenditë. Pas gjykimit, në bazë të një vlerësimi psiçik të të miturit u konkludua se, para akuzimit dhe paraburgimit të tij, I mituri vuante nga ç’rregullime të stresit post-traumatik dhe pas asaj kërkohet mjekim intenziv. Gjatë periudhës nëntë-mujore në paraburgim dhe asaj katër-mujore në gjykim, gjykata duhet të kishte bërë përpjekje më të mëdha për t’a përfunduar këtë gjykim sa më shpejtë që të ishte e mundur. Në pajtim me këtë, duket se gjykata nuk ka përfillur gjendjen e shëndetit psikik të të miturit dhe nuk e ka trajtuar atë me kujdes të duhur, përkundër obligimit të gjykatës për të siguruar se rrjedha e procedurës penale nuk ndikon jofavorshëm në zhvillimin e të miturit<sup>49</sup>.

Në rastin e të miturit, I cili është Shqiptar, një gjykatë në Prizren mbajti të miturin në një qendër të paraburgimit për të rriturit për më tepër se 6 javë, duke e ngarkuar atë për

vjedhje të automjetit në Prishtinë. Shkresat e lëndës përmbasnin një qertifikatë nga Spitali I Neuro-psikiatrisë së Shqipërisë të datuar 1 Gusht 2000, I cili deklaroi se I mituri ishte “mentalisht I sëmurë” dhe nën kujdesin e përhershëm mjekësor. Në ditën e fundit të gjyqimit, I cili ishte shtyrë dy herë, mbrojtësi I të miturit nuk u paraqiti pasiqë siq thuhet dy ditë më parë ishte emëruar gjykatës. Si rezultat, gjykatësi për të mitur e luti sekretarëshën e gjykatës që të gjente ndonjë mbrojtës në ndërtesë. Mbrojtësi I cili asnjëherë më parë nuk ishte ndërlidhur në rast u paraqiti dhe bisedoi me të miturin për dy minuta. Ai asnjëherë nuk rishqyrtoi shkresat e lëndës . Gjatë kësaj kohe në gjykim, gjykatësi për të mitur I dha dëshmitarit që të lexonte shkresat e lëndës pasiqë ai më parë tha se “ nuk I kujtoheshin të gjitha lidhur me rastin.” Babai I të miturit I cili ishte prezent në gjykim por I cili mëpastaj gjatë pushimit dual jashtë, nuk u ftua në gjykatore për pjesën tjetër të procedurës. Fakti se I mituri posedonte pashaportë, (nuk ishte I tij) të vulosur me datë të hyrjes në Kosovë, 4 ditë pas vjedhjes së raportuar në Prishtinë, asnjëherë nuk u përmend në gjykim edhe pse ajo mbështeste tregimin e të miturit. Nuk u prezentuan prova gjatë gjyqimit se I mituri kishte qenë ndonjëherë në Prishtinë, I lënë vetëm në kohën e vjedhjes. Në fund të procedurës, gjykatësi gjeti të miturin fajtor për vjedhje automjeti por e dënoi me” mbikqyrjen e shtuar nga prindërit”. I mituri mëpastaj ishte liruar.

Më 22 gusht 2000, Departamenti I Drejtësisë lëshoi një udhërrëfyes për gjykatat duke I përkujtuar ato mbi obligimet e tyre sipas ligjit vendas lidhur me procedurat për të miturit<sup>50</sup>. Kjo ndërlidhet me një udhërrëfyes të mëhershëm për gjykatat ku theksohet se periudha më e gjatë e paraburgimit të të miturve I vendosur nga ligji vendas është tre muaj.<sup>51</sup>

### **(c) Urdhërat për paraburgim**

Shumë, nëse jo shumica, e vendimeve për paraburgim nga gjykatat e qarkut dhe Gjykatës Supreme në Kosovë dështojnë të vlerësojnë fakte dhe rrethana të caktuara që kanë të bëjnë me rastin e individit, të cilat autorizojnë detyrimin për paraburgim. Në fakt, në disa vendime për paraburgim, gjykata vetëm përsërit formulimin e arsyeve të LPP-së së RFJ-së për paraburgim pa dhënë asnjë fakt lidhur me rastin e individit që përkrah privimin e lirisë. Për shembull, në rastin e Nazime Hamitit, në vijim, gjykata thjesht përsëriti fjalë për fjalë nenin 191 alinenë 2 pikën 2. Poashtu, SMSL-ja ka vërejtur se shumë vendime duket të jenë esencialisht të mbështetura në dyshimin e bazuar se një individ ka kryer veprë penale. Për shembull, vendimi për zgjatjen e paraburgimit nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë pohon se, “Kjo gjykatë ka arsye për këtë vendim si dhe personi në fjalë do të ndjeket për kanosje seksuale me dhunë...”

Praktika e dështimit në sigurimin e fakteve të caktuara të cilat autorizojnë urdhërin për paraburgim në bazë të një apo më shumë nga katër arsyet ligjore shkel si LPP-në e RFJ-së ashtu edhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. LPP-ja e RFJ-së dhe ligji ndërkombëtar I të drejtave të njeriut kërkojnë argumentim të veçantë në përkrahjen e privimit të lirisë së një personi para se të është vërtetuar se është fajtor për kryerjen e veprës penale. Pos kësaj, ligji ndërkombëtar I të drejtave të njeriut rreptësisht e ndalon

urdhërin për paraburgim vetëm në mbështetje të dyshimit të bazuar se personi I paraburgosur ka kryer vepër penale.

#### **(d) Paraburgimi I bazuar në ruajtjen e rendit publik**

Praktika e dështimit në sigurimin e vendimeve të arsyeshme për një urdhër për paraburgim është posaçërisht shqetësuese kur merret parasysh detyrimi në nenin 191 (2)(4) që është arsyeja për paraburgim në bazë të ruajtjes së rendit publik. Për shembull, një zgjatje e paraburgimit të një serbi të Kosovës bazuar në këtë është arsyetuar se “kundër të akuzuarit tashmë është ngritur aktakuza”, lirimi I tij do të shkaktonte trazira në popullsi apo do të kishte paraqitur pengesë në zhvillimin e procedurës penale. Zbatimi aktual I nenit 191 (2)(4) nga gjykatat mund të përfundojë me paraburgime arbitrare.

#### ***Enes Haxhialjeviq***

Më 1 prill 2000, *Haxhialjeviq* është arrestuar derisa ishte I pranishëm në një banesë të shokëve ku u gjet më tepër se 1 kilogram marihuanë. Pasi që është marrë në pyetje, Haxhialjeviq është liruar nga policia e UNMIK-ut ditën e nesërme. Dy të dyshimit tjerë të këtij rasti mbetën në paraburgim. Më 10 prill 2000, Haxhialjeviq erdhi në gjykatë për t’u intervistuar nga gjyqtari hetues. Meqë gjyqtari hetues nuk ka pasur kohë të takohet me të atë ditë, ai është lutur të kthehet. Ditën e nesërme më 11 prill 2000, Haxhialjeviq është kthyer për t’u dëgjuar nga gjyqtari hetues. Pas dëgjimit, SMSL-ja është informuar se është urdhëruar paraburgimi I Haxhialjeviqit në bazë të nenit 191 (2), (3) dhe (4). Haxhialjeviqi vullnetarisht shkoi në Burgun e Qarkut në Prishtinë ku i është refuzuar hyrja për shkak se nuk ka qenë I përcjellur nga policia e UNMIK-ut. Ditën e nesërme më 12 prill 2000 Haxhialjeviq është përcjellur deri në burg.

Paraburgimi I *Haxhialjeviqit* është urdhëruar për shkak të “rrethanave të caktuara të cilat e arsyetojnë frikën se krimi do të përsëritet” dhe se “mënyra e zbatimit, konsekuencat apo rrethanat e tjera të veprës penale kishte apo mund të ketë shqetësim të tillë në popullatë ashtuqë urdhëri për paraburgim është [menjëherë] **I duhur** për hir të zhvillimit të papengueshëm të procedurës penale apo sigurisë së njeriut.” Gjatë më tepër se dhjetë ditësh pas lirimimit të tij nga paraburgimi, nuk kishte asnjë dëshmi që do të parashihte se Haxhialjeviq do t’a përsëriste veprën penale. Haxhialjeviqi nuk kishte prapavijë penale. Dëshmija e vetme e mbledhur dhe e prezentuar në gjykim ishin deklaratat e tre të pandehurve. Në kohën kur Haxhialjeviq është dëgjuar nga gjykatësi hetues, dy dëshmitarët tjerë kishin dhënë deklaratat e tyre dhe hetimet përkatëse kishin përfunduar. Gjykatësi hetues informoi SMSL-në se në dëgjimin e të pandehurve të tjerë, ai ishte I sigurtë se Haxhialjeviq kishte qenë nxitësi kryesor I veprës penale dhe ai kishte urdhëruar paraburgimin e tij sepse bashkë-të-pandehurit ishin në paraburgim. Për më tepër, gjyqtari hetues theksoi se për shkak të rendit publik është arsyetuar paraburgimi për një vepër të tillë.

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ndalojnë qartë përdorimin e dyshimit të arsyetuar se një person ka kryer vepër penale si arsye e vetme për paraburgim. LPP-ja e RFJ-së qartë pohon se paraburgimi duhet të jetë [menjëherë] **I duhur** për t’u siguruar

kundër kërcënimit ndaj rendit publik. Sipas KEDNJ-së, duhet të ketë dëshmi për atë se lirimi do të kishte në të vërtetë pasojë në trazimin e rendit publik<sup>52</sup>. SMSL-ja shënon se gjatë më tepër se dhjetë ditësh që Haxhialjeviq ishte liruar nga paraburgimi, nuk kishte trazim të rendit publik për shkak të lirimit të tij. Pos kësaj, paraburgimi I një individi duhet të rrjedhë nga faktet e caktuara që kanë të bëjnë me rastin e individit dhe nuk duhet të urdhërohen në bazë të asaj se bashkë-të-pandehurit janë paraburgosur, siç është praktikë e zakonshme në gjykata.

### ***I paraburgosuri B***

*I paraburgosuri B* ishte paraburgosur me fëmijën e saj që nga 18 maji 2000. Ajo ndjeket për vrasjen e bashkëshortit të saj për të cilin ajo ka pranuar se e ka qëlluar pa qëllim. Paraburgimi I të paraburgosurit B është bazuar, së paku pjesërisht, në nenin 2 (4) në atë se nëse ajo do të lirohej mund të kishte “trazim të tillë në popullatë kështuqë urdhëri për paraburgim është **[menjëherë] I duhur** për hir të zhvillimit të papengueshëm të procedurës penale apo sigurisë së njeriut apo ruajtjes së rendit publik.” SMSL-ja është informuar nga gjyqtari hetues se krimet serioze siç janë vrasjet e arsyejnë paraburgimin. Ai shpjegoi më tutje se ai përkrahu detyrimin e nenit 191 (2) (4) sepse banorët e fshatit të të paraburgosurit nuk do të kuptonin nëse I dyshimti për një vepër aq serioze penale do të lirohej. Gjyqtari përsëriti se serioziteti I veprës arsyeton paraburgimin.

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ndalojnë aplikimin e paraburgimit vetëm për shkak të seriozitetit të veprës. Pos kësaj, SMSL-ja shënon se shumë persona të dyshimtë për kryerjen e veprave me seriozitet të tillë si vrasjes janë liruar nga paraburgimi. Për shembull, i dyshimti F, anëtar i Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), organizatës civile që rrjedh nga demilitarizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ishte i kyqur në një seri këmbim-zjarri të profilit të lartë në qendrën e Prishtinës që rezultoi në vdekjen e Komandantit të mirënjohur të TMK-së (ish UÇK-së) dhe të një viktime tjetër. F është ndjekur për vrasje lehtësuese në vetë-mbrojtje, “vrasje e kryer në mbrojtje të pashmangshmërisë,” pavarësisht nga fakti se ekspertët ballistikë tregojnë se viktima është qëlluar në shpinë. Përkundër të paraburgosurit B dhe fëmijës së saj, F është liruar nga paraburgimi pas arrestimit të tij. Pos kësaj, kërkesa nën LPP-në e RFJ-së dhe KEDNJ-në se paraburgimi është menjëherë I duhur për mbrojtjen kundër trazimit të rendit publik kërkon standard më të lartë lidhur me kanosjen e rendit publik se sa shpjegim nga gjyqtari hetues në rastin e të paraburgosurit B.

### ***Nazime Hamiti***

*Hamiti*, analfabete 21 vjeçare, është arrestuar dhe paraburgosur e ndjekur për vrasje pasi që kishte mbytur foshnjën e saj pas lindjes në spitalin e Prishtinës. Hamiti u ankua se foshnja ishte rezultat I dhunimit dhe se ajo ishte aq e dëshpruar pas lindjes saqë nuk ishte e vetëdijshme se po e vriste foshnjën e saj. Pavarësisht nga kjo, prokurori e paditi për vrasje e jo për krim infanticid. Gjatë dëgjimit të z. Hamiti para gjyqtarit hetues dhe gjykimit të saj, SMSL-ja vërejti se ajo tregoi shenja serioze të shqetësimit emocional. Paraburgimi I z. Hamiti u urdhërua në bazë të nenit 191 (2) (1), (2) dhe (4). Pika 1 kërkon rrethana të cilat “kërkojnë mundësi të mëdha të ikjes” dhe pika 2 kërkon “frikë të

justifikuar se I dyshimi do t'i asgjësojë gjurmët e krimit apo nëse rrethana të veçanta dëshmojnë” se I dyshimi do t'i pengojë hetimet duke ndikuar në dëshmitarët.

Urdhëri për paraburgim në rastin Hamiti thjesht e ri-pohoi atë që thuhet në Seksionin 2 pa siguruar kurrëfarë rrethana të veçanta që tregojnë se Hamiti do të mund t'i influenconte dëshmitarët, që ishin mjekët dhe motrat medicinale nga spitali I Prishtinës. Pos kësaj, nuk kishte gjurmë të krimit të cilat Hamiti do të mund t'i asgjësonte. Poashtu, vendimi nuk ka siguruar fakte specifike të cilat përkrahin imponimin e Seksionit 1, frikën nga ikja. Arsyeja përfundimtare për paraburgim ishte ajo e ruajtjes së rendit publik, gjë që nuk ishte provuar nga rrethana të posaçme që do të përkrahnin atë se paraburgimi I z. Hamiti ishte menjëherë 'I duhur'. SMSL-ja potencon se ligji ndërkombëtar I të drejtave të njeriut ndalon aplikimin e paraburgimit si dënim për veprat penale të perceptuara si moralisht të dënueshme para se të vërtetohet se personi është fajtor.

Praktika aktuale e gjykatave të Kosovës në kërkimin e arsyeve për paraburgim zgjon çështjen e angazhimit të gjykatave në supozimin e pafajësisë. SMSL-ja sipas diskutimeve me zyrtarët e gjykatave, ka shënuar se besimi i tyre në fajësinë e personave apo dënueshmëria etike e veprimeve të tyre pretenduese luajnë një rol të rëndësishëm në vendimet e tyre lidhur me paraburgimet.

#### **(e) Kundërshtimi i Urdhërave për Paraburgim**

Praktikat aktuale në detyrimin e paraburgimit në Kosovë vështirësojnë së tepërmi kundërshtimin e vendimeve për paraburgim. Midis shkurtit dhe 31 korrikut 2000, kishte 71 sugjerime Gjykatës Supreme për vazhdimin e paraburgimit, dhe Gjykata miratoi që të gjitha 71 propozimet. Në fakt, SMSL-ja nuk din për asnjë rast në të cilin detyrimi për paraburgim është përmbysur nga një gjykatë më e lartë.

Për shkak të faktit se paraburgimet privojnë lirinë e personit para se të dihet se ai ka kryer vepër penale, standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që vendimet për paraburgim të mund të rishqyrtohen dhe kundërshtohen rregullisht. SMSL-ja theksoi më parë se LPP-ja e RFJ-së nuk përputhet me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe as dispozitat mbi rishqyrtimin e vendimeve për paraburgim nuk sigurojnë një forum efektiv për rishqyrtim të tillë.

#### **REKOMANDIMET E SMSL-së**

1. Secili që privohet nga liria e vet pavarësisht nga urdhëri i ligjshëm për lirim nga një autoritet gjyqësor duhet të lirohet menjëherë.
2. UNMIK-u duhet të themelojë menjëherë një mekanizëm sipas të cilit të gjithë personat e paraburgosur në Kosovë mund t'a kontestojnë ligjshmërinë e arrestimit dhe paraburgimit të tyre në çdo kohë. Veçanërisht:



- i. Gjykata Supreme e Kosovës duhet t'a ketë fuqinë e rishqyrtimit të çfarëdo ankese nga I paraburgosuri mbi natyrën e ligjshmërisë së arrestimit dhe/apo paraburgimit të vet;
  - ii. gjyqtarët ndërkombëtarë duhet të emërohen në Gjykatën Supreme të Kosovës për t'u marrë me rishqyrtimet e përmendura;
  - iii. rishqyrtimi I Gjykatës Supreme të Kosovës duhet të përbëhet nga një dëgjim I hapur ku palët janë prezente dhe mund të bëjnë paraqitjet;
  - iv. vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës duhet të jenë të detyruese ndaj të gjitha autoriteteve në Kosovë.
3. UNMIK-u duhet të themelojë një mekanizëm të qasshëm dhe efektiv për dispozitat e kompenzimit, personave të cilët kanë qenë joligjshëm të paraburgosur apo ndryshe të autorizuar për kompenzim sipas ligjit vendor.
  4. Është rekomanduar se urdhërat nga KOMKFOR për paraburgime do të ndalohen për aq kohë sa ato të shqyrtohen nga gjykata.
  5. KFOR-I dhe UNMIK-u duhet të ndërprejnë praktikën e rregullt të paraburgimit të individëve të arrestuar për 72 orë , apo më tepër, para sjelljes së tyre para autoriteteve gjyqësore, duke shkelur ligjin vendor. Derisa LPP RFJ të ndryshohet, të gjitha dispozitat ligjore përkitazi me arrestim dhe paraburgim, siq është lëshuarja e fletëarrestit dhe urdhërit të shkruar për paraburgim nga policia duhet të përcillet nga organet zbatuese të ligjit. Qendrat e paraburgimit duhet të lirojnë personat të cilët nuk janë subjekt I urdhërave ligjore për paraburgim.
  6. Shefi i policisë së UNMIK-ut duhet të sigurojë shpërndarje efektive të ligjit të aplikueshëm dhe të të gjitha rregullave dhe procedurave të brendshme përkatëse në teren.
  7. Në pajtim me Buletinin 15 të policisë së UNMIK, autoritetet zbatuese të ligjit duhet t'i informojnë të personat e arrestuar mbi të drejtat e tyre për mbrojtës edhe gjatë marrjeve në pyetje dhe mbi të drejtën e tyre të heshtjes. Të gjithë personave të arrestuar dhe/apo të paraburgosur duhet t'u ofrohet angazhim i menjëhershëm i mbrojtësit. Pos kësaj, të gjithë personat e arrestuar duhet të informohen për arsyet e arrestimit të tyre dhe, nëse janë të paraburgosur, të drejtën e informimit të familjeve të tyre, drejtpërdrejtë apo përmes autoriteteve zbatuese të ligjit, mbi arrestimin dhe vendin e paraburgimit. Policia e UNMIK-ut duhet të sigurojë se të gjitha stacionet policore duhet të mbajnë shenja apo pamfleta që informojnë të arrestuarit mbi të drejtat e tyre.
  8. Zyrtarët gjyqësor duhet të ndërpresin që ta ngarkojnë Policinë e UNMIK-ut me urdhëra verbale për vazhdimin e paraburgimit pas një periode të burgimit policor dhe

të mbështesë kërkesat e ligjot vendor dhe standardeve ndërkombëtare lidhur me të drejtën të sillet menjëherë para autoriteteve gjyqësore.

9. Në rastet që ndërlidhin të miturit, gjykatat duhet të sigurojnë që hetimet dhe gjykimet të zhvillohen sa më shpejtë kur I mituri është subjekt I paraburgimit në pajtim me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare. Si plotësim, në procedurat të të miturve gjykatat nevojitet të mbështesin obligimet e tyre përkitazi me trajtimin e të miturve për sigurimin që procedura, përfshirë edhe paraburgimin, nuk do të ndikoj negativisht në zhvillimin mental dhe emocional. UNMIK-u duhet rritur fondacionet, personelin dhe trajnimet e Qendrave për Punë Sociale që të sigurojnë trajtimin adekuat të të miturve në procedurat penale përfshirë edhe paraburgimin dhe se këto procedime nuk do të ndikojnë negativisht në zhvillimin mental dhe emocional të të miturit. Gjykatësit për të miturit duhet të vazhdojnë të pranojnë trajnime specifike.
10. Të gjitha urdhërat për paraburgim nga gjykatat e Kosovës duhet të nxjerrin faktet që përkrahin detyrimin e çfarëdo arsyeje të posaçme të paraburgimit në pajtim me ligjin vendas dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
11. KFOR-i, policia e UNMIK-ut dhe Administrata e Burgjeve e KB-ve, autoritetet përkatëse të administrimit të burgjeve, duhet t'i udhëzojnë komandirët e burgjeve se janë të obliguar t'i lirojnë personat që nuk janë subjekt i urdhërave të ligjshëm për paraburgim.
12. Është rekomanduar që PSSP-ja duhet t'a revidojë ligjin e aplikueshëm lidhur me rishqyrtimin e urdhërave për paraburgim ashtu që të përfshijë edhe:
  - i. Mënyrat e inicimit të rishqyrtimit të një urdhëri për vazhdimin e paraburgimit;
  - ii. Angazhimin e përfaqësuesit efektiv ligjor;
  - iii. Kohën adekuate për përgatitjen e përgjegjes së kërkesës për vazhdimin e paraburgimit dhe, gjithsesi, të njojtimit për kërkesën për zgjatjen e afatit të kufizuar të paraburgimit jo më vonë se shtatë ditë para dëgjimit;
  - iv. Të drejtën e përfaqësimit personal apo përmes një përfaqësuesi ligjor;
  - v. Hapjen e mëparshme të çdo prove ndaj prokurorit publik apo gjyqtarit hetues si bazë për paraburgimin e vazhduar të rekomanduar;
  - vi. Hapjen e mëparshme të çdo prove që mund të dobësojë referimin për vazhdimin e paraburgimit të bërë nga gjyqtari hetues apo prokurori publik;
  - vii. Mundësinë për paraqitjen e dëshmimeve përkatëse; dhe,
  - viii. Vendim i plotarsyeshëm me shkrim mbi bazën e urdhërit për vazhdimin e paraburgimit.

13. Instituti Juridik I Kosovës duhet të sigurojë trajnim me punëtori praktike për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrimin e nenit 191 të LPP-së së RFJ-së për paraburgim.

14. Avokatët duhet të trajnohen për mbrojtjen efektive lidhur me detyrimin për paraburgim.

<sup>1</sup> Neni 9(4) KNDCP dhe neni 5(4) KEDNJ.

<sup>2</sup> Neni 9(5) KNDCP, neni 5(5) KEDNJ.

<sup>3</sup> *Shiko* nenin 12, nenin 545 të LPP-së së RFJ-së.

<sup>4</sup> *Shiko* nenin 9(4) të KNDCP-së, nenin 5(3) të KEDNJ-së.

<sup>5</sup> *Shiko* Schiesser v Switzerland, A/34 (1979) 2 REDNJ 276 “kontrolli gjyqësor në ndërhyrje nga zbatuesit me të drejtën e individit për liri.”

<sup>6</sup> *Id.* Gjykata pohon se një karakteristikë e këtij zyrtari “është pavarësia e tij nga zbatuesit dhe nga palët.”

<sup>7</sup> *Id.* Gjykata ka pohuar qartë se prokurori nuk vlerësohet si një zyrtar i tillë, dhe as zyrtari nuk mund të ndihmojë më vonë në prokurori.

<sup>8</sup> *Shiko* Komitetin e KB-ve për të Drejtat e Njeriut, Koment i Përgjithshëm Nr.8, alineja 2.

<sup>9</sup> *Shiko* Borgan v UK A/145-B (1988) 11 REDNJ 117.

<sup>10</sup> *Shiko* nenin 192, nenin 197 të LPP-së së RFJ-së.

<sup>11</sup> *Shiko* nenin 195 të LPP-së së RFJ-së.

<sup>12</sup> *Shiko* nenin 196 të LPP-së së RFJ-së.

<sup>13</sup> *Ibid.*

<sup>14</sup> Neni 192 i LPP-së së RFJ-së.

<sup>15</sup> *Shiko* poashtu, parimin 17(1) në “The Body of Principles for the Protection of all Persons Under Any Form of Detention or Imprisonment”.

<sup>16</sup> Murray v. UK (1996) 22 REDNJ 29.

<sup>17</sup> Neni 9(2) i KNDCP-së dhe neni 5(2) i KEDNJ-së.

<sup>18</sup> *Shiko*, psh. Funke v Franca (1993) 16 EHRR 297 dhe Neni 14(3)(g) ICCPR.

<sup>19</sup> *Shiko* Raportin SMSL Nr.7 Qasja mbrojtësit Efikas, Faza e parë 1) Arresti në Dëgjimin e parë, 23 Maj 2000.

<sup>20</sup> *Shiko* nenin 200 të LPP-së së RFJ-së..

<sup>21</sup> Pasiqë ky rast, I përdorimit të testit poligrafik është anuluar nga Policia e UNMIK-ut , shiko Buletini e Policisë së UNMIK-ut 30, “ Utilizimi I Provave të Poligrafit”, 5 Maj 2000.

<sup>22</sup> *Shiko* nenin 37(b) të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës .. Shiko gjithashtu Rregullën 1 të Rregullave të KB-ve për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria e tyre.

<sup>23</sup> Wemhoff v FRG, A 7 fq. 24 (1968).

<sup>24</sup> Letellier v. France, A 207 alineja 35 (1991).

<sup>25</sup> ECHR Neni 5(3) dhe ICCPR Neni 9(3) DHE (4).

<sup>26</sup> 1992) 14 REDNJ 551, Neumeister v Austria (Nr.1) (1979-80) 1 REDNJ 91 tash është anuluar.

<sup>27</sup> *Shiko*, psh. Woukam Moudefau v Franca (1991) 13 EHRR 549.

<sup>28</sup> Neni 3 i LPP-së së RFJ-së.

<sup>29</sup> Neni 190(2) i LPP-së së RFJ-së. *Shiko* nenin 474(1) e LPP-së së RFJ-së.

<sup>30</sup> *Shiko* nenin 462 e LPP-së së RFJ-së.

<sup>31</sup> *Shiko* nenin 474 (1) LPP RFJ.

<sup>32</sup> *Shiko*, Neni 473 i LPP-së së RFJ-së.

<sup>33</sup> *Id.* nën seksionin (2).

<sup>34</sup> Neni 462 i LPP-së së RFJ-së.

<sup>35</sup> Neni 484 i LPP-së së RFJ-së.

<sup>36</sup> Neni 454(2) LPP RFJ.

<sup>37</sup> Teksti Serb sygjeron urgjentisht I domosdoshëm.

<sup>38</sup> Neni 192(2) i LPP-së së RFJ-së “Paraburgumi duhet të urdhërohet përmes vendimit me shkrim që përmban këto: emrin dhe mbiemrin e personit që do të merret në paraburgim, veprën penale për të cilën ndjeket, bazën ligjore për paraburgim, udhëzimet mbi të drejtën në ankesë, një vërtetim i shkurtyr ku arsyet

---

e urdhërimit të paraburgimit duhet specifikisht të argumentohen, vula zyrtare dhe nënshkrimi i gjyqtarit i cili urdhëron paraburgimin.”

<sup>39</sup> SMSL-ja tashmë ka raportuar mbi dështimet e *Rregullores 1999/26* në përputhjen me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. *Shiko* Raportin nr.6 të SMSL-së *Joligjshmëria e Rregullores 1999/26*.

<sup>40</sup> Sipas nenit 190(3) të LPP-së së RFJ-së “gjatë tërë procedurës, paraburgu do të hiqet kur pushojnë shkaqet në bazë të të cilave ka qenë caktuar.”

<sup>41</sup> Neni 199(1) (2) (3) (4) i LPP-së së RFJ-së.

<sup>42</sup> Këta të dy kanë ikur nga burgu më 2 shtator 2000..

<sup>43</sup> I dyshimti D ka ikur nga paraburgimi.

<sup>44</sup> Shiko nenin 457 (1) e LPP-së së RFJ-së.

<sup>47</sup> Id. nën alinenë (2).

<sup>48</sup> <http://www.un.org>, 16 gusht 2000 *Gjykimi i njeriut të ndjekur për gjenocid fillon në Mitrovicë*

<sup>49</sup> Gjykatës në këtë rast ka qenë Kryetari I Gjykatës së qarkut, e jo gjykatësi I emëruar për të mitur.

<sup>50</sup> Drejtësia e UNMIK-ut 2000/18: *Procedura me të mitur*, 22 gusht 2000.

<sup>51</sup> Drejtësia e UNMIK-ut 2000/6: *Paraburgimi i të miturve*, 16 maj. 2000

<sup>52</sup> Shiko, psh. *Letierr v Franca* (1992) 14 EHRR 83 në alinenë 51.

## **SEKSIONI 5: E DREJTA NË MBROJTËS**

Standardet ndërkombëtare për gjykimet korekte imponojnë një obligim të dyfishtë shtetit sa i përket mbrojtësit të caktuar nga gjykata: së pari, kohë adekuate dhe lehtësira duhet të ofrohen me qëllim të sigurimit të pregatitjes së duhur të mbrojtjes<sup>1</sup> dhe së dyti, përfaqësimi ligjor i siguruar, duhet të jetë me kualifikim dhe përvojë të duhur. Mbrojtësi duhet ofruar shërbime të cilat janë “praktike dhe efektive”.<sup>2</sup> Manifestimi i dështimit të përfaqësorj të pandehurin efektivisht, është shkelje e standardeve për gjykim korekt. Edhe pse zhvillimi i rastit është qështje në mes të të pandehurit dhe mbrojtësit, nga shteti kërkohet të intervenojë, nëse dështimi i mbrojtësit për ofrimin e përfaqësimit efektiv “manifestohet”.<sup>3</sup>

### **I. Ligji Vendor**

LPP FRJ përmban një numër dispozitash që kanë të bëjnë me rolin e mbrojtësit gjatë fazës hetimore, i cili qartë fuqizon një rol aktiv për mbrojtësin. Dispozita të ngjashme në relacion me fazën e gjykimit, siq është e drejta e kërkesës për prova plotësuese dhe e drejta e kontestimit të pranueshmërisë së provave, veq tjerash, janë gjithashtu të parapara në LPP RFJ. Për hir të këtij shqyrtimi, dispozitat relevante të fazës hetimore do të shqyrtohen dhe do të ndahen në tri kategori: Funkzioni “Mbikqyrës”, Funkzioni i Egzaminimit dhe Mbledhjes së Provave dhe Funkzioni i Udhërrëfyesit dhe Asistimit Hetimor. Është imperative që lehtësirat adekuate dhe procedurat të jenë të vendosura mirë me qëllim që të sigurojnë që mbrojtësit mund të ushtrojnë këto funksione efektivisht.

#### **(a) Funkzioni Mbikqyrës**

Sipas LPP RFJ, gjykatat dhe autoritete tjera relevante janë të detyruara që në mënyrë të vërtetë dhe të plotë të konstitujnë faktet e rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm dhe, me vëmendje të njëjtë, të konstitujnë këto fakte, si për ashtu edhe kundër, të të pandehurit.<sup>4</sup> Për më tepër, kur vendimi për fillimin e hetimeve të mirret, gjykata është e obliguar të mbledh, veq tjerash, të gjitha provat dhe informatat e domosdoshme për vendimin lidhur me ngritjen, apo jo, të aktakuzës; të gjitha provat të cilat mund të mos jenë të disponueshme për gjykim, apo prezentimin e të cilave është vështirë të provohet në gjykim; dhe të gjitha provat tjera që mund të jenë të dobishme për procedurë.<sup>5</sup> Si pjesë e funksionit të mbikqyrësit, mbrojtësi është i obliguar të sigurojë që gjykatat të ushtrojnë këto detyra në mënyrë të duhur, pasojat e akcioneve të të cilave do të kenë ndikim të drejtëpërdrejtë në hetime dhe mund të influencojnë mbrojtjen në gjykim.

Gjatë dëgjimit të parë, të akuzuarit duhet ti lejohet të prezentoj pozitën e tij përkitazi me të gjitha rrethanat inkriminuese dhe të paraqesë të gjitha faktet në favor të tij.<sup>6</sup> Në rastet e mbrojtjes së obliguar, dëgjimi *duhet* të bëhet në prezencën e mbrojtësit.<sup>7</sup> Në rastet e mbrojtjes së joobligueshme dhe në mungesë të dorëheqjes së shprehur, mbrojtësi duhet përgjithësisht ti lejohet të marrë pjesë në dëgjim, përveq kur i akuzuari dështon të siguroj mbrojtës përkundër faktit se i është tërheqë vërejtja 24 orë më parë që të bëjë një gjë të

tillë<sup>8</sup>, kur mbrojtësi dështon të pjesëmarrë në dëgjim përkundër faktit se i është dhënë njoftim i mjaftueshëm, ose kur mbrojtësi i është mohuar qasja, aktivitetet hetimore.<sup>9</sup> Shkelja e masave mbrojtëse, që qeverisin me dëgjimin e të akuzuarit mund të bëjnë deklaratën të akuzuarit të papranueshme.<sup>10</sup>

Në pajtim me funksionin e tij të “mbikqyrësit”, mbrojtësi mund të parashtrijë kundërshtim pranë Kryetarit të Gjykatës së Qarkut, për shkak të zgjatjes së procedurës apo të parregullsive të tjera gjatë zhvillimit të hetimeve.<sup>11</sup>

### **(b) Funksioni i Ekzaminimit dhe Mbledhjes së Provave**

LPP RFJ përmban dispozita që i lejojnë mbrojtësit të drejtën për të ekzaminuar provat gjatë hetimeve. Kur të merret vendimi për zhvillimin e hetimeve, Neni 73(1) LPP RFJ i garanton mbrojtjes, qasjen tek dosja e lëndës dhe tek provat materiale të mbledhura.<sup>12</sup> Si qështje praktike kjo duhet të përfshijë dosjen e policisë e cila mund të përmbajë gjurmët e hetimeve dhe material kontradiktor.<sup>13</sup> Kur është në interes të procedurës, gjyqtari hetues është poashtu i obliguar ti bëjë të ditur të pandehurit dhe mbrojtësit, para përfundimit të hetimeve, për të gjitha provat e rëndësishme të mbledhura në hetime.<sup>14</sup> Në bazë të ekzaminimeve të këtyre provave, mbrojtësi, mundet, për shembull, të paraqesë parashtrësë për prezentimin e provave të reja. Këto dispozita për zbulim duhet të interpretohen gjërësisht në pajtim me funksionin e mbrojtësit si mbikqyrës dhe nevojën e sigurimit të pregatitjes së duhur të mbrojtjes për gjykim.

### **(c) Funksioni i Udhërrëfyesit dhe Asistimit në hetime**

LPP RFJ parasheh një rol aktiv për mbrojtësin në udhërrëfimin dhe ndihmën për zhvillimin e hetimeve dhe kontestimin e bazës së aktakuzës. Para se të mirret vendimi për iniciimin e hetimeve, Gjykatësi hetues mund të kërkojë dëgjimin gojor me prokurorinë dhe mbrojtjen, për sqarimin e disa qështjeve relevante.<sup>15</sup> Mbrojtja mund të ankoet kolegjit gjykues kundër vendimit për zhvillimin e hetimeve preliminare.<sup>16</sup>

Sipas LPP RFJ Neni 167(1)(2), mbrojtësi mundet, gjatë zhvillimit të hetimeve, të paraqesë parashtrësë pranë gjykatësit hetues ose agjensive për zbatimin e ligjit që të ndërmerren disa veprime të caktuara hetimore. Përmëtepër, sipas Neni 168(8) të LPP RFJ,

“ Personat që marrin pjesë gjatë hetimeve, mund të propozojnë që gjykatësi hetues ti bëjë disa pyetje sqaruese të akuzuarit, dëshmitarit apo ekspertit, dhe me lejen e gjykatësit hetues, munden që edhe vetë direkt të bëjnë pyetje. Këta persona kan të drejtë të bëjnë vërejtjet e tyre përkitazi me ushtrimin e veprimeve të caktuara të shënuara në procesverbal dhe ata munden gjithashtu të propozojnë që provat e caktuara të prezentohen.”

Përfundimisht, dispozitat vendore të përmendura më lart nuk janë të rëndësishme vetëm për efektin potencial të tyre mbi mbrojtjen në gjykim, por gjithashtu edhe se pas ngritjes së aktakuzës, I akuzuari dhe /ose mbrojtësi mund të kontestojnë aktakuzën brenda 8

ditësh.<sup>17</sup> Bazat mbi të cilat një aktakuzë mund të hudhet poshtë përfshinë, për shembull, mungesën e provave apo rrethanat e tjera që përjashtojnë përgjegjësinë penale.<sup>18</sup>

## **II. E Drejta në Kohë Adekuate dhe Lehtësira për Pregatitjen e Mbrojtjes**

### **(a) Qasja Përfaqësimit Ligjor**

SMSL intervistoi njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë të paraburgosur lidhur me qasjet e ndryshme qështjeve të mbrojtjes, në të pestë regjionet e Kosovës.<sup>19</sup> Nga të paraburgosurit e pyetur, *asnjëri* nuk ka raportuar se ka patur qasje mbrojtësit derisa ishte në paraburgim, para dëgjimit të parë. Ata indikuan mungesën e lehtësirave themelore (p.sh. nuk kanë patur në dispozicion telefonin dhe nuk u ishte lejuar lapsi, stilot dhe materiali tjetër për shkrim), çka paraqet barrierë për kontaktimin e mbrojtësit para dëgjimit të parë. Në Prishtinë dhe Pejë, të paraburgosurit kanë raportuar se nuk u janë lejuar vizitorët gjatë 72 orëve të para, apo para dëgjimit të parë në paraburgim. Këto restriksione gjithashtu aplikohen për anëtarët e familjes, të cilët përndryshe u kishin asistuar në sigurimin e mbrojtësit gjatë asaj periudhe kohore.<sup>20</sup> Në Pejë, të paraburgosurit vazhdimisht kanë raportuar se anëtarëve të familjeve iu nevojitet autorizimi prej gjykatësit hetues para se tu lejohet vizita.<sup>21</sup>

Për shumicën e të paraburgosurve të intervistuar, problemi i qasjes mbrojtësit duket se shkaktohet, së paku në instancën e parë, nga mungesa e mekanizmave procedural me të cilat emërohet apo autorizohet mbrojtësi para dëgjimit të parë.<sup>22</sup> Përmëtepër, në Prishtinë, në disa raste të raportuara ku të paraburgosurit ishin në gjendje të angazhojnë mbrojtës, ose para se ti dorëzoheshin policisë ose gjatë burgimit policor përmes anëtarëve të familjes, vetëm njëri kishte qasje tek mbrojtësi, në qendrën e paraburgimit para dëgjimit të parë. Me at rast i paraburgosuri i Prishtinës, raportoi se në dëgjimin e parë, ai kërkoi që gjyqtari hetues të emëroi mbrojtësin dhe lejoi të paraburgosurin të bisedoi me mbrojtësin, në besim, para vazhdimit të dëgjimit. Gjykatësi hetues lejoi kërkesën dhe e dërgoi të paraburgosurin sërish në qendrën e paraburgimit ku i ishte lejuar të takohet me mbrojtësin. Pastaj ai ishte kthyer në gjykatë të njëjtën ditë, dhe dëgjimi ishte bërë në prezencën e mbrojtësit.

Për të paraburgosurit Serb të Kosovës, këto probleme janë më të theksuara për shkak të mungesës së mbrojtësve Serb të Kosovës në dispozicion për marrjen e emërimeve gjyqësore. Kjo mund të ngritet në të ardhmen në konflikt potencial të qështjes së interesave. Thuhet se Gjykatat kanë dështuar aktualisht të emërojnë mbrojtësit Serb të cilët janë në dispozicion. Në regjionin e Prishtinës siq raportohet janë të ditur katër mbrojtës Serb të Kosovës, në dispozicion për të marrë emrimet gjyqësore;<sup>23</sup> vetëm dy aktualisht janë emëruar. Në Mitrovicë, tetë mbrojtës mbrojtës Serb të Kosovës, është raportuar, të jenë në dispozicion për emërim; vetëm një aktualisht është emëruar. Në regjionin e Gjilanit, vetëm një mbrojtës Serb i Kosovës është në dispozicion për emërim.<sup>24</sup> Asnjë mbrojtës Serb i Kosovës nuk janë raportuar të jenë në dispozicion as në Prizren as në Pejë.

Dështimi për të ofruar procedurë apo lehtësira me të cilat të paraburgosurit, të cilët atë e dëshirojnë, mund të kontaktojnë mbrojtësin dhe të ngurtësojnë mungesën e mbrojtësve

Serb të Kosovës, ndriqon dështimin e autoriteteve relevante të plotësojnë obligimet e tyre pozitive për ofrimin e qasjes mbrojtësit.

#### **(b) Qështja e Qasjes Fizike**

##### **Lehtësirat Adekuate dhe Qasja Mbrojtësit**

Në rastet kur të paraburgosurit kan siguruar mbrojtës të autorizuar apo të emëruar, ata vazhdojnë të raportojnë mungesën e lehtësirave themelore për komunikimin e lirë të tyre me mbrojtësin përveq vizitave të tij (p.sh. nuk kan patur telefona në disponim, dhe atyre nuk u është lejuar të ken laps, stilo, apo material tjetër shkrimi). Disa të paraburgosur në Prishtinë raportuan se ata janë, sidoqoftë, në gjendje të marrin lajme nga mbrojtësi përmes anëtarëve të familjes.

##### **Qasja e Kufizuar nga Autoritetet**

Në Mitrovicë, mbrojtësit e intervistuar Serb të Kosovës raportuan se (i) atyre nuk u është lejuar të flasin me klientët e tyre para dëgjimit të parë; dhe (ii) atyre nuk u është lejuar çfarëdo komunikimi i besueshëm me klientët e tyre deri pas përfundimit të hetimeve dhe pas ngritjes së aktakuzës. Këta mbrojtës raportuan se, para secilës, dhe çdo vizite me klientin e tyre ata duhet të marrin në të shkruar “ fletëlejen” nga gjykatësi hetues. Fletëlejet caktojnë datën dhe gjatësinë, në minuta, të çdo vizite.<sup>25</sup> Dispozitat e LPP RFJ të cilat i lejojnë gjykatës të rregullojnë qasjen mbrojtësve klientëve të tyre janë në mospajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut pasi që negativisht ndikojnë në aftësinë e mbrojtjes të përfaqësojnë në mënyrë adekuate dhe efektive klientët e tyre.

Mbrojtësit në Gjilan raportuan se, përderisa ata teorikisht ishin në gjendje të vizitojnë klientët e tyre pa kufizime, procedura e hyrjes në Kampin Bondstill vazhdimisht mirrte prej një gjer në tri orë. Gjatësia e këtyre procedurave hyrëse redukton kohën të cilën mbrojtësi mundet të kaloj me klientin e tij apo saj, dhe ka rezultuar në zbritjen e frekuencës së vizitave.

#### **(c) Komunikimi i Besueshëm**

Në Gjilan, njëzetë e tre nga tridhjetë e pesë të paraburgosur të intervistuar indikuan se takimet e tyre me mbrojtësin bëheshin në prezencën e përfaqësuesit të qendrës së paraburgimit apo nëpunësit mbikqyrës.

Në Mitrovicë, mbrojtësit e intervistuar Serb të Kosovës indikuan se çdo vizitë me klientët e tyre duhej të zhvillohej në prezencën e, ose të antarit të stafit të gjykatësit hetues ose të nëpunësit të qendrës së paraburgimit. Këta mbrojtës bënë të qartë se është Gjykata e Qarkut, e jo qendra e paraburgimit, ajo që imponon këto kërkesa. Njëri nga mbrojtësit e intervistuar beson se dënimi për tentim të komunikimit të besueshëm me klientin e tij, pa lejen nga gjykatësi hetues, do të ishte ndërprerje e urdhëruar nga gjykata e të gjitha privilegjeve të tij vizitore, si mbrojtës. Gjykata e Qarkut nuk e pranoi këtë. Në



Qendrën e paraburgimit në Lipjan, kryesi i detyrës së udhëheqësit, një ndërkombëtar, insistoi në qëndrim gjatë komunikimit në mes të mbrojtësit dhe kljentit.

#### **(d) Qasja Shkresave Gjyqësore**

Informatat e mbledhura nga policia, para dhe pas arrestit janë kritike për zhvillimin e mbrojtjes. Ato mund të ofrojnë, p.sh., gjurmët hetimore dhe materialin kontradiktor. Prokurori publik në Prishtinë raportoi se mbrojtësve u është siguruar qasja shkresave policore pasi që gjykatësi hetues i ka emëruar apo autorizuar për rastin. Për dallim, në Mitrovicë, mbrojtësit Serb të Kosovës të intervistuar nga SMSL, në Prill 2000, raportuan se atyre kurrë nuk u është siguruar qasja shkresave policore, as pas ngritjes së aktakuzës. Këta mbrojtës raportuan se u është lejuar të kopjojnë vetëm ato faqe të shkresave të gjyqit të aprovuara nga gjykatësi hetues, por se *të gjitha dokumentet policore janë të “mbyllura”*.

Departamenti Juridik, më 26 Maj 2000, ka lëshuar Qarkoren Juridike /2000/7 që ka të bëjë me qasjen dosjeve gjyqësore. Qarkorja vërteton natyrën kritike të qasjes së mbrojtësve, dosjeve gjyqësore për përgatitjen e mbrojtjes dhe kontestimin e paraburgimit.<sup>26</sup> Mbrojtësit janë gjithashtu të autorizuar të kopjojnë shkresat e lëndës dhe mbrojtësi i caktuar nga gjykata mund të bëjë këtë pa kompenzim. Autoritetet relevante duhet të sigurojnë që lehtësirat adekuate të jenë në dispozicion për kopjim.

### **III. E Drejta për Përfaqësim Efektiv Ligjor**

Gjatë SGJE, gjykimet zhvilloheshin vetëm në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe një numër i theksueshëm prej tyre ishin vepra relativisht kundërvajtëse. Provat ishin të pamjaftueshme për ngritjen e ndonjë përfundimi lidhur me efektivitetin e mbrojtësve ligjor në Kosovë. Sidoqoftë, në mes të 1 Shkurtit 2000 dhe 31 Korrikut 2000, numri total i gjykimeve të përfunduara ishte **njëqind e gjashtëmbëdhjetë**, dhe rangimi fillonte prej sulmit e gjer tek dhunimet dhe vrasjet e rënda. Nga këto gjykime, **SMSL ka monitoruar shtatëdhjetë e shtatë raste, gjashtëdhjetë e gjashtë përqind (66%) të të gjitha gjykimeve në Gjykatat e qarkut.**

#### **(a) Standardet Ndërkombëtare për Gjykimet Korrekte**

Edhe pse standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut bëjnë pjesë në ligjin e aplikueshëm në Kosovë, SMSL mund të llogarisë vetëm dy raste kur, ose kolegji gjykues ose mbrojtësi, janë referuar në to.<sup>27</sup> Provat duket sugjerojnë se mbrojtësit janë plotësisht të panjohur me këto standarde.<sup>28</sup>

Parimi i “barazisë së armëve”, në mes të shtetit dhe të pandehurit, siguron që të dy palët të jenë të trajtuar proceduralisht njësoj. Për shembull, i pandehuri nuk duhet të jetë i pafavorizuar, thjeshtë, sepse ai nuk ka, sikurse prokuroria, fondacion adekuat për ekspertin. Gjer tani, ky parim duket se nuk ka vend në kulturën legale në Kosovë, përkundër faktit se LPP RFJ përmban dispozita për mbrojtje aktive. Si rezultat, në gjykimet e monitoruara nga SMSL, mbrojtësi duket më tepër të jetë bashkëqëndruar se avokat i cili duhet të jetë aktivisht i angazhuar në përfaqësimin efektiv të kljentit të tij.

Edhe pse ky dështim mund të ketë shtrirje historike, mundet të jetë gjithashtu edhe financiare. Të ardhurat mujore maksimale për mbrojtësin e caktuar nga gjykata janë 500 DM.<sup>29</sup>

Nga shtatëdhjetë e shtatë rastet e monitoruara, SMSL nuk ka vrojtuar asnjë rast në të cilin mbrojtja ka kërkuar nga gjykata të siguroj fonde për asistencën në ekspertim dhe hetime.<sup>30</sup> Për më tepër, me përjashtim të *Muriuki et al*, SMSL nuk ka identifikuar asnjë rast në të cilin mbrojtja ka njoftuar për provat e ekspertizës apo hetimeve.<sup>31</sup> Duket se ky dështim është kryesisht rezultat i mungesës së diturisë apo mirëkuptimit të parimit të “barazisë së armëve”.

### **(b) Mirësjellja e Mbrojtësit dhe Efektiviteti**

Shumë nga të paraburgosurit e intervistuar, raportuan se ata janë më rrallë të vizituar nga mbrojtësit gjatë hetimeve; se mbrojtësit angazhohen pak, nëse e bëjnë këtë, në diskutimet lidhur me rastet e tyre; dhe se ata nuk janë në dijeni se çfarë po ndodh në fazën e hetimeve. Në të vërtetë, shumë prej tyre pohojnë se atyre asnjëherë nuk u është thënë, apo janë konfuz mbi atë, se cila është saktësisht vepra penale për të cilën ata ngarkohen, ta kenë kryer.

Për shembull, në Gjilan, dymbëdhjetë të paraburgosurit e intervistuar raportuan se ata asnjëherë nuk kishin qenë të vizituar nga mbrojtësit e tyre të angazhuar apo të emëruar nga gjykata. Në Prishtinë i paraburgosuri i akuzuar për vrasje dhe i përfaqësuar nga mbrojtësi i emëruar nga gjykata raportoi se kishte patur *një* vizitë për *shtatë muaj*; tjetri raportoi se ai ishte vizituar *një* herë nga mbrojtësi për *gjashtë muaj*.<sup>32</sup> Edhe në rastet kur të paraburgosurit ishin vizituar më shpesh nga mbrojtësit, shumica e të paraburgosurve raportuan se mesatarja e vizitave të tyre ishte prej 10 deri 15 minuta.

Vështirësitë e vizitave të mbrojtësve janë, në disa raste, të imponuara nga restriksionet prej autoriteteve. Për shembull, vështirësitë e vizitave të mbrojtësve në Mitrovicë janë rezultat direkt i kufizimeve kohore të imponuara nga Gjykata dhe ndalesa e Gjykatës për komunikimin e besueshëm në mes të mbrojtësit dhe të paraburgosurit. Ngjashëm, në Gjilan, kufizimi kohor ekziston për vizitat e mbrojtësve, edhe pse është e paqartë se a janë vendosur këto kufizime nga Gjykata apo nga autoritete e paraburgimit.<sup>33</sup>

Në rastet tjera, vështirësitë e vizitave të mbrojtësve duken të jenë drejtëpërdrejtë në relacion, ose me pagesën joadekuate nga UNMIK-u, ose nga mosmirësjellja e mbrojtësit. Tetë mbrojtës në Gjilan raportuan se për shkak të niveleve të ulta të pagave në rastet e caktuara nga gjykata, ata nuk mund të ofrojnë investim kohe të njëjtë në këto rate prandaj janë më pak proaktivë në zhvillimin e tyre të mbrojtjes. Të paraburgosurit në Prishtinë Gjilan, dhe Pejë kan raportuar se mbrojtësit e caktuar nga gjykatat kan kërkuar nga të paraburgosurit që tu paguajnë më tepër të holla për të vazhduar për ti vizituar dhe/ose për të punuar në rast. Trembëdhjetë të paraburgosur në Gjilan kan raportuar se çdo vizitë e mbrojtësit të tyre ishte zhvilluar në “grup” me mbrojtësit e klientëve të tjerë. Këto takime “grupore” me klientë janë brengosës pasi që për të paraburgosurit, individualisht, komunikimet në këto takime, qartë, nuk ishin të besueshme.

Të paraburgosurit në Mitrovicë dhe Prishtinë gjithashtu kanë raportuar takime të ngjashme grupore. Qështja në Mitrovicë është posaqërisht brengosëse pasi që një numër i madh i të paraburgosurve, të akuzuar për krime lufte, janë të përfaqësuar nga i njëjti mbrojtës. Ky mbrojtës e lajmëroi SMSL se ai ishte i përgatitur të shkonte në gjykimet e 20 rasteve, edhe pse pohoi se ishte pa zyre, automjet, apo asistencë administrative, hetimore apo të ekspertëve.

### **(c) Rastet e Monitoruara**

Nga shtatëdhjetë e shtatë rastet e monitoruara, SMSL ka zbuluar modelin, të themi, të mbrojtësit:

- i. dështimi për të kërkuar analizat e ekspertëve;
- ii. dështimi për të hetuar në mënyrë adekuate, para gjykimit, rastin e prokurorit dhe mbrojtjes;
- iii. dështimi për të marrë në pyetje dëshmitarët;
- iv. dështimi për të prezentuar provat mbështetëse në gjykim; dhe
- v. dështimi për të kontestuar në gjykim provat e papranueshme.

Rastet e përmendura më poshtë nuk janë listë shterruese, por më tepër shembuj të problemeve të rënda në Kosovë.

### **Pejë**

Mbrojtësi është caktuar nga gjykata për të përfaqësuar një të mitur të ngarkuar për vrasje (që të dytë, viktima dhe i pandehuri ishin ish- ushtarë të UÇK-së).<sup>34</sup> Mbrojtësi e informoi SMSL se, para gjykimit, familja e viktimës e kishte kërcnuar që të mos e përfaqësonte të miturin. Edhe pse ai e injoroi kërkesën e tyre, ai e informoi SMSL se gjatë përfaqësimit të të miturit e kishte ndjerë vehten "psiqikisht të kërcnuar". I pandehuri pohoi se, para gjykimit, mbrojtësi e kishte vizituar katër deri në gjashtë raste në periudhën prej nëntë muajsh. Edhe pse, siq thuhet, i pandehuri tentoi të bënte vetvrasje dhe me rastin kur ishte rëndë i sedativizuar në paraburgim, mbrojtja dështoi të kërkojë raportin psikiatrik. Mbrojtësi e informoi SMSL se po ta kishte vizituar më shpesh, nuk do të ishte paguar më tepër. Sa i përket përgatitjeve për gjykim, mbrojtësi deklaroi se atë do të përgatiste posa të dëgjonte se çka kishin për të thënë dëshmitarët.

Gjatë gjykimit, mbrojtësi nuk prezantoi mbrojtje dhe foli shumë rrallë. Si rezultat, i pandehuri, 17 vjeçar, morri mbi vehte të bëjë vërejtje në aspektet e gjykimit. Në një shkallë, i pandehuri madje, kërkoi nga gjykata që të thërret një numër dëshmitarësh që do të mbështesnin mbrojtjen apo vetëmbrojtjen dhe/ose aksidentin. Gjykata e refuzoi kërkesën. Pjesa më e madhe e gjykimit, siq dukej, zhvillohej nga mbrojtësi i viktimës. Prokurori nuk kishte kurrfarë roli në procedurë dhe madje mungoi gjatë aktgjykimit. I pandehuri u shpall fajtor dhe u dënua me shtatë vite burgim.

Pas gjykimit, ishte bërë vlerësimi psikiatrik i të pandehurit. Aty konkludohej se, para kryerjes së veprës, i mituri kishte vuajtur nga çrregullimi me stres post-traumatik i shkaktuar nga kyqja e tij në luftë dhe se kjo kërkonte psikoterapi intenzive. Pra, ajo çka kishte me qenë më e rëndësishmja në gjykim, ta quajmë ashtu, gjendja mentale e të pandehurit në kohën e veprës, asnjëherë nuk u aktualizua nga mbrojtësi.

*Edin Gusinac*, një Musliman Boshnjak, ishte akuzuar për mashtrim-vjedhje dhe ishte ballafaquar me dënimin e mundshëm prej pesë viteve burgim. Edhe pse mbrojtësi e informoi SMSL se ai ishte caktuar nga gjykata të përfaqësoj Gusinac, ai dështoi të mirrte pjesë në gjykim. Rasti vazhdoi me të pandehurin pa përfaqësues. I pandehuri është shpallur fajtor dhe është dënuar me dy vite e katër muaj burgim. Aktgjykimi është ndryshuar sipas ankesës. Gjykata ankimore morri qëndrim se i pandehuri nuk kishte mbrojtës në gjykim dhe kjo ishte cënimi i KEDNJ. Gjykata c njëjtë e ulët më heret ka dështuar të caktoj mbrojtësin për një të pandehur tjetër, *Ismet Krusha*, një Rom i Kosovës i cili akuzohej për sulm seksual. Ai është shpallur fajtor dhe është dënuar me dymbëdhjetë muaj burgim. Pas dënimit, SMSL është informuar nga gjykata se gjykatësi ishte i mendimit se Krusha nuk e kuptoi procedimin dhe se mund të vuante nga ndonjë sëmundje mentale. Ankesa e tij është në pritje.

Në gjykimin e *Shaqir Dobranit* i akuzuar për Tentim vrasje dhe Posedim joligjor të armëve, mbrojtësi ishte prezent gjatë leximit të aktakuzës dhe mëpastaj lëshoi gjykatoren, për tu kthyer për fjalën e tij përfundimtare. I pandehuri ishte liruar.

## **Gjilan**

Në rastin e *Besim Eminit*, mbrojtësi mori pjesë në dëgjimin e viktimës së dhunimit, para gjykatësit hetues. Sidoqoftë, pasi që ishte i angazhuar edhe tjetërkund, ai shkoi para përfundimit kështuqë dështoi të mirrte në pyetje viktimën. Ky dëshmitar më vonë nuk u paraqit në gjykim dhe deklarata e saj dhënë gjykatësit hetues hyri në procesverbal, përkundër vërejtjes së mbrojtësit. I pandehuri ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me gjashtë vite burgim.

Në rastin e *Selman Fejza dhe të tjerëve* të akuzuar për tentim vrasje, një mbrojtës gjithashtu përfaqësonte edhe viktimën. Gjatë gjykimit mbrojtësi hjequ dorë nga përfaqësimi dhe një tjetër bashkëmbrojtës i të akuzuarve të tjerë, i caktuar nga gjykata, morri përsipër të përfaqësonte Fejzën.

Në rastin *Hyr Marovci*, mbrojtësi arriti pesë minuta pas fillimit të gjykimit në gjykimin e të pandehurit të cilin nuk e kishte takuar më parë. Në rastin e *Halim Halili*, mbrojtësi i caktuar nga gjykata, është vërejtur të ketë lexuar shkresat e lëndës, njëzet minuta para fillimit të gjykimit. Pastaj ai është njoftuar me të pandehurin, të cilin nuk e kishte takuar më parë. Problem i ngjashëm ishte identifikuar edhe në rastin e *Fatmir Mehmetit* ku mbrojtësi ka patur pesë minuta për ta prezentuar vehten klientit të tij dhe të diskutoi rastin.

Në rastin e *Fahredin Shabani*, të akuzuar për dhunim, viktima dështoi të paraqitet në gjykim. Kurrfarë shpjegimi nuk u ofrua për mungesën e saj. Sidoqoftë, mbrojtësi nuk kundërshtoi procedimin e gjykimit dhe as leximin e deklaratës së saj, e cila ishte e vetmja provë që e implikonte të pandehurin në krim. Kjo ishte deklarata e cila ishte dhënë para Policisë së UNMIK-ut , si rezultat i kësaj, të pandehurit asnjëherë nuk i ishte dhënë mundësia të ekzaminoj dëshmitarin. Kjo deklaratë ishte provë primare kundër të pandehurit. I pandehuri ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me pesë vite burgim.

### **Prizren**

Gjykimi i tre të miturve, të ngarkuar për vjedhje të rëndë, u procedua në mungesën e mbrojtësit i cili përfaqësonte dy prej tyre. Gjykata deklaroi për procesverbal se mbrojtësi kishte telefonuar duke i informuar se ishte vonuar dhe duke këshilluar që gjykimi të vazhdonte me marrjen në pyetje e të miturit të tretë (mbrojtësi i të cilit ishte prezent) në mungesë të tij. Për shkak të shtyerjeve të mëparme, dhe faktit se njëri prej të pandehurve ishte në burg për më tepër se tre muaj, gjykata zhvilloi procedurën e tërë kundër të treve përkundër faktit se mbrojtësi mungonte. Viktimat nuk u paraqitën në gjykatë për të dëshmuar, dhe as që gjykata futi në prova deklaratat e tyre para gjykatësit hetues, siq raportohet, pa vërejtje nga palët. Dy të mitur ishin dënuar, dhe tjetri ishte liruar. SMSL bisedoi më vonë me mbrojtësin i cili shpjegoi se nuk kishte ardhur në gjykim për shkak të “obligimeve të pashmangshme familjare”. Ai informoi SMSL se nuk ia ka bërë të ditur këtë gjykatës.

### **Prishtina**

Në dëgjimin hetimor të një Serbi të Kosovës të akuzuar për krime lufte, mbrojtësi e lëshoi dëgjimin duke e informuar klientin e tij që të vazhdojë të përgjigjet në pyetjet e gjykatësit. Në një tjetër dëgjim të tillë, kur i pandehuri kërkoi mbrojtës, daktilografja e gjykatës ishte dërguar jashtë që të kërkonte ndonjë mbrojtës. Asnjëri nuk ishte gjetur dhe dëgjimi kishte vazhduar.

Mbrojtësi që përfaqësonte *Moses Omwenon* gjithashtu përfaqësonte edhe bashkë- të pandehurin tjetër edhe pse kjo ishte qartë konflikt interesash pasi që bashkë-i pandehuri kishte implikuar Omwenon në vepër. Në rastin tjetër mbrojtësi i përfaqësonte të tre të bashkëpandehurit në fazën para-gjyqësore, përkundër faktit se mbrojtjet e tyre ishin drejtëpërdrejtë në konflikt.

*Nazime Hamiti* kishte vrarë foshnjën e saj pesë orë pas lindjes, dhe ishte akuzuar për vrasje e jo infanticid (vrasje e foshnjës). E pandehura deklaroi, dhe ndjekja nuk e kontestoi, se shtatzania ishte rezultat i dhunimit. Gjatë dëgjimit në hetime dhe në gjykim, Hamiti vazhdimisht qante dhe ishte në stres. Raporti psikiatrik ekzistonte lidhur me rastin. Edhe pse ai ishte në dosjen e lëndës, mbrojtësi dështoi të mirrte kopjen e këtij dokumenti. Në at raport qëndronte se Hamiti nuk vuante nga ndonjë sëmundje mentale në kohën e kryerjes së veprës. Pashpjegueshëm, raporti bazohej në komentin e bashkëshortit të Hamitit, dhënë gjatë procedurës hetimore , se ajo e ka “tradhëtuar” në rastet e mëparme

dhe se gjatë luftës “*njerëzit e kanë parë me shumë mashkuj*”, përfundim i qartë i asaj se bashkëshorti nuk u besonte pohimeve të saj për dhunim.

Mbrojtësi e informoi SMSL se ajo nuk kishte kërkuar një vlerësim të pavarur psikologjik sepse ajo nuk kishte të holla dhe se shpresonte lirim. KB Qendra e paraburgimit në Prizren konkludoi se Hamiti ishte “në kufi të dijenisë” dhe se vuan nga sëmundja mentale që ka ekzistuar para veprës penale. Mbrojtësi dështoi të bëjë hyrjen këtij raporti në prova.

Në gjykim, mbrojtësi ishte kryesisht pasiv, duke pyetur disa pyetje dhe duke dështuar të prezentojë provat mbështetëse. Për shembull, vllau i Hamitit i ka ofruar deklaratë policisë duke theksuar se bashkëshorti e ka informuar atë se shtatzania ishte rezultat i dhunimit dhe se ai, bashkëshorti, nuk e dëshiron fëmijun. Prej aktgjykimit, gjykata e ka informuar SMSL, se dënimi ishte pjesërisht i bazuar në dëshminë e bashkëshortit para gjykatësit hetues (edhe pse i ftuar ai dështoi të paraqitet në gjykim). Hamiti ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me pesë vite burgim.

Në rastin e *Afrim Hasanit* të akuzuar për Dhunim të rëndë, mbrojtësi ishte emëruar tri ditë para gjykimit dhe ai e informoi SMSL se ishte i përgatitur për gjykim. Në gjykim, prokurori propozoi leximin në procesverbal të deklaratave të dy ushtarëve të KFOR-it SHBA, njëri prej të cilëve ishte posaqërisht paragjykses për të pandehurin. Në këtë deklaratë, dëshmitari dëshmonte të ketë gjetur të pandehurin në procesin e sulmit të viktimës dhe viktimën duke thënë, në prezencën e të pandehurit, “ai më dhunoi” pohim të të cilin i pandehuri e mohoi. Mbrojtësi dështoi të kundërshtoi pranimin e kësaj deklaratë, duke informuar SMSL se ai ishte kundër shtyerjes së mëtejme të procedurës dhe se ishte plotësisht e zakonshme që deklaratat e tilla të lexohen. Deklaratat e KFOR-it ishin kryesore për prokurorinë, në atë se viktimë dështoi të identifikoi të pandehurin. I pandehuri ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me tri vite e gjysmë burgim.

#### **IV. Trajnimi**

Me qëllim të zhvillimit dhe lehtësimit të trajnimit të gjykatësve, prokurorëve dhe personelit tjetër relevant ligjor, OSBE themeloi Institutin Juridik të Kosovës. Seminarët e trajnimit janë zhvilluar për gjykatësit dhe prokurorët, i pari i mbajtur në Nëntor 1999<sup>35</sup>. Në Maj 2000, praktikantët u trajnuan në seminarin e përbashkët të Këshillit të Europës/OSBE-së, lidhur me Nenin 5 dhe 6 të KEDNJ. Trajnim i ngjashëm parashihet të mbahet në Shtator 2000. Përkundër këtyre përpjekjeve për trajnim, dhe duke patur parasysh problemet e parashtruara në këtë seksion të raportit, është nevojë e qartë për vazhdimin e trajnimeve intensive për të drejtat e njeriut përbrenda kontekstit të së drejtës penale për të gjithë akterët e gjykatave, posaqërisht përfshirë mbrojtësit.

Problemet me të cilat ballafaqohet oda e avokatëve janë të komplikuar nga fakti se me secilën raund të emërimeve të gjykatësve, numri i mbrojtësve është zvogëluar. Gjer më 1 Shtator, në vend ishin përafërsisht shtatëdhjetë mbrojtës “të kualifikuar”.

Ky numër nuk është i bazuar, sepse provat anegdotike sygjerojnë se një numër i theksueshëm i këtyre avokatëve ose nuk janë duke punuar ose nuk dëshirojnë të marrin rastet penale.

Pas paraqitjes së këtij problemi, është nevojë urgjente të zhvillohet një listë më e madhe e mbrojtësve. Për shembull, Universiteti i Prishtinës mund të zhvilloi një program klinik për studentët e juridikut që të përfaqësojnë të pandehurit të ngarkuar për kundërvajtje.

Në Shtator 2000, Shtylla e Ndërtimit të Institucioneve, në bashkëpunim me Asociacionin e Avokatëve Amerikan dhe Këshillin e Evropës, ka mbajtur seminar pilot-projektin për mbrojtësit, e pagëzuar, “*Përfaqësimi Efektiv i të pandehurve Penal në Gjykatat e Kosovës*”.

### **Rekomandimet e SMSL**

1. KFOR-i, Policia e UNMIK-ut dhe KB Administrimi i Burgjeve duhet të pajisin qendrat e paraburgimit dhe stacionet policore me lehtësira adekuate për të akuzuarit që të ushtrojnë të drejtat e tyre për mbrojtës, e këto lehtësira mund të përfshijnë për shembull, qasjen telefonave apo të afërmëve apo shokëve.
2. KFOR-i, Policia e UNMIK-ut dhe KB Administrimi i Burgjeve duhet të sigurojnë që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij të jenë në gjendje të komunikojnë lirisht, pa restriksione kohore apo të tjera, në të gjitha fazat e procesit penal. Të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij duhet ti garantohet komunikimi i besueshëm, me shkrim apo verbal në të gjitha fazat e procesit penal. Komunikimi verbal mund të ndodhë duke i shikuar por jo edhe duke i dëgjuar, të tjerët. UNMIK-u dhe gjykatat duhet të ofrojnë të gjitha lehtësirat e domosdoshme për komunikime të tilla. Ligji vendor, posaqërisht neni 74 (2) LPP RFJ, duhet të ndryshohet apo anulohet.
3. Gjykatat duhet të ofrojnë njoftime të mjaftueshme mbrojtësit për të gjitha dëgjetimet e rëndësishme apo aktivitetet hetimore, posaqërisht marrjen e deklaratës dëshmitarëve. Dëshimet e mbrojtësve nuk duhet ti atributohen të akuzuarit, dhe në rastet kur mbrojtësi dështon të merr pjesë në dëgjetimet e tilla, me arsyetim të mirë apo pa te, pjesa e rëndësishme e hetimeve duhet të ri-hapet, nëse këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë. Në raste përjashtimore, që kyqin për shembull, dështimin e përsëritur të mbrojtësit për të pjesëmarrë pa ndonjë arsye të mirë, gjykata duhet të caktoj mbrojtësin e ri.
4. Autoritetet relevante duhet të bëjnë publike të gjitha provat, si ato që shkojnë në favor si ato që nuk shkojnë, për të akuzuarin apo mbrojtësin e tij brenda kohës së arsyeshme të pranimit.
5. Gjykatat duhet të sigurojnë që mbrojtësi të ketë qasje të lirë tek dokumentet relevante gjyqësore dhe provat, përfshirë edhe dosjen policore, në të gjitha fazat e procesit penal. Mbrojtësit duhet bërë të mundur të gjitha lehtësirat adekuate për kopjimin e të gjitha shkresave relevante dhe provave, pa pagesë.

6. Tërë personelit relevant, përfshirë gjykatësit, prokurorët dhe mbrojtësit duhet ofruar trajnimi praktik në pajtim me rolet e tyre dhe përgjegjësitë dhe të drejtat e të akuzuarit gjatë procedurës hetimore. UNMIK-u mund ti obligoj të gjithë mbrojtësit e caktuar nga gjykata për pjesëmarrje në edukimin vijues ligjor.
7. Zyra e mbrojtjes duhet të themelohet dhe duhet bërë të mundur të veprojë si qendër burimore dhe ndihmuese për mbrojtësit.
8. Duhet të përpilohet Kodi i Etikës si udhërrëfyes i mirësjelljes dhe përgjegjësisë së prokurorisë dhe mbrojtësit, posaqërisht mbrojtësit e caktuar nga gjykata. Projekti i Avokatëve për Kodin e Etikës është tani në rishqyrtim nga përfaqësuesit e Odës së Avokatëve të Kosovës, me ndihmën e OSBE-së.
9. Këshilli Disiplinor i Odës së Avokatëve duhet të fuqizohet aq sa të adresoj në mënyrë të duhur kundërshtimet e të pandehurve, gjykatësve, dhe autoriteteve tjera relevante, përkritazi me raportimet për mosmirësjellje, në një pjesë të mbrojtjes dhe prokurorisë. Personat e akuzuar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre për të parashtruar kundërshtime dhe procedurat duhet të përhapen dhe të jenë të qasshme lehtë. Përbërja e këtij trupi duhet të jetë përfaqësuar nga avokatët e Kosovës dhe komuniteti ligjor.

<sup>1</sup> Shiko, Biondo v Italia Nr. 8821/79, 64 DR 5 (1983) Kom.Rep. Kamasinski v Austria A 168 (1989).

<sup>2</sup> Artiko v Italia (1981) 3 EHRR 1.

<sup>3</sup> Kamasinski v Austria (1991) 13 EHRR 36. Shiko gjithashtu Daud V Portugal (1998) EHRLR. Këto raste I referohen mbrojtësve të caktuar nga gjykata.

<sup>4</sup> Neni 15(1) dhe (2) LPP RFJ.

<sup>5</sup> Neni 157 (2) LPP RFJ.

<sup>6</sup> Neni 218 (5) LPP RFJ, shiko gjithashtu Neni 4 (2) LPP RFJ.

<sup>7</sup> Shiko, Nenin 218(9) LPP RFJ. Rastet e mbrojtjes së obliguar janë definuar në Nenin 70 (1) dhe (2) LPP RFJ sikurse edhe rastet kur I akuzuari është I shurdhër, memec apo I paaftë për të mbrojtur vehten, apo nëse procedura është zhvilluar për veprën për të cilën parashihet dënimi me vdekje( dënimi me vdekje nuk parashihet më në Kosovë), apo kur aktakuza është ngritur për veprën e cila mban dënimin prej dhjetë vitesh apo më të rëndë.

<sup>8</sup> Por, në rastet e varfërisë, *shiko supra* n.11.

<sup>9</sup> Ibid. Shiko gjithashtu Nenin 67 (2) LPP RFJ. Neni 168(5) dhe 73 (2) LPP RFJ fuqizon përshtimin e mbrojtësit nga disa aktivitete të caktuara hetimore ku interesat e mbrojtjes kombëtarë apo sigurimi kombëtar këtë e kërkon. Përderisa neni 73(2) kufizon përjashtimin e për ekzaminimin e dokumenteve të caktuara apo gjësendeve si prova materiale, nuk është e qartë a është edhe neni 168(5) gjithashtu I kufizuar. Sidoqoftë, çfarëdo dispozite përjashtimore duhet ti ipet lexim jashtëzakonight I kufizuar.

<sup>10</sup> Neni 218(10) LPP RFJ.

<sup>11</sup> Neni 181(1) LPP RFJ.

<sup>12</sup> LPP RFJ Neni 73(2) parasheh në raste përjashtimore të cilat kyqin qështjet e sigurisë kombëtare, qasja e mbrojtjes mundet *përkohësisht* të kufizohet.

<sup>13</sup> Vendimin për inicimin e hetimeve dhe për vezhdimin e paraburgimit është në të shumtën I bazuar në dosjen policore. Shiko përgjithësisht *Raportin e SMSL* Nr. 7 Id. n.1.

<sup>14</sup> Neni 173(10) LPP RFJ.

<sup>15</sup> Neni 159 (3) LPP RFJ.

<sup>16</sup> Neni 159(5) LPP RFJ.

<sup>17</sup> Neni 267(1) LPP RFJ.

<sup>18</sup> Neni 270 LPP RFJ.



---

<sup>19</sup> SMSL intervistoi më tepër se gjashtëdhjetë të paraburgosur në Prishtinë, pesëdhjetë e dy në Mitrovicë, tridhjetë e pesë në Gjiilan, tridhjetë në Pejë, dhe nëntëmbëdhjetë në Prizren (Ku monitori ka raportuar se intervistimet plotësuese përkritazi me këto qështje ishin pezulluar për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga të paraburgosurit).

<sup>20</sup> Praktika e mohimit të vizitave anëtarëve të familjes gjer pas dëgjimit të parë paraqet cënim të Parimeve 16 (10 dhe 19 të *KB Trupi I Parimeve* dhe Rregullës 92 të *KB Standardet e Rregullave Minimale për Trajtimin e të Burgosurve*).

<sup>21</sup> Autorizimi duhet të mirret sipas nenit 203(1) LPP RFJ.

<sup>22</sup> Monitorët e SMSL kan raportuar se qendrat e paraburgimit në Gjiilan, Mitrovicë, dhe Pejë refuzojnë të lejojnë mbrojtësve qasjen klientëve të tyre përdërisa ata të dëshmojnë se ai apo ajo janë të emruar apo autorizuar për rastin. Përgjithësisht, kjo nuk ngjan gjer në dëgjimin e parë.

<sup>23</sup> Dy prej të katërve mund të ken refuzuar të pranojnë emrimet.

<sup>24</sup> Është e paqartë sa I përket domenit të regjionit se cilit I përket të punojë.

<sup>25</sup> Kopja e fletëlejes është në posedim të SMSL.

<sup>26</sup> LPP RFJ Neni 131 dhe 73 ka të bëjë me qasjen procesverbaleve dhe provave.

<sup>27</sup> Shiko, raste në Pejë dhe Gjiilan.

<sup>28</sup> Në Maj 2000, gjykatësi I kolegjit informoi SMSL se ishte I panjoftuar me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Pasiqë iu prezentua kopja e KNDCP, ai shprehu mosdije të plotë lidhur me dokumentin (ka hyrë në fuqi më 1976).

<sup>29</sup> Gjykatësat janë gjithashtu të paguar dobët: gjykatësat e gjykatës për kundërvajtje paguhen përafërsisht 480 DM/në muaj, gjykatësat e gjykatës komunale paguhen përafërsisht 600/në muaj, gjykatësat e gjykatës së qarkut paguhen përafërsisht 720 DM/në muaj dhe gjykatësit e gjykatës supreme përafërsisht 840 DM/në muaj.

<sup>30</sup> Testimet e ekspertimeve shtetërore tanipërtani ushtrohet nga autoritetet Bullgare.

<sup>31</sup> Gjykimi I Muriukit e të tjerëve u mbajt në Gusht 2000. Mbrojtësi ishte I përkrahur nga mbrojtësi I angazhuar nga Care International, I cili angazhoi hetuesin e tij.

<sup>32</sup> Të gjithë të paraburgosurit nuk kan raportuar të dhëna të tilla ekstreme. Në Prishtinë shtatëmbëdhjetë të paraburgosur raportuan se ata ishin të vizituar së paku një herë në javë. Nëntë të paraburgosur raportuan vizitat e mbrojtësit së paku çdo të dytën javë. Për dallim, në Gjiilan rasti më I mirë I scenarios së vizitave ishte çdo dy javë.

<sup>33</sup> Në katër raste, vizita ishte kufizuar në më pak se 5 minuta; në 8 raste prej pesë gjer dhjetë minuta, në 8 raste prej dhjetë gjer 15 minutadhe në dy raste prej 15 deri më 20 minuta më tepër.

<sup>34</sup> Rregull e SMSL është që të mos përmenden emrat e të miturve, të dënuarve dhe të tjerëve, në dokumentet publike.

<sup>35</sup> Seminarët dhe puntoritë për gjykatësit dhe prokurorët e rinj të emruar u mbajt në Mars, Korrik, dhe Gusht 2000. Të gjithë pjesëmarrësit ishin të siguar me tekstet themelore të KEDNJ dhe materialet e praktikës gjyqësore (teksti I Konventës, Udhërrëfyes I shkurtër për Konventë, Përmbledhje Rastesh dhe Rastet Kyqe, në gjyhën shqipe).

## SEKSIONI 6 : KRIMET E LUFTËS DHE ATO ETNIKISHT TË MOTIVUARA PAANSHMËRIA E GJYKATAVE

### **I. Shtytja për Ekspedimin e Gjykimeve**

Më 10 Prill 2000, 32 të paraburgosur Serb, të mbajtur në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë filluan grevën e urisë. Gjer më 3 Maj 2000 ky numër është ngritur në rreth 36. Shumica e grevistëve të urisë ishin të etnicitetit Serb dhe ballafaqoheshin me akuza për krime lufte apo krime serioze të motivuara etnikisht. Sipas statistikave disponuese nga SMSL, më 3 Maj 2000 përafërsisht 25 prej grevistëve të urisë ishin të arrestuar dhe/ose të paraburgosur nga mes- Gushti dhe Shtatori 1999, shumica prej të cilëve mbetën të pa-akuzuar.

Me letrën drejtuar PSSP të datuar 21 Prill 2000, grevistët e urisë vunë në pah se ata po reagonin për mungesën e ekspeditimit të duhur të rasteve të tyre nëpër gjykata dhe mungesën e paanshmërisë në një pjesë gjykatash. Greva është nderur, së paku në një pjesë, nga anshmëria e paramenduar e gjykatave për lirimin e një mashkulli Shqiptar të Kosovës, të akuzuar, për siq thuhej, hudhje të granatës në një turmë në Mitrovicë. Greva e urisë, e kombinuar me skadimin e pashmangshëm të maksimumit të limitit kohor të paraburgimit, solli gjer tek inkurajimi i gjyqësisë për caktimin e gjykimeve për krime lufte dhe etnikisht të motivuara. Si plotësim, Rregullorja nr. 2000/34 siguron autorizimet për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë nëpër tërë Kosovën.<sup>1</sup>

Ekspedimi i gjykimeve sidoqoftë nuk është bërë për shkak të kapaciteteve egzistuese dhe kompetencës së sistemit gjyqësor për zhvillimin e gjykimeve serioze penale të kësaj natyre në mënyrë korrekte dhe të rregullt. Për më tepër, klima e gjatë dhe e vazhdueshme e konfliktit etnik, ka ndikuar rëndë mbi paanshmërinë objektive të gjykatave dhe ka ngritur brengat mbi anshmërinë aktuale në një pjesë të caktuar të kolegjeve gjyqësore. Përgjegjja e autoriteteve relevante ka qenë reaguese dhe *ad hoc* – duke rezultuar në trajtimin e pabarabartë të të pandehurve para gjykatës dhe mohimin e lehtësirave themelore me të cilat do të pregatitet dhe presentohet në mënyrë adekuate mbrojtja.

### **II. E drejta në një Gjykatë të Paanshme**

Neni 6(1) KEDNJ dhe Neni 14(1) KNDPC garantojnë të drejtën në dëgjim të drejtë dhe korrekt nga një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të përcaktuar me ligj. Parimi 2 I *Parimeve Themelore Mbi Pavarësinë e Gjyqësisë* i përforcon këto dispozita:<sup>2</sup>

“Gjyqësia vendos çështjet para tyre në mënyrë të pavarur, në bazë të fakteve dhe në pajtim me ligjin, pa restriksione dhe influenca të papërshtatshme, shtytje, presione, kërcënime apo ndërhyrje, direkte apo indirekte, prej çfarëdo këndi apo çfarëdo arsye.”

Kjo garancë është interpretuar gjërësisht, në njohje të faktit se pavarësia dhe paanshmëria janë predispozitat për korrektësinë e procedurës gjyqësore. *Komiteti për të Drejtat e*

Njeriut ka gjetur se e drejta për një gjykatë të paanshme sipas nenit 14(1) të KNDPC është “ absolute” dhe “nuk pëson asnjë përjashtim”.<sup>3</sup>

KEDNJ nuk përshkruan ndonjë formë të veçantë për procedurën penale vendase, sidoqoftë, autoritetet relevante janë ndër obligimin pozitiv të sigurojnë që ndonjë, dhe të gjitha procedurat e këtilla garantojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatave. Ky obligim pozitiv është konfirmuar në Parimin 1 të *Parimeve Themelore*.<sup>4</sup>

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka marrë shumë vendime të ndërlidhura me çështjen e paanshmërisë. Në *Hauschildt v Denmark*, Gjykata muar qëndrim, se për pajtim me kërkesat nga neni 6(1) për paanshmëri, gjykata duhet të respektojë, si testin subjektiv ashtu edhe atë objektiv:

“ Ekzistimi i paanshmërisë për qëllimet e Nenit 6(1) duhet të determinohen në pajtim me testin subjektiv, i cili është në bazat e bindjes personale të gjykatësit të cakuar në çështjen e caktuar, dhe gjithashtu në pajtim me testin objektiv, i cili është përcaktues se a ofron gjykatësi, garanca të mjaftueshme për përjashtimin e çdo dyshimi ligjor lidhur me rastin.”<sup>5</sup>

Testi subjektiv procedon në supozimin se anëtarët e gjyqësisë janë të paanshëm. Gjykatësi duhet të tregoj se vepron në bazë të anshmërisë personale në dështim të testit subjektiv. Me dhënjen e këtij supozimi dhe me nevojën për vërtetimin e anësisë, Gjykata shumë rrallë, nëse ndonjëherë, ka gjetur tribunalin në shkelje të testit subjektiv.<sup>6</sup>

Testi objektiv nuk është aq strikt dhe nisët nga doktrina e të drejtës zakonore se “ *drejtësia nuk duhet vetëm të bëhet; duhet të shihet duke u bërë.*”<sup>7</sup> Theksi i Gjykatës Evropiane për pamjen, rrjedh nga nevoja e gjyqësisë së një shoqërie demokratike për promovimin e besimit publik.

Testi objektiv është zgjëruar për të përfshirë më tepër se këndvështrimi i të akuzuarit:

“[...] secili gjykatës, në lidhje me të cilin ekziston shkak ligjor për frigë, për shkak të mungesës së paanshmërisë, duhet të tërhiqet...[...] këndvështrimi i të akuzuarit është i rëndësishëm por jo vendimtar. Vendimtare është se a është friga objektivisht e arsyeshme.”<sup>8</sup>

Me ballafaqimin me anësinë racore, Gjykata ka vendosur një prag shumë të lartë provues. Në *Remi v France*<sup>9</sup>, Gjykata gjeti se trinitubali ka dështuar në standardet objektive për shkak të refuzimit të marrjes në konsiderim të vërejtjeve raciste jashtë-gjykatë të anëtarit të kolegjit. Së voni, *Sander v Britania e Madhe*<sup>10</sup> mendohet se udhëzimet e një gjykatësi gjykues dhënë kolegjit, nuk ishte e mjaftueshme për lehtësimin e dukjes objektive të anshmërisë, bazuar në një shënimi anonim nga një anëtar kolegji që shprehte anshmërinë raciste në një pjesë të kolegëve të tij. Letra e nënshkruar unanimisht e kolegjit, e cila bazohej, sikurse letra e njërit prej anëtarëve të kolegjit, që pranonte dhe kërkonte falje për shprehjen e “mahive” raciste, ishin garanca të pamjaftueshme për përjashtimin e çfarëdo dyshimi objektiv të arsyetuar apo ligjor, në paanshmërinë e gjykatës. Gjykatësit duhej të

përgjigjeshin në kërkesat e mbrojtjes dhe të shkarkojnë kolegjin.<sup>11</sup> Në *Sander*, gjykata në mënyrë eksplicite deklaroi se kur ka të bëjë me anshmërinë e shprehur raciste, ajo:

“ e konsideron këtë si qështje serioze, të dhënë se, në shoqëritë e sotme multikulturale Evropiane, çrrënjësja e racizmit është bërë qëllim prioritar për të gjitha Shtetet Kontraktuese (shiko, *inter alia*, Deklaratën e Vienës dhe Samitin e Strasburgut të Këshillit Evropian).”<sup>12</sup>

### III. Aplikimi i Tanishëm: Dështimi në Testin e Paanshmërisë

Kosova suksesivisht ka qenë teatër i represionit politik dhe etnik nga autoritetet e Beogradit, lindja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), raportimi i akteve të tmerrshme të kryera gjatë intervenimit të NATO-s dhe tensioni tanishëm i rënduar etnik dhe veprat hakmarrëse. Për më tepër, shumë prej anëtarëve prezent të gjyqësisë ose lan pozitat e tyre më 1989-90 ose iu bashkangjiten të ashtuquajturit sistemit paralel të qeverisjes. Shumica ka vuajtur, në mënyrë direkte apo indirekte, nga brutaliteti dhe represioni i regjimit të Beogradit. Që nga emergjenca e e sistemit të krijuar gjyqësor në Kosovë, si gjykatësit ashtu edhe prokurorët publik kan shprehur brengosje për sigurinë e tyre, përkitazi me pozitat publike që mbajnë.<sup>13</sup> Sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, siq është përmendur më lart, është obligim i autoriteteve të sigurojnë një mjedis në të cilin zyrtarët publik janë të lirë të marrin vendime të paanshme.

#### (a) Perceptimi i të Pandehurit dhe i Publikut

Në dritë të klimës së vazhdueshme të jotolerancës etnike, standardi më pak i rreptë i paanshmërisë objektive mund në mënyrë të kundërshtueshme të çenohet në rastet kur tribunali mono-etnik gjykon anëtarët e minoritetit Serb të Kosovës, Boshnjak-Musliman apo Rom.<sup>14</sup>

Testi i paanshmërisë objektive është posaqërisht brengosës me perceptimet e palës së tretë – të të akuzuarit apo publikut në përgjithësi. Shkeljet potenciale të standardeve objektive sipas nenit 6(1) të KEDNj nuk ndërlidhin drejtëpërsëdrejti kritikën në integritetin profesional, apo anshmërinë personale etnike apo individuale të anëtarëve të gjyqësisë Kosovare. Ato janë në fakt pasojë e klimës së gjërë politike dhe sociale që ekziston në Kosovë dhe brengosjet e vazhdueshme lidhur me trajtimin e minoriteteve.

#### *Bozhur Bishevac dhe Miroslav Vučković*

Rast i *Bozhur Bisevac* dhe *Miroslav Vuckovic* është ilustrim i mirë i qështjes së paanshmërisë. *Bisevac* dhe *Vuckovic* janë Serb të Kosovës të akuzuar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, për gjenocid. Më 13 Korrik 2000, duke u bazuar në një numër shtyerjesh të rastit, këshilltari mbrojtës për *Bisevac* ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e kolegjit gjyqësor, përfshirë këtu edhe gjykatësin ndërkombëtar, Kryetarin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, dhe gjykatësit e Gjykatës Supreme të Kosovës. Bazat për përjashtim përfshinin në mes tjerash, dështimin për të garantuar paanshmërinë e kolegjit. Mbrojtja kontestonte se, në dritë të faktit, se gjykatësit Shqiptarë të Kosovës janë nga e njëjta

grupë etnike, se të të pandehurit thuhet se “kan patur qëllim të shkatrojnë plotësisht apo pjesërisht“ ata nuk mundën të bëhen arbitër të paanshëm të rastit. Më specifikisht, mbrojtja deklaroi se Kryetari i Kolegjit ishte “ pala e dëmtuar”, për faktin se zyret e tij dhe shtëpia, ishin plaqkitur dhe djegur gjatë konfliktit. Banesa e Kryetarit të Gjykatës së Qarkut, siq është raportuar, gjithashtu ishte thyer dy herë gjatë konfliktit. Në Gusht 2000, Gjykata Supreme e Kosovës refuzoi kërkesën e mbrojtjes. Sipas udhëzimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, SMSL kërkoi nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë kopjen e vendimit lidhur me ankesën. Kryetari i kolegjit e refuzoi kërkesën. Sipas informatës me të cilën disponon SMSL, gjykimi do të zhvillohet para kolegjit të njëjtë të gjyqtarëve.

LPP i RFJ parasheh diskualifikimin e gjykatësve nga kolegjii në rastet kur ” rrethanat e fituara shkaktojnë *dysim në paanshmërinë e tyre*” .<sup>15</sup> (theksimet e nënvizuara)

Ligji parasheh se diskualifikimi do të ndodhë sipas kërkesës së palës, apo sipas vullnetit të gjykatësit. *Rregullorja e UNMIK-ut 1999/7* ka themeluar Komisionin Këshilldhënës Gjyqësor (KKGj), me përgjegjësi për këshilldhënje PSSP-në për emërimet, dhe pranimin e ankesave, në relacion me, gjykatësit dhe prokurorët.<sup>16</sup> Duke patur parasysh brengosjet lidhur me paanshmërinë e përshkruar më lart, Sekcioni 5(2) i Rregullores parasheh, se në vlerësimin e kërkesave udhërrëfyese duhet të mirret nga “qëllimet e UNMIK-ut për konstituimin një gjyqësie profesionale, të pavarur, të paanshme dhe multietnike, dhe shërbimit të prokurorisë.” Për më tepër, sipas, Sekcionit 7, gjykatësit dhe prokurorët mund të largohen prej zyreve, nga PSSP, në konsultim me KPK. Bazat për largim, përfshijnë, mes tjerash, “mosveprimin serioz” ose kur janë ” vendosur, nga veprimi personal ose ndryshe, në pozitën e cila është e papajtueshme me ekzekutimin e rregullt të zyes”.

Pëkundër dispozitave të ligjit vendas dhe Rregullores 1999/7, nuk ka sistem efektiv për hetime dhe largim të gjykatësve dhe prokurorëve. SMSL nuk ka në dijeni ndonjë gjykatës i cili është larguar nga zyra. SMSL kundërshton se dhënja e betimit zyres dhe vetë-rregullimi nga gjykatësit është masë jo e mjaftueshme me të cilën do të sanohet perceptimi objektiv i anshmërisë në relacion me kolegjet gjyqësore për gjykimet e krimeve të luftës dhe ato etnikisht të motivuara.

#### **(b) Anshmëria Aktuale e Gjykatave**

Përderisa kemi parasysh prezumimin e paanshmërisë subjektive, është një numër i rasteve që ka ngritur brengosje reale lidhur me anshmërinë aktuale të gjykatave.

#### **Paraburgimi Para-gjyqësor**

Trajtimi i pabarabartë i minoriteteve përkitazi me paraburgimin para-gjyqësor është ngritur në një numër rastesh. Më 12 Korrik 2000, tre Serb të Kosovës, përfshirë edhe dy priftë, janë lënduar pas një sulmi nga një grup i armatosur në Gjilan. Të njëjtën ditë dy mashkuj Shqiptarë janë arrestuar dhe paraburgosur përkitazi me sulmin dhe janë ngarkuar për tentim- vrasje. Urdhëri origjiner për paraburgim është bazuar në katër bazat për paraburgim, të parapara në Nenin 191 (2) të LPP RFJ. Kolegji i gjykatësve ka zgjatur paraburgimin më 11 Gusht 2000, për tridhjetë ditë, me bazë, se të pandehurit mund të

ndikojnë, ose të shkatrojnë, provat e rastit. Bazat tjera për paraburgim siq janë rreziku i ikjes apo përsëritja e veprës, pa arsyetim, duken se më nuk janë aplikuar. Baza e katërt lidhur me rendin publik nuk është cituar fare.

Më 14 Gusht 2000, njëra nga viktimat dështoi të marrë pjesë në dëgjimin hetues. Ai informoi gjykatën se, veq tjerash, ishte i brengosur për sigurinë e tij dhe ai shprehu dëshirën që gjykatësi ndërkombëtar të caktohet për rastin. Më 18 Gusht 2000, që të dy të pandehurit u liruan sipas urdhërit të gjykatësit hetues, edhe pse hetimet vazhdonin. Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Gjilan informoi SMSL se arsytet për lirim ishin se “dëshmitarët ishin jokooperativ”.

SMSL ende nuk është në gjendje të fitoj qasjen në dosjen e lëndës me qëllim që të bëjë një vlerësim të detajizuar për bazën e paraburgimit apo lirimit. Sidoqoftë, sipas informatës tani për tani në disponim, gjykata si duket ka dështuar të sigurojë çfarëdo baze të arsyetuar për lirim, dhe ka vepruar në bazë tërësisht irelevante lidhur me qështjen e paraburgimit.

Ka edhe raste të tjera që tregojnë mungesën e paanshmërisë në një pjesë gjykatash për sa i përket vendimeve për paraburgimin. Më 10 Mars 2000, “X”, një Shqiptar i Kosovës, ishte arrestuar nga KFOR-i pasi që ishte njohur nga ushtarët e KFOR-it si kryesi i sulmit me granatë në Mitrovicën Veriore gjatë peridhës së dhunës serioze ndër-etnike në Shkurt 2000. X ishte ngarkuar sipas Nenit 157 (3) të LPK për “shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm”, veprë penale në kompetencën e Gjykatës së Qarkut. Sidoqoftë, rasti është deleguar në Gjykatën Komunale. Më 10 Prill 2000, prokurori propozoi që paraburgimi kundër X, të zgjatet duke u bazuar në atë se hetimet nuk janë përfunduar dhe se ka disa dëshmitarë, deklaratat e të cilëve duhet të mirren. Gjykatësi hetues nuk u pajtua, dhe ndërpreu paraburgimin, në bazën e cila kundërshtonte hetimet që vazhdonin “ lirimi i të dyshimtit nuk mund të shkatroji gjurmët e veprës dhe ai nuk mund të ndikoi gjatë fazës hetimore”. Sidoqoftë, LPP I RFJ obligon që mospajtimi mes prokurorit dhe gjykatësi hetues për sa i përket ndërprerjes së paraburgimit, duhet të vendoset nga kolegji i gjyqtarëve. Aty nuk ka patur fare vendim nga kolegji i gjyqtarëve dhe X ishte liruar. Lirimi i X shkaktoi grevën e zgjatur të urisë, së të paraburgosurve Serb të cilët venin në pah se gjyqësia e Mitrovicës anonte kundër tyre.

Lirimi i të pandehurve në rastet e më sipërme është në kontrast me trajtimin e të pandehurve Serb të Kosovës. *Dragan Sekulic* ishte paraburgosur më 14 Tetor 1999 për shkak të vrasjes së djalit të tij, dhe ka mbetur në paraburgim nga ajo datë. Përkundër aktakuzës e cila është ngritur nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 7 Janar 2000, ende nuk është caktuar dita e gjykimit. Kryetari i Gjykatës është raportuar të ketë thënë se vonesa është për shkak të mungesës së gjykatësve. Përafërsisht dymbëdhjetë të pandehur të cilët ishin të akuzuar ne mes-Tetorin 1999 dhe Janarin 2000, për vrasje apo vepra në relacion me vrasje, janë gjykuar apo janë liruar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Për më tepër, trembëdhjetë të pandehur të tjerë, të akuzuar për vepra të ngjashme prej Shkurtit dhe Prillit 2000, gjithashtu janë gjykuar apo liruar. *Të gjithë* nga këto raste kanë të bëjnë me të pandehurit Shqiptarë të Kosovës.

## **Rasti Zymer Thaqi**

Më 16 Nëntor 1999 *Zymer Thaqi*, Shqiptar i Kosovës ishte akuzuar për vrasje të një Serbi të Kosovës. Raporti i autopsisë theksonte se viktimë "Y" ka vuajtur asfiksi dhe thyerje të kafkës dhe brinjëve. Trupi si duket kishte qenë i djegur për së gjalli. Trupi është gjetur para shtëpisë së një Serbi të Kosovës, brenda së cilës është gjetur qertifikata mjekësore. Është besuar se emri në qertifikatë ishte i viktimës. Thaqi ishte i dyshuar për bashkëkryerje me 14-vjeqaren Shqiptare të Kosovës "Z", kundër të cilës, për shkak të moshës së përgjegjësive penale, nuk është ngritur aktakuza.

Në deklaratën dhënë Policisë së UNMIK-ut, si duket në mungesë të prindërve, kujdestarit apo përfaqësuesit ligjor, Z pranoi të ketë asistuar *Thaqin* në vrasje. Në deklaratën e Thaqit para Policisë së UNMIK-ut, ai paraqiti mbrojtjen sipas alibisë dhe vuri në pah se dy individë janë dëshmitarë se Z, në kohën relevante, ka sulmuar viktimën. Ka qarje të theksueshme në mes të kësaj deklarate dhe deklaratës para gjykatësit hetues. Gjatë dëgjimit hetimor Z gjithashtu ndryshoi deklaratën e saj të parë dhe indikoi se Thaqi nuk ishte prezent gjatë vrasjes dhe se Z ka vepruar vetëm dhe në vetëmbrojtje.

Gjykimi është mbajtur në data të ndryshme në Prill, Maj, dhe Qershor 2000, para kolegjit të gjithë Shqiptarë të Kosovës në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Me kërkesën e prokurorit, raporti i autopsisë është futur në procesverbal me qëllim identifikimi të viktimës. Mbrojtësi ka reaguar në këtë kërkesë.

Më 2 Qershor 2000, prokurori publik hodhi poshtë aktakuzën. Prokurori deklaroi se " sipas deklaratave të dëshmitarëve, në fshat nuk ka patur Serb në at kohë, pasi që të gjithë kan shkuar. Nga kjo, është e paqartë kush është viktimë. Pasi që trupi është djegur, është e pamundur që qertifikata të jetë gjetur në trup. Nga ana tjetër, nuk ka prova se viktimë ka qenë pronar i shtëpisë. Nga këto shkaqe kam vendosur që ta hudhi poshtë aktakuzën kundër Thaqit."

SMSL bisedoi me prokurorin, i cili vërtetoi se ka hudhur poshtë aktakuzën, në pajtim me Nenin 262(1)(2) të LPP RFJ, sepse trupi nuk ka mundur të identifikohet. Sipas prokurorit, bazat tjera për hudhje poshtë të aktakuzës janë mungesa e provave, që rrjedh fillimisht nga ndryshimi i deklaratës së Z. Si shënim, këto baza plotësuese nuk janë paraqitur nga prokurori publik gjatë hudhjes poshtë të aktakuzës në gjykim.

Neni 262(1)(2) LPP RFJ ka të bëjë me kërkesat e aktakuzës. Aktakuza duhet të përmbajë, mes tjerash, " përkryerjen e aktit... objektin në të cilin, dhe mjetet me të cilat është kryer vepra, dhe rrethanat tjera të domosdoshme që sigurojnë sa më saktësisht që mundet, definicionin e veprës." Në shumicën e sistemeve penale, kur është prurë akuza për vrasje, identifikimi i trupit nuk është esencial për zhvillimin e ndjekjes. SMSL beson se LPP RFJ nuk është përjashtim përkitazi me këtë. Përderisa Neni 262 LPP RFJ kërkon nga prokurori që të sigurojë informata detale në aktakuzë, nuk kërkon identifikimin e viktimës në çdo rast. Për më tepër, përkundër ndryshimit të deklaratës së Z, ka patur mospërputhje të theksuara në prova të atilla që kolegji ka mundur në mënyrë të arsyetuar

të marrë në konsiderim akuzën për vrasje. Është evidente se ose për shkak të jokompetencës apo anshmërisë etnike:

- i. autoritetet relevante kanë dështuar të zhvillojnë rastin me kujdes të duhur, posaqërisht në dështimin për thirrjen e dëshmitarëve relevant dhe për shqyrtimin e papajtueshmërive në prova;
- ii. Prokurori publik, me pranimin e heshtur të kolegjit, ka hudhur poshtë akuzën në bazë josubstanciale sipas ligjit, dhe tërësisht kontradiktore në dritën e fakteve që prokurori ka kërkuar raportin e autopsisë të futet në procesverbal për qëllim të identifikimit të viktimës.

### **Rasti Besim Berisha**

Më 20 Mars 2000, *Besim Berisha* është liruar, nga kolegji të gjithë Shqiptarë të Kosovës, për vrasje të një mashkulli Serb të Kosovës. I pandehuri është identifikuar në paradën e identifikimit nga dy anëtarë të familjes së viktimës, të cilët ishin prezent gjatë vrasjes. Të pandehurit gjithashtu “kan pranuar” se kanë kryer veprën në qeli, “X”.

Mbrojtja e Berishës ishte alibi. Vepra thuhet të ketë ndodhur më 2 Gusht 1999 në 20:45. I pandehuri deklaroi se në kohën relevante ai ka qenë i paraburgosur nga KFOR-i Italian në Pejë, derisa ishin duke shkuar në mbledhinë e UÇK-së. Ai ftoi dy dëshmitarë të mbështesin deklaratën e tij, përfshirë edhe X. Për më tepër, mbrojtja mbështetej në faktin se gjurmët e gishtërinjëve, të marrura nga mbulesa e tavolinës e cila është përdorur për strangulimin e viktimës, nuk përputheshin me ato të të akuzuarit.

Rasti kundër të pandehurit pësoi kollaps, për shkak të dështimit të prokurorit të kontestojë alibin e të pandehurit dhe mosprezencën e dëshmitarëve okular të prokurorisë.

Më 13 Gusht 1999, në dëshminë para gjykatësit hetues, i pandehuri deklaroi se më 2 Gusht 1999, ai është ndaluar dhe arrestuar nga policia ndërkombëtare në Pejë, ku ai është paraburgosur për dy deri tri ditë. Duke konsideruar se gjykata nuk ka prova kundër këtij pohimi, gjykatësi hetues është dashur të ndërprejë hetimet sepse “nuk ka baza se i akuzuari ka kryer veprën”<sup>17</sup> Por ai nuk e bëri këtë. Dhe as që ndërmorri hapa për hetimin e qështjes së arrestit dhe paraburgimit. Për shembull, ai dështoi të kërkojë nga polici që e arrestoi që të dëgjohet dhe merret në pyetje. Sidoqoftë, kjo ishte një qështje që do të ishte rregulluar me një thirrje telefonike.

Më 22 Nëntor 1999, prokurori publik propozoi aktakuzën me të cilën ngarkohej Berisha, për vrasjen e kryer më 2 Gusht 1999. Çfarë informate pat ai që e bëri të konkludoi se alibi i Berishës ishte i rrejshëm? SMSL ishte informuar nga KFOR-i, se më 1999, ata e siguruan prokurorin me dokumente që indikonin se Berisha nuk ishte në paraburgim më 2 Gusht 1999. Pyetja është se çfarë provash posedonte prokurori, dhe a i janë dorëzuar ato me dosje prokurorit të ri të emëruar në Shkurt 2000? Besohet se po, se pse përndryshe të vazhdohet me akuzimin e Berishës, në Mars 2000?



I pyetur prej SMSL, prokurori i ri i emëruar, siguroi shpjegim tjetër nga ai i KFOR-it Italian. Fillimisht, ai deklaroi se dokumentet ishin në gjuhën të cilën ai nuk e kuptonte. Ai pastaj deklaroi se nuk i kishte parë ato dokumenta sepse ishin të “mbyllura” nga gjykata. Pastaj shtoi se ai nuk kishte propozuar një aktakuzë të tillë “ku të gjitha provat...indikojnë pafajsinë”. Ai nuk mund të shpjegonte, pse ka pritur dy muaj për hapjen e tyre. Nga përvoja e tij, ai tha se informatat e përmbledhura nga organet e zbatimit të ligjit, nuk janë të sigurta.

Për mosprezencën e dëshmitarëve, prokurori deklaroi se thirrjet për gjykatë u janë bërë në adresën e vjetër në Prishtinë, por tani ata janë larguar në Beograd, dhe nuk e din se ku janë vendosur. Ai deklaroi se policia e UNMIK-ut ka informuar gjykatën me shkrim se për shkak të marrëdhënjëve të rënduara me Serbinë, ata janë në pamundësi për të ndihmuar në sjelljen e dëshmitarëve në gjykim. Zyra e Policisë së UNMIK-ut për ndërlidhje me gjykatat, ka shkruar memorandumin konfliktor lidhur me rastin. Sidoqoftë, gjykatësit dhe prokurori muarrën mjete krejtësisht joadekuate për të hetuar se çfarë hapash të ndërmerren për të zbuluar dhe ftuar dëshmitarët. Në kërkesën e prokurorit që të lexohen deklaratat e tyre në procesverbal, kolegji gjykues refuzoi që të njëjtat të lexohen.

Pas liritimit, SMSL pati një numër bisedash për informim, me prokurorin,. Prokurori publik kishte bërë ankesën kundër vendimit të gjykatës. Përkundër kësaj, në dritë të fakteve, se provat kryesore dhenë dispozicion, nuk ishin mbledhur për gjykim, SMSL mendon se ekzistojnë baza për të dyshuar, se, ose për shkak të jokompetencës apo për shkak të anshmërisë, janë bërë përpjekje të vogla apo nuk janë bërë fare, për hetimin e duhur dhe ndjekjen e rastit Berisha. Në Prill 2000, SMSL përmbledhi raportin lidhur me rastin tek DPJ KB me rekomandim për hetimin e rastit, SMSL nuk është në dijeni për ndërmarrjen, nëse ka, të ketij hetimi.

## **Rasti Momqilloviq**

### *Sfondi*

Më 8 Gusht 2000, Gjykata e Qarkut në Gjilan liroi tre mashkuj Serb të Kosovës, *Mirolub, Boban, dhe Jugoslav Momqilloviq* për vrasje dhe tentim vrasje, dy viktime të të cilëve ishin Shqiptarë të Kosovës. Ata ishin dënuar për armëmbajtje joligjore (një pushkë automatike, një gjysmë automatike, dy revole dhe një pushkë) me dymbëdhjetë muaj burgim. Pavarsisht nga aktgjykimi, SMSL nxorri raportin “*Drejtësia në gjykim: Rasti Momqilloviq*”, të datës 16 Gusht 2000. Raporti nënvizon katalogun e shkeljeve të ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, që përfshin brengosjet përkitazi me paanshmërinë e gjykatave.

Me 10 Korrik 1999 katër mashkuj Shqiptarë të Kosovës, iu qasën shtëpisë së familjes Momqilloviq. Të pandehurit ishin brenda shtëpisë. Një pjesë e ngjarjes është kapur nga video sigurorese.

Video tregon se katër mashkuj Shqiptarë të Kosovës të armatosur dhe ata i qasën shtëpisë së Momqilloviqëve dhe e thrrasin njërin prej tyre të del jashtë. Një krismë pushke

dëgjohej të vjen, si duket nga shtëpia e Momqiloviçëve. Në këtë fazë duket se asnjëri nga mashkujt Shqiptarë të Kosovës nuk është lënduar. Kjo përcillet nga një shkëmbim I rëndë zjarri. Snajperistët e KFOR-it SHBA ishin prezent në vendin e ngjarjes dhe ata kyqën mashkujt Shqiptarë të Kosovës. Si rezultat I shkëmbim zjarrit, dy mashkujt Shqiptarë të Kosovës ishin vrarë dhe dy të tjerë ishin të lënduar. Momqiloviçët ishin akuzuar për vrasjen e një mashkulli Shqiptar të Kosovës dhe tentim vrasjen e tjetrit. Një Shqiptar I Kosovës ishte akuzuar me tentim vrasje të ushtarit të KFOR-it të SHBA.

Gjykimi i parë filloi me 25 Prill 2000, në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës para kolegjit të gjithë Shqiptarë të Kosovës. Bazuar në kërkesën për prova të reja, rasti ishte shtyrë për 27 Prill 2000. Pas një vonese të theksuar, gjykimi i ri ishte caktuar për 20 Korrik 2000 para kolegjit të ndryshuar i cili përfshinte një gjykatës ndërkombëtar. Ishte gjatë gjykimit të dytë, kur deklaratat e ushtarëve të KFOR-it SHBA, që ishin prezent gjatë shkëmbim zjarrit dolën në dritë. Këto deklarata indikuan se shumica e ushtarëve të kyqur në shkëmbim zjarri, në mes 10 dhe 17 Korrikut 1999, kan dhënë aktualisht deklarata me shkrim apo verbale, Departamentit për Hetime Penale Ushtarake të SHBA (DHPU), duke thënë se ata, e jo Momqiloviçët, ishin përgjegjës për lëndimet e dy personave të përmendur në aktakuzën e Momqiloviçëve. Gjer më tani, nuk është siguruar shpjegim se pse kjo informatë nuk i është bërë e ditur gjykatës më heret.

#### *Paraburgimi para-gjyqësor*

Momqiloviçët kan qenë të paraburgosur më 10 Korrik 1999. Gjykata e Qarkut në Gjilan filloi dëgjimin e rasteve penale më 17 Shkurt 2000, afro shtatë muaj pas paraburgimit të tyre fillimtar. Në njëmbëdhjetë gjykimet para gjykimit të parë të Momqiloviçëve më 25 Prill 2000, të gjithë të pandehurit ishin Shqiptarë të Kosovës. Gjashtë nga këta të pandehur mbaheshin në paraburgim, edhe pse asnjëri më tepër se Momqiloviçët. Pasiqë si duket të gjitha provat relevante ishin të mbledhura para ngritjes së aktakuzës më 7 Janar 2000, nuk ka arsytim për vonesë të gjykimit gjer në Prill 2000.

Kjo vonesë më tej është acaruar me shtyerjen e gjykimit të parë më 27 Prill 2000, në pritje të provave të tjera. Dështimi I gjykatës të rezumoj dëgjimin brenda tridhjetë ditëve rezultoj me braktisjen e gjykimit të parë. Data e re në Korrik ishte caktuar për gjykim, në fund të Qershorit 2000.

#### *Ndjekja Qëllimkeqe e Motivuar nga Etniciteti i të Pandehurve*

Prokurori publik ishte caktuar më 18 Janar 2000. Kah mesi i Shkurtit 2000 prokurori vërtetë ishte i njoftuar për ekzistimin e videos – ai ishte vizituar nga një numër i mediave ndërkombëtarë që pyesnin pyetje në lidhje me të. Prokurori publik e informoi SMSL se ai e ka shikuar videon për “ katër orë” në Prillin e vonë 2000 dhe se ai nuk kishte parë “asgje për interesim”. Kjo vërejtje është e bafasishme pasiqë, së paku, video tregon qartë katër mashkuj të armatosur që i qaseshin shtëpisë së Momqiloviçëve. Për më tepër, në gjykimin e parë, prokurori pa të udhës që pasiqë video ishte ndërlidhur duhej të përjashtohet. Në shumicën e sistemeve juridike penale, në mungesë të provës së qartë të

ekspertit që do të kontestonte autenticitetin, video e këtij lloji do të kishte patur rëndësi të theksuar provuese.

Deklaratat e KFOR-it SHBA ishin të lexuara në procesverbalin e gjykimit më 24 Korrik 2000. SMSL ishte i informuar se në fakt këto deklarata kan qenë në shërbim të gjykatës më 18 Korrik 2000 dhe se përmbajtja e tyre i ishte e njohur kolegjit gjykues, dhe prokurorit publik me 20 Korrik 2000. Me të vërtetë, gjatë marrjes në pyetje më 24 Korrik 2000, prokurori publik falenderoi Armatën e SHBA “për sigurimin e provave të reja, pasi që, ato i sjellin dritë të re rastit” .

Deklaratat e KFOR-it SHBA ishin kryesoret për mbrojtjen, dhe tërësisht minuan rastin e prokurorit. Ishte tepër e qartë në këtë fazë, se vrasja dhe tentim vrasja ishin të pabazuara. Prapëseprap, prokurori zgjodhi të procedoj sipas aktakuzës dhe kërkoi, mes tjerash, rekonstruktimin e ngjarjes. Kjo shkaktoi një vonesë tjetër të theksuar të rastit. Për më tepër ai kundërshtoi kërkesën për dorëzani, e cila më vonë u refuzua nga gjykata.

#### *Dështimi për Preventimin e Ndjekjes Qëllimkeqe*

Gjyqtari hetues në 1999, dhe kolegji gjykues në Prill 2000, dështuan të marrë në konsiderim provat e rastit. Në Prill 2000, dy anëtarët e kolegjit gjykues a shikuan videon para gjykimit. As anëtarët e kolegjit nuk e panë të rrugës të parashtronjë brengosjet e tyre lidhur me bazueshmërinë e ndjekjes.

Me 20 Qershor 2000, kolegji i ri i gjyqtarëve, përfshirë edhe gjykatësin ndërkombëtar morri qëndrim se pranueshmëria e videos do të vendoset pasi që të jetë luajtur në gjykatën e hapur. Video faktikisht është luajtur dy herë. Video dhe eplotësuar me audio provat ishte në kontrast të madh me dëshmitë e dy dëshmitarëve qëndror të prokurorit.<sup>18</sup> Përkundër këtyre kontradiktave kritike, vetëm një prej këtyre dëshmitarëve ishte pyetur përciptë lidhur me dëshmitë e mëparme.

Përmbledhjet e deklaratave të KFOR-it SHBA, gjithashtu dështuan të ndryshojnë veprimet e kolegjit për rastin. Deklaratat shfaqësuan të pandehurit nga akuzat e vrasjes dhe tentim vrasjes, sidoqoftë, duke përcjellur pranueshmërinë e deklaratave, kolegji pranoi heshtazi kërkesën e prokurorisë për prova të reja (në relacion me narkotikët dhe armët) dhe për rekonstruimin e vend-ngjarjes. Kjo shkaktoi vonesë të mëtejme të rastit dhe zgjati paraburgimin e Momqiloviqëve.

Është vlerësim i SMSL se prokurori ka dështuar të zhvilloi me rregull procedurën lidhur me rastin dhe ka cënuar betimin e dhënë zyres. Efekti i kombinuar i videos dhe deklaratave të KFOR-it ishte të ofrojnë prova të qarta në mbështetje të mbrojtjes së Momqiloviqëve. Këto prova u –përplasën- për- fytyrë “provave” të prezentuara nga dy dëshmitarët e prokurorisë, asnjëri prej të cilëve nuk ishte akuzuar për konspiracion për kidnapim, apo për armëmbajtje. Përkundër këtyre fakteve, prokurori vazhdoi ndjekjen për akuza vrasje dhe tentim vrasje, që rezultoi me shtyerjen e mëtejme të rastit dhe zgjatjen e paraburgimit. Duket se ndjekja sipas këtyre akuzave ishte qëllimkeqe. Është vështirë të

gjendet ndonjë shpjegim tjetër për këtë, pos anshmërisë etnike. I njëjti vlerësim vlen edhe për pajtimin e gjykatës me ndjekjen.

### *Vendimi*

*Momqiloviqët* ishin të dënuar me dymbëdhjetë muaj burgim për armëmbajtje joligjore. Në rishqyrtimin e praktikës së dënimeve për për këtë vepër penale, SMSL gjeti se, në Gjilan dhe regjionet tjera, posedimi i vëllimit të vogël të armëve shpesh nuk është subjekt i akuzave penale dhe se shumica e rasteve rezultojnë me dënim më të ulët se dymbëdhjetë muaj burgim. SMSL ka në dijeni vetëm dy raste të tilla ku dënimi ka qenë i ngjashëm, edhe pse SMSL nuk ka dijeni për vëllimin e armëve në ato raste.

### **I mituri Z**

Më 23 Dhjetor 1999 *i mituri*, “Z” ishte akuzuar nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë për gjenocid. Aktakuza pohonte se, bashkarisht me një person madhor dhe me “qëllim të shpërnguljes së Shqiptarëve dhe me qëllim të shkatrrimit të tyre të pjesërishëm apo të tërësishëm *I mituri* “Z” djegu për afërsisht njëqind shtëpi. Z ishte arrestuar dhe paraburgosur më 29 September 1999 dhe ka mbetur në burg prej asaj date.

Disa njëmbëdhjetë muaj pas arrestit dhe paraburgimit të *i miturit Z*, dhe për afërsisht tetë muaj pas aktakuzës, gjykimi i Z filloi me 15 Gusht 2000 në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Kolegji të gjithë Shqiptarë të Kosovës dëgjoi rastin, përderisa ana e prokurorisë ishte përfaqësuar nga prokurori ndërkombëtar. SMSL bëri kërkesë për pjesëmarrje në gjykim, kërkesë kjo e përkrahur nga prokurori ndërkombëtar, mbrojtësit dhe Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Më 24 Gusht 2000, SMSL gjithashtu bëri një kërkesë formale kryetarit të kolegjit. Kjo kërkesë ishte refuzuar në bazë të asaj se sipas LPP RFJ nuk ekziston dispozitë e cila shprehimisht parasheh prezencën e monitorëve të OSBE-së.

SMSL konsideron se akuzat janë të tepruara dhe nuk janë mjaftueshëm të mbështetura në prova. Me tëë vërtetë, sipas informatave në dispozicion të gjatë gjykimit prokurori ndërkombëtar e redukoi aktakuzën në “shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm”<sup>19</sup>.

Më kryesorja në rastin kundër *i miturit Z* ishte pranimi. Pasiqë SMSL I ishte mohuar dëgjimi, SMSL nuk ka qenë në gjendje të konkludoi a ka qenë “pranimi” I dhënë në mënyrë të ligjshme.

Më 13 Shtator 2000, *I mituri* ishte dënuar. Të dytë, si prokurori ndërkombëtar ashtu edhe mbrojtësi propozuan lirimin e tij. Kjo ishte refuzuar nga kolegji I cili e dënoi të miturin me “masa edukuese-korrektuese” me propozim për dërgimin e të miturit Z në institucion korrektues.

## **Gjykimi i Zvezdan Simiq**

*Zvezdan Simiq* ishte i akuzuar më 6 Janar 2000, për vrasje të rëndë, të dy Shqiptarëve të Kosovës në fshatin Oshlan më 27 Shtator 1998. Ai ishte akuzuar poashtu me armëmbajtje joligjore. Gjykimi u mbajt më 1 Gusht 2000 dhe përfundoi më 8 Gusht 2000. *Simiq* ishte dënuar me tetë vjet e gjashtë muaj burgim.

Provat kundër *Simiqit* konsistonin në armët e gjetura në lokalet e tij dhe në dëshmitë e dëshmitarëve. SMSL beson se kjo dëshmi nuk mund të jetë e bazueshme sepse dëshmitarët kryesor ofruan dëshmi konfuze dhe spekulative lidhur me prezencën e *Simiqit* në vendin e vrasjes. Një dëshmitar deklaroi se i pandehuri ishte parë duke shkuar në drejtim të vendit ku viktimat ishin vrarë. Dëshmitari tjetër deklaroi se ai ishte në vendin e ngjarjes, ka njohur zërin e tij të përcjellur nga tingulli i krismës. Ai pastaj e ndroi dëshminë e tij dhe deklaroi se ai nuk ka dëgjuar të pandehurin duke folur, dhe se ai as që e njeft të pandehurin. Ai shtoi se i kishte thënë dëshmitari tjetër, se i pandehuri ishte prezent.

### **IV. Tentimet për Sigurimin e të Drejtës për Gjykatë të Paanshme**

#### **(a) Gjykatësit Ndërkombëtar: Një Mjet i domosdoshëm por i Pamjaftueshëm**

Si përgjegje në shqetësimin publik, dhe dhunën etnike në Mitrovicë në Shkurt 2000, PSSP sipas *Rregullores 2000/6* siguruan emërimin e një gjykatësi ndërkombëtar dhe prokurorit ndërkombëtar në Mitrovicë.<sup>20</sup> Më 29 Maj 2000, nën presionin e grevistëve të urisë në Mitrovicë, PSSP sipas *Rregullores 2000/34*, që zgjeron autorizimet për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar në tërë territorin e Kosovës.<sup>21</sup> Në kohën e shkruarjes së këtij raporti, gjashtë gjykatës ndërkombëtarë janë emëruar – dy për Prishtinë, një për Mitrovicë, dy për Gjilan, dhe një për Prizren. Dy prokurorë gjithashtu ishin të emëruar – një në Mitrovicë dhe një në Prizren. Në pajtim me Seksionin 1(2) të *Rregullores*, gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar mund të “zgjedhin dhe marrin përgjegjësi për rastet e reja dhe ato që presin, përbrenda kompetencave të gjykatës për të cilën ai apo ajo janë emëruar.”

Emërimi i personelit ndërkombëtar, në gjykata në një mënyrë do të shmangin disa brengosje sa i përket paanshmërisë. SMSL beson, sidoqoftë, se numri i kufizuar i gjykatësve ndërkombëtar, shpërndarja e tyre sporadike dhe fushëveprimi i kufizuar i autorizimeve, dështon të adresojë në mënyrë adekuate këto brengosje. Burimi i këtyre jopërshtatshmërive bien në dy kategori kryesore:

E para, numri i kufizuar i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar, koha për sa janë emëruar dhe lokalizimi i gjykatësve ndërkombëtar dhe prokurorëve, për rastet ka rezultuar në trajtimin e jobarabartë të të pandehurve. Të pandehurit të cilët ishin ngarkuar për krime etnikisht të motivuarat natyrës dhe seriozitetit të ngjashëm, janë gjykuar nga kolegjet e përbërjes së ndryshme. Disa ishin në përbërje të gjithë gjykatës Shqiptarë të Kosovës, disa tjerë kishin të kyqur gjykatësit ndërkombëtar e, në një rast, gjykatësit porotë Serb të Kosovës. Sa i përket gjykimeve të përfunduara, para 31 Qershorit 2000, që

përfshijnë të pandehurit Serb të Kosovës të akuzuar për vrasje të Shqiptarëve të Kosovës: Më 26 Maj 2000, menjëherë para hyrjes në fuqi të Rregullores 2000/34, *Sasha Maksimoviq* ishte dënuar me trembëdhjetë vite e gjashtë muaj burgim, pas gjykimit para kolegjit të tërë Shqiptarë të Kosovës. Më 3 Qershor 2000, *Dragan Nikoliq* ishte dënuar me njëzet vjet e gjashtë muaj burgim, pas gjykimit para kolegjit të tërë Shqiptarë të Kosovës. Gjykimi i *Nikoliqit* ka ndodhur para hyrjes në fuqi të Rregullores 2000/34. Përkundër, më 28 Qershor 2000, *Nenad Raduloviq* ishte dënuar me 2 vite dhe gjashtë muaj burgim pas gjykimit para kolegjit prej katër gjykatësve Shqiptarë të Kosovës, përfshirë edhe Kryetarin e kolegjit, dhe një gjykatës ndërkombëtarë. Sa i përket dy gjykimeve të përfunduara që përfshijnë Shqiptarët e Kosovës të akuzuar për vrasje të Serbëve të Kosovës: më 3 Mars 2000 *Besim Berisha* është liruar për vrasje të rëndë pas gjykimit para kolegjit të tërë Shqiptarë të Kosovës. Kjo ishte përcjellur, më 10 Maj 2000 me lirim të *Ali Eminit*, përsëri para kolegjit të gjithë Shqiptarë të Kosovës.

Sa i përket gjykimeve dhe hetimeve që janë në vijimësi lokalizimi personelit ndërkombëtar është si duket i rastësishëm. Të pandehurit Serb të Kosovës vazhdojnë të akuzohen nga prokurorët publik Shqiptarë të Kosovës, vërtetë, sipas prokurorit ndërkombëtar për Prizren aktakuza e 7 Gushtit 2000 të shtatë Serbëve të Kosovës në Prizren, përmban akuzat për krime lufte përfshirë edhe vrasjet e më shumë se 100 Shqiptarëve të Kosovës, do të ndjeket nga Prokurori publik Shqiptarë i Kosovës. Arsyetimi i ofruar për këtë nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut ishte se prokurori ndërkombëtar nuk do të kishte kohë të mjaftueshme për të përgatitur gjykimin. Data e gjykimit, sidoqoftë, nuk është caktuar ende.

E dyta, sipas Nenit 23 të LPP RFJ, kolegjet e gjykatave të qarkut duhet të përbëhen prej dy gjykatësve profesional, njëri prej të cilit do të jetë kryetar kolegji, dhe tre gjykatës porotë. Aktgjykimi merret me shumicë votash dhe çdo gjykatës ka votë të barabartë.<sup>22</sup> Në kohën e shkrimit të këtij raporti, vetëm dy gjykatës ndërkombëtar janë emëruar në pozitën e Kryetarit të kolegjit. Sidoqoftë, shpërndarja e barabartë e fuqisë votuese tek të gjithë gjykatësit e redukton shumë çfarëdo ndikimi që gjykatësi ndërkombëtar mund të ketë mbi aktgjykimin potencial të motivuar nga anshmëria etnike. Në këtë drejtim, roli i tanishëm që ka gjykatësi ndërkombëtar është i pamjaftueshëm për sanimin, e së paku, mungesës së paraqitjes objektive të paanshmërisë e cila tani hedh hije në gjykimet të cilat përfshijnë akuzat për krime serioze etnikisht të motivuara.

#### **(b) Masat plotësuese: Mbrojtja e Pabarabartë e Ligjit**

Masat plotësuese për sigurimin e paanshmërisë objektive janë ndërmarrë në gjykimin e *Vuqkoviqit* dhe *Bishevacit*. Që të dy të pandehurit ishin të akuzuar për gjenocid dhe *Bishevac* ishte gjykuar në mungesë. Si plotësim në prezencën e gjykatësit ndërkombëtar, dy gjykatësit porotë Serb të Kosovës ishin emëruar në kolegji, kjo për baraspeshën e shpërndarjes së votave për shmangjen nga mungesa e paraqitjes së paanshmërisë objektive. Ky gjykim ishte shtyrë për 12 Qershor 2000, ku, veq tjerash, gjykatësit porotë Serb të Kosovës dështuan të paraqiten. Gjykimi ende zvarritet.

Përderisa masat plotësuese për paanshmërinë ishin ndërmarrë në rastin *Vuqkoviq* dhe *Bishevac*, masa të tilla nuk ishin ndërmarrë në rastet tjera njësoj serioze që përfshijnë etnicitetet e përziera. Më 20 Korrik 2000 gjykimi në *mungesë* i *Lulzim Ademit* filloi para kolegjit në përbërje prej një gjykatësi ndërkombëtar dhe katër gjykatës Shqiptarë të Kosovës, përfshirë edhe Kryetarin e kolegjit. Ademi është Shqiptarë i Kosovës dhe është akuzuar, përveq tjerash, për krime lufte kundër popullatës Shqiptare të Kosovës, përfshirë edhe vrasjen e një mashkulli Shqiptarë të Kosovës. Ngjajshëm, më 1 Gusht 2000 gjykimi i Zvezdan Simiqit është mbajtur para kolegjit të përbërë nga një gjykatës ndërkombëtar dhe katër gjykatës Shqiptarë të Kosovës, përfshirë edhe kryetarin e kolegjit. Simiqi është Serb i Kosovës i akuzuar për vrasjen e dy Shqiptarëve të Kosovës.

Shpërndarja dhe roli i gjykatësit ndërkombëtar dhe prokurorit publik është ende i pamjaftueshëm për adresimin e brengosjeve në relacion me paanshmërinë objektive, apo për sanimin e rasteve që kyqin anshmërinë aktuale. Përmëtepër, mënyra dhe koha e emërimit dhe përbërja *ad hoc* e kolegeve gjykuese ka rezultuar me trajtimin e pabarabartë të të pandehurve para gjykatave në rastet e natyrës dhe seriozitetit të ngjashëm.<sup>23</sup>

#### **V. Gjykata Kosovare për Krime Lufte dhe ato Etnike (GJKKLE)**

Komiteti Teknik Këshilldhënës për Gjyqësi dhe Zyra të Prokurorisë (“KTK”) ishte konstituuar në Shtator 1999, për këshilla PSSP në lidhje me strukturën dhe administrimin e gjyqësisë dhe zyrave të prokurorisë në Kosovë.<sup>24</sup> Në raportin final të datës 13 Dhjetor 1999, KTK rekomandoi, përveq tjerash, themelimin e një tribunali të jashtëzakonshëm vendor me kompetencë mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe krimet serioze etnikisht të motivuara. Gjykata e propozuar u pagëzua “Gjykata Kosovare për Krime Lufte dhe ato Etnike” (“GjKKLE”).

Qëllimi i GjKKLE ka qenë të ketë kompetencë konkurente me gjykatat vendore, edhe pse me kompetencë të kufizuar përkohësisht kohore. Ngjashëm me GjNKL dhe GjNKR, GjKKLE ishte dashur të përbëhet nga Zyra e Prokurorisë, Kolegjet dhe Shkrimores. Të punësuarit do të ishin vendas dhe ndërkombëtar dhe kolegjet gjykuese të përbëra nga së paku një gjykatës ndërkombëtar dhe dy gjykatës vendor. Strukturat ankesore formojnë pjesë të fushëveprimit, i cili poashtu do të pranojë ankesa nga gjykatat vendore.

Me qëllim të sigurimit të barazisë më të madhe në mes të prokurorisë dhe mbrojtjes, propozimet janë bërë gjithashtu për themelimin e “Zyres së Mbrojtjes.” Ishte theksuar se Zyra do të ishte përbërë nga mbrojtësit ndërkombëtar dhe vendor dhe do të ofrojnë kapacitete dhe ndihmë profesionale për mbrojtësit. Një Zyre e këtillë do të ishte esenciale me qëllim sigurimi të barazisë më të madhe të armëve në mes të prokurorisë dhe mbrojtjes, posaqërisht në relacion me gjykimet serioze penale.

Themelimi i GjKKLE është në vonesë të theksuar për shkak të, veq tjerash, gjetjes së lokaleve të përshtatshme dhe rritjes së buxhetit. Për më tepër, Rregullorja, me të cilën

GJKKLE do të themelohet, ka kaluar një numër shqyrtimesh nga zyrat relevante ligjore në Nju-Jork dhe Prishtinë, dhe për tani mban formën e projektit.

Sipas statistikave në dispozicion të SMSL më 31 Korrik 2000, nga rastet që mund të bien nën kompetencën e GJKKLE, pesë gjykime janë përfunduar që përfshijnë pesë të pandehur dhe dy raste të hudhura poshtë. Përafërsisht shtatëmbëdhjetë raste janë për të shkuar në gjykim para gjykatave të rregullta vendore në muajt që pasojnë dhe, sa më shumë aktakuza që ngriten, duket se kjo figurë do të rritet. Për më tepër, përderisa hetimet lidhur me krime të luftës dhe atyre etnikisht të motivuara janë në vijimësi dhe krimet serioze etnikisht të motivuara vazhdojnë të ndodhin, dhe nuk duket se numri i rasteve që shkojnë në gjykim do të rritet dukshëm. Për më tepër, emërimi i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar në gjykatat e Kosovës kan patur efekt në largimin e ndjenjës për urgjencë për rastet që do të transferohen në kompetencë të veçantë dhe të ndarë.

Duke patur parasysh vështirësitë e përmendura më lart, më 11 Shtator 2000 KB DPJ deklaroi se projekti i GJKKLE nuk do të realizohet dhe se përpjekjet do të koncentrohen në sigurimin e gjykatave vendore me gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë. Është me rëndësi që të rithirren motivet themelore pas GJKKLE për, veq tjerash, siguron se të gjitha burimet materiale dhe profesionale ishin në disponim të gjykatave për zhvillimin e gjykimeve serioze penale në mënyrë të drejtë dhe të sigurojnë që gjykimet të mos jenë të ngarkuara me anshmëri. Përderisa institucioni i GJKKLE është tejkaluar nga rastet-nevoja themelore vazhdon të ekzistoj. Për më tepër, përderisa numri i krimeve të luftës dhe atyre etnikisht të motivuara mund të mos ngritet theksueshëm, ngjarjet e fundit kan filluar të fokusojnë vëmendjen në forma të tjera të krimit, siq janë krimet politikisht të motivuara. A duhet gjykimet e kësaj natyre, të mbahen, do të vendosë një barrë të theksuar mbi kapacitetet e tanishme të gjykatave dhe do të kërkojnë burime speciale logjistike dhe ekspertiza.

Fushëveprimi themelor pas GJKKLE vazhdon të ketë rëndësinë, sidoqoftë një fushëveprim i tillë nevojitet të mos ekzistoj jashtë institucioneve gjyqësore ekzistuese. Fushëveprimi i GJKKLE mundet në një pjesë të rëndësishme të transferohet efektivisht në gjykata duke përdorur, për shembull, kolegjet gjykuese të përbërë nga gjykatësit ndërkombëtar dhe prokurori ndërkombëtar. Sistemi ankimor duhet gjithashtu të reformohet përshtatshëmrisht. Një Zyre efektive e mbrojtjes duhet të jetë gjithashtu një imperativ, me qëllim të pengimit të paraqitjes së jobarazisë së armëve. Efekti i këtyre qasjeve do të ishte të drejtoj resurset me shikim të ndërtimit të kapaciteteve afatgjata të gjykatave.

## **VI. Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ish –Jugosllavinë (TNPJ)**

Pasiqë SMSL nuk monitoron aktivitete e TNPJ, për hir të kompletimit të këtij seksioni, dhe për adresimin e konfuzionit ekzistues, në vijim do të paraqesë thekse të shkurtëra lidhur me mandatin e TNPJ.

Më 29 Shtator 1999, Prokurori i Lartë për TNPJ theksoi rolin dhe përgjegjësitë që TNPJ do të ndërmer sa i përket ngjarjeve në Kosovë.<sup>25</sup> Fokusimi kryesor i punëve të TNPJ



ishite të bëhe hetimet dhe ndjekja e pesë liderëve të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë të cilët ishin akuzuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Prokurori gjithashtu indikoi se TNPJ do të hetoi edhe “nivelet e larta të liderëve civil, policor dhe ushtarak të cilësdo palë në konflikt i cili mund të jetë përgjegjës për krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë”. Pas kësaj, prokurori deklaroi se hetimet mund, në bazë të rast pas rastit, të zhvillohen në relacion me individët tjerë të cilët mund të ken kryer “krime posaqërisht serioze ( përfshirë dhunën seksuale) gjatë konfliktit të armatosur”.

Prokurori rifuqizoi se mandati dhe kapacitetet e TNPJ nuk do të lejoj që ai të veproi si agjensi primarisht hetuese apo e ndjekjes për Kosovë, siq “është si rregull përgjegjësi e UNMIK-ut, përmes UNCIVPOL dhe së voni të formuar Policisë Civile në Kosovë, të ndihmuar nga KFOR-i .” Duke patur parasysh burimet e theksueshme dhe kapacitetet hetimore të TNPJ, janë dhënë udhërrëfyesit të ndihmojnë në publikimin e informatave nga TNPJ autoriteteve relevante përbrenda UNMIK-ut. Esenca e udhërrëfyesit është se publikimi duhet të bëhet na bazë të rast-pas-rastit, duke buruar nga kërkesa specifike e bërë nga autoritetet relevante.

### **Krimet e luftës dhe ato etnikisht të motivuara**

- Bazuar në statistikat e disponueshme nga SMSL më 31 Korrik 2000
- Sk/Shk = etniciteti i të pandehurit /viktimës

<b>Statusi</b>	<b>Gjenocidi<sup>1</sup></b>	<b>Krimet e luftës<sup>2</sup></b>	<b>Vrasjet<sup>3</sup></b>	<b>Dhunimet<sup>4</sup></b>	<b>Tjera<sup>5</sup></b>
<b>Të akuzuar</b>	<b>10</b> Sk/Shk-10	<b>3</b> Sk/Shk-2 Shk/Sk-1	<b>16</b> Shk/Sk-5 Sk/Shk-11	<b>0</b>	<b>8</b> Shk/Shk-2 Sk/Shk-1 Shk/Rk-2 Rk/Shk-1 Shk/Cr-2
<b>Të paakuzuar</b>	<b>2</b> Sk/Shk-2	<b>16</b> Sk/Shk-13 Rk/Shk-3	<b>2</b> Sk/Shk-2	<b>0</b>	<b>2</b> Shk/Sk-2
<b>Në paraburg</b>	<b>11</b> Sk/Shk-11	<b>15</b> Sk/Shk-12 Rk/Shk-3	<b>14</b> Sk/Shk-11 Shk/Sk-3	<b>0</b>	<b>1</b> Shk/Rk-1
<b>Të ikur</b>	<b>0</b>	<b>3</b> Shk/Shk-1 Sk/Shk-2	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Në arrati</b>	<b>1</b> Sk/Shk-1	<b>0</b>	<b>2</b> Sk/Shk-2	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Gjykimet e kryera</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>5</b> Shk/Sk-2 Sk/Shk-3	<b>2</b> Shk/Rk-2	<b>1</b> Shk/Rk-1
<b>Fajtor</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3</b> Sk/Shk-3	<b>2</b> Shk/Rk-2	<b>1</b> Shk/Rk-1
<b>Të pafajshëm</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2</b> Shk/Sk-2	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Aktakuza e hudhur poshtë</b>	<b>0</b>	<b>1</b> Sk/Shk-1	<b>1</b> Shk/Sk-1	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Total Rastet e mbetura</b>	<b>12</b>	<b>19</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>10</b>

<sup>1</sup> Neni 141 LPP RFJ.

<sup>2</sup> Neni 142 LPP RFJ.

<sup>3</sup> Përfshirë vrasjet e rënda, Vrasjet dhe Vrasjet në tentativë.

<sup>4</sup> Përfshirë Dhunimin dhe dhunimin e rëndë.

<sup>5</sup> Përfshirë Vjedhjet, Plaquitjet dhe Kërcnimet.

## Rekomandimet e SMSL

1. Është rekomanduar që PSSP të emëroi dy prokurorë ndërkombëtar në zyrën e prokurorisë pranë Gjykatës Supreme të Kosovë. Prokurorët ndërkombëtarë duhet të jenë i autorizuar për:
  - i. shqyrtimin e të gjitha rasteve të krimeve të luftës dhe atyre etnikisht të motivuara dhe akuzat për gjenocid në mënyrë që të siguroi mjaftueshmërinë e dëshmive për të mbështetur aktakuzën. Ku është e përshtatshme akuzat duhet të ndryshohen;
  - ii. shqyrtimin e rasteve të ngritura në këtë raport të marrin në konsiderim çfarëdo vëllimi të “mosveprimit serioz” në emër të gjykatësve dhe prokurorëve publik duke vlerësuar hetimet apo nëse është baza ligjore për rifillimin e ndjekjes.
2. Rastet që kyqin akuzat për krime lufte, krime serioze etnikisht të motivuara ose krimet e tjera politikisht të ngarkuara duhet të ndjekën nga prokurori ndërkombëtar apo të kryesohen nga një gjykatës ndërkombëtar individualapo kolegji me shumicë të gjykatësve ndërkombëtar.
3. Koncepti i GjKKLE duhet të rikonsiderohet duke pasur parasysh dështimin e menjëhershëm të kapaciteteve dhe kompetencës së gjykatave. Originaliteti i racionalitetit të GjKKLE mbetet i gjallë- dispozita e resurseve materiale dhe profesionale për zhvillimin e gjykimeve të caktuara serioze penale të krimeve të luftës, atyre etnikisht apo politikisht të motivuara dhe prezenca e personelit ndërkombëtar për sigurimin e paanshmërisë në procedurë.

Këto tipare esenciale duhet të përhapen gjërësisht në gjykatat ekzistuese, pa nevojë për elaborimin e lokaleve apo fushëveprimin e GjKKLE. Tiparet qendrore të kësaj qasjeje duhet të përfshijnë veprime të fuqishme të sigurimit, kolegjet ndërkombëtare gjyquese (e cila mund të merr formën e gjykatësit individual apo shumicën e gjykatësve ndërkombëtar), prokurorët ndërkombëtar dhe përkrahjen e fuqishme mbrojtjes.
4. Zyra e Mbrojtjes duhet menjëherë të themelohet dhe të fuqizohet që të sigurojnë materialin dhe përkrahjen substanciale mbrojtjes. Zyra duhet të përfshijë mbrojtësit ndërkombëtar juridik të aftë për tu paraqitur në gjykatë së paku në gjykime me pjesëmarrjen e gjykatësit ndërkombëtar dhe prokurorit.
5. Është rekomanduar që PSSP të institucionalizoj funksionet e Komisionit Këshilldhënës Gjyqësor me çfuqizimin e komisionit dhe me themelimin e Zyres për Hetimet Gjyqësore(ZHGJ) përbrenda Departamentit të Drejtësisë. Një ndërkombëtar duhet të emërohet të udhëheq këtë zyre me qëllim që të siguroj sistem efektiv për hetime dhe largime/disiplinë të gjykatësve dhe prokurorëve publik. ZHGJ duhet të krijoj procedurë për shqyrtimin dhe hetimin e ankesave drejtëpërsëdrejti. Si rezultat i hetimeve, ZHGJ duhet të fuqizohet për disiplinë dhe largim të gjykatësve dhe prokurorëve publik nga rastet individuale apo nga zyra.

<sup>1</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 Mbi Emërimin dhe Largimin nga Zyra e Gjykatësve dhe Prokurorëve Ndërkombëtar, 15 Shkurt 2000, sigurojnë emërimin e një gjykatësi ndërkombëtar dhe një prokurori ndërkombëtar në Mitrovicë. Kjo rregullore është shtri me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/34 Ndryshimet e Rregullores së UNMIK-ut 2000/6 Mbi Emërimin dhe Largimin nga Zyra e Gjykatësit dhe Prokurorët Ndërkombëtar, 29 Maj 2000.

<sup>2</sup> Parimet Themelore kan qenë të adoptuara nga Kongresi I Shtatë mbi Preventimin e Krimit dhe Trajtimin e kryesve të mbajtur në Milano nga 26 Gushti gjer më 6 Shtator 1985. Parimi 1 thotë se “ pavarësia e gjyqësisë do të garantohet nga Shteti dhe parashihet me Kushtetutën e legjislacionit të vendit”. Është detyrë e qeverisë dhe institucioneve tjera të respektojnë dhe vrojtojnë pavarësinë e gjykatave”.

<sup>3</sup> *Gonzales del Rio v Peru* (1993) 2 Raporti I KDNJ, f. 20. Shiko gjithashtu Doracakun mbi Gjykimet Korrekte, nga Amnesti International, Kapitulli 12 (në dispozicion në [www.amnesty.org](http://www.amnesty.org)).

<sup>4</sup> Parimi 1 parasheh se “ pavarësia e gjyqësisë do të garantohet nga Shteti dhe do të përcaktohet me Kushtetutën e legjislacionit të vendit. Është detyrë e qeverisë dhe e institucioneve tjera të respektojnë dhe vrojtojnë pavarësinë e gjyqësisë”.

<sup>5</sup> (1990) 12 EHRR 266, par. 46. Shiko gjithashtu D.J Harris, M. O Boil dhe C. Warbrick, Ligji mbi Konventën Evropiane për Të Drejtat e Njeriut , Londër, Butterworths, 1995, p. 235.

<sup>6</sup> Id, f.234.

<sup>7</sup> *Delcourt v Belgium* (1979-80) 1 KEDNj 253.

<sup>8</sup> *Hauschild v Denmark* në para. 48.

<sup>9</sup> (1996) 22 EHRR 253.

<sup>10</sup> 9 Maj 2000 (Seksioni I tretë).

<sup>11</sup> Gjykata e ndau vendimine saj në *Sanders* nga ajo *Gregory v Britania e Madhe* (1997) 25 EHRR 253, ku kundërshtimet për anshmërinë racore të njërit nga kolegji ishin të dobëta dhe joprecize dhe mbrojtje asnjëherë nuk kërkoi që kolegji të shkarkohet (shiko par.34).

<sup>12</sup> Par.23.

<sup>13</sup> SMSL nënvizon se të gjithë gjykatësve ndërkombëtar dhe prokurorëve iu është ofruar mbrojtja e ngushtë e sigurisë.

<sup>14</sup> Ngjashmëria e Shqiptarit Të Kosovës të gjykuar nga kolegji jo-shqiptarë, është I largët ndaj situatës ekzistuese.

<sup>15</sup> Neni 39(6)LPP RFJ. Përkthimi në përmbledhje të ligjeve përdorë fjalën ”objektivitet ”.

<sup>16</sup> Rregullorja 1999/7 Mbi Emërimet dhe Largimet nga Zyra të Gjykatësve dhe Prokurorëve, 7<sup>th</sup>

<sup>17</sup> Neni 171(1) par.4 LPP RFJ.

<sup>18</sup> Video qartë ishte në kontradiktë me mohimin e dëshmitarëve se kan qenë në posedim të armëveapo se kan vepruar në mënyrë agresive kundrejt Momqiloviqëve.

<sup>19</sup> Neni 157 Ligji Penal I Kosovës.

<sup>20</sup> Rregullorja 2000/6 Mbi emërimin dhe Largimin nga Zyra e Gjykatësve dhe Prokurorëve, 15 Shkurt 2000.

<sup>21</sup> Rregullorja 2000/34 Ndryshim I Rregullores së UNMIK-ut 2000/6 Mbi Emërimin dhe Largimin nga Zyra e Gjykatësve dhe Prokurorëve Ndërkombëtarë, 29 Maj, 2000.

<sup>22</sup> Neni 116 LPP RFJ.

<sup>23</sup> Nenet 16 dhe 26 të *Traktatit Ndërkombëtar për Të Drejtat Civile dhe Politike* e sigurojnë të pandehurin me të drejtën e njohjes para ligjit dh mbrojtjen e barabartë të ligjit.

<sup>24</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 1999/6 Mbi rekomandimet për Strukturën dhe Administrimin e Gjyqësisë dhe Zyrave të Prokurorisë, 7 Shtator 1999.

<sup>25</sup> Deklarata e Karla Del Ponte Prokurores për Tribunalin Ndërkombëtar për Krime Lufte Për Ish Jugosllavinë mbi Hetimet dhe Ndjekjen e Krimeve të kryera në Kosovë, Hagë, 29 Shtator 1999 në <http://www.icty.org>.

## **SEKSIONI 7: VEPRAT SEKSUALE**

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Femrave (KEDKF) formon një pjesë të ligjit të aplikueshëm në Kosovë përmes Rregullores 1999/24. KEDKF obligon UNMIK-un dhe të gjitha autoritetet publike të “ themelojnë mbrojtjen ligjore të të drejtave të femrave në bazë të barabartë me mashkujt dhe të sigurojnë përmes gjykatave vendore kompetente dhe institucioneve publike , mbrojtjen efektive të femrave kundër çdo akti të diskriminimit “. <sup>1</sup> Si plotësim, KEDKF kërkon nga UNMIK-u të ndërmarrë “të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, për modifikimin apo heqjen e e ligjit ekzistues, rregulloreve, zakoneve dhe praktikës e cila konstituon diskriminimin kundër femrave.”<sup>2</sup>

Preambula e *KB Deklarata mbi Eliminimin e Dhunës Kundër Femrave* pranon se:

“*dhuna kundër femrave* është manifestim i fuqisë historikisht të pabarabartë në relacionin mes mashkujve dhe femrave, e cila ka sjellë gjer tek dominimi mbi, dhe diskriminimi kundër, femrave nga mashkujt, dhe në preventimin e përparësive të plota të grave, dhe se dhuna kundër femrave është njëra ndër mekanizmat kryesor social me të cilat femrat janë shtyrë në pozitë të subordinuar në krahasim me mashkujt.”

Pajtueshmërisht, Neni 4(c) i *Deklaratës KB* vendos një obligim afirmativ në autoritetet qeveritare të “ushetrojnë *diligjencë të duhur* për preventimin, *hetimin* dhe, në pajtim me legjislacionin vendor, *dënimin e akteve të dhunës kundër femrave*, se këto akte a kryhen nga Shteti apo personi privat” (theksimet e shtuara). Ky obligim është posaqërisht I rëndësishëm kur viktima është e mitur, siq kërkohet prej autoriteteve publike sipas Nenit 36 të Konventës për të Drejtat e Fëmiut (KDF) për “*mbrojtjen e fëmijve kundër çdo...forme të eksploatimit, paragjykuar prej çdo aspekti të mirëqenjes së fëmiut.*”

Sipas LPP RFJ, kur femra ka raportuar se ajo ishte dhunuar apo sulmuar seksualisht, dhe “se ekzistojnë bazat për të dyshuar se vepra është kryer” autoritetet relevante janë të obliguara të hetojnë rastin dhe ti ndërmarrin të gjitha hapat për ruajtjen e provave në relacion me kryerjen e veprës.<sup>3</sup> Kur “ekzistojnë provat se vepra është kryer”, prokurori publik është I obliguar të ndërmarrë ndjekjen.<sup>4</sup> Autoritetet relevante janë nën detyrën e përgjithshme që në mënyrë të drejtë dhe të plotë të konstituojnë faktet relevante për ngritjen e vendimit të ligjshëm sa i përket rastit dhe, me vëmendje të njëjtë, të konstituojë faktet si, për ashtu edhe kundër, të akuzuarit.<sup>5</sup>

SMSL ka monitoruar rastet e zgjedhura, që kyqin dhunën kundër femrave, posaqërisht sulmin seksual, për vrojtimin e pikëpamjeve të policisë, prokurorisë, dhe gjyqësisë dhe trajtimin e viktimave si dhe identifikimin e qështjeve të veqanta apo brengosjeve që parashtrohen në këto raste.

## **I. Detyra për të Hetuar dhe Ndjekur**

LSMS ka identifikuar dy raste në të cilat kyqen femrat nga minoritetet, në regjionin e Pejës, në të cilën, sipas hetimeve policore, provat e mjaftueshme duhet të ekzistojnë për prokurorin publik dhe gjykatësin hetues për të inicuar hetimet lidhur me sulmin seksual të raportuar, por ku hetime të tilla nuk janë ndërmarrë. SMSL do të vazhdoj të monitoroj raportet lidhur me sulmet seksuale, që të determinoj se a ekzistojnë këto edhe në regjione tjera dhe, nëse po, a paraqiten ato në kontradiktë me obligimet e autoriteteve sipas LPP RFJ dhe standardeve ndërkombëtare për “hetimin“ dhe “dënimin e akteve të dhunës kundër femrave”.

Në një rast, një 60 vjeqare femër Rome Kosovare i raportoi policisë se fqinji i saj e ka sulmuar seksualisht më 24 Nëntor 1999. Ajo deklaronte se ai ka hyrë në shtëpinë e saj, e ka shtyrë në një dhomë, e ka zhveshur dhe ka tentuar që seksualisht ta sulmojë. Mëpastaj ka kërkuar nga ajo që ti paguaj 3,000-4,000 DM. Ajo ka raportuar ta ketë thirrë djalin e saj, që është jashtë, dhe ka thënë që të dërgojë të holla për tia shpëtuar jetën.

Viktima më tej raportoi, se me 28 Nëntor 1999, i njëjti mashkull u kthye në shtëpinë e saj me një shok të tij (i cili më vonë ishte identifikuar nga policia). Kur viktima mohoi tu hapte derën, ata thyen dritaren, hynë në shtëpi, e rrëzuan poshtë dhe e mbajtën nën shënjestër të revoles. Ajo raportoi se ata gjithashtu kan mbajtur edhe thikën në fytyrën e saj. Ata sërish kërkuar të holla. Ata vodhën disa stoli dhe telefonin mobil. Ajo raportoi se ishte shtyrë të iu ipte 3000 DM, në një datë të mëvonshme. Ditën e njëjtë, viktima i ka raportuar rastin KFOR-it.

Më 9 Prill 2000, viktima raportoi rastin sërish tek Policia e UNMIK-ut, duke u ankuar se KFOR-i nuk ka bërë asgjë përpos një orvatjeje për lokalizimin e të dyshuarit. Më tej ajo deklaroi se babai i të dyshuarit e ka kërcënuar për të mos raportuar rastin në polici. Më 10 Prill 2000, Policia e UNMIK-ut i raportoi rastin prokurorit publik. Prokurori publik inicioi hetimet për vjedhje, por siq raportohet refuzoi të ndërmerr hapa të mëtejshme sa i përket sulmit seksual të raportuar, duke i thënë SMSL se ka kaluar kohë e gjatë prej sulmit origjinal dhe se eskalimi i situatës mund të bie viktimën në rrezik të mëtejshëm. Prokurori publik i tha SMSL se i ka thënë policisë së UNMIK-ut që të tentojnë të zgjidhim qështjen e parave dhe ti tërhekin vërejtjen të dyshuarit. Si pasojë, pasoi njëfarë zgjedhje e qështjes së sendeve të vjedhura.

Rasti tjetër gjithashtu ndërlidh një grua të moshuar nga rradhët e minoriteteve, një 71 vjeqare Muslimane Boshnjake të Kosovës. Ajo i raportoi policisë se me 7 Maj 2000, tre mashkuj kan hyrë në shtëpinë e saj, e kan lidhur, dhe e kan dhunuar. Raporti mjekësor indikon se, menjëherë pas dhunimit, gruaja ishte ekzaminuar nga mjeku, dhe provat mjekësore, të cilat mund të mbështesin deklaratën e saj, ishin gjetur. Gruaja poashtu identifikoi dy prej kryesve të raportuar. Prokurori publik nuk e mohoi se dhunimi ka ndodhur, por sidoqoftë deklaroi se policia dështoi të hetoi mjaftueshëm rastin, dhe kërkoi informatat plotësuese para dhënjes së fletëarrestit edhe pse dukej të jetë dyshimi i bazuar se vepra është kryer, për kthimin e qështjes gjykatësit hetues siq kërkohet nga LPP RFJ. Me datën e këtij raporti, aq sa SMSL është i informuar, asnjë arrestim nuk është bërë.

Policia e UNMIK-ut ka informuar SMSL se një prej kryesve të raportuar ishte figurë eminente e UÇK-së.

## **II. Nevoja për Avokatë Gjyqësor, Shtëpi Sigurimi dhe Sigurim Gjyqësor për Viktimat e Dhunës Seksuale**

KDF kërkon nga autoritetet që të ndërmarrë të gjitha hapat për "mbrojtjen e fëmijve nga të gjitha format e dhunës mentale apo fizike, lëndime apo abuzim, pakujdesi apo trajtim të pakujdesshëm, keqtrajtim apo eksploatim, përfshirë edhe abuzimin seksual..."<sup>6</sup> Rastet vijuese ndërlidhin të miturit që kanë raportuar dhunimet apo aktet tjera të dhunës të dizajnuara si shtrëngim në marrëdhënje të dhunshme seksuale. Në këto raste, sjelljet e zyrtarëve gjyqësor dhe prokurorit ndaj viktimës shtrëngojnë brengosje lidhur me diskriminimin dhe vëjnë në pyetje veprimet tyre për ndjekjen e krimeve të tilla. LPP RFJ obligon gjykatat që viktimat e mitura, kur trajtohen si dëshmitarë, ta bëjnë këtë me kujdes të posaqëm gjatë zhvillimit të procedurave të tilla. Sipas LPP RFJ gjykata është e obliguar të ketë "kujdes... gjatë marrjes në pyetje të të miturit, posaqërisht nëse (ajo) ishte lënduar nga krimi, dhe vetëm atëherë kur marrja në pyetje nuk do të ketë efekt të dëmshëm në gjendjen mentale të të miturit. Nëse është e nevojshme, i mituri mund të mirret në pyetje me ndihmën e mësueses apo profesionalistit tjetër."<sup>7</sup> Si plotësim, gjykata mund të përjashtoj publikun prej marrjes në pyetje të dëshmitarëve të tillë për "mbrojtjen e interesave të të miturit" dhe /ose "për mbrojtjen e moralit".<sup>8</sup> Të dyjat, KNDCP dhe KEDNJ ngjashëm sigurojnë përjashtimin e publikut në raste të tilla dhe KDF siguron mbrojtje speciale për privatizmin e të miturit.<sup>9</sup>

Në rastet e përmendura, brengosjet lidhur me trajtimin e viktimave të raportuara nga gjykata kanë posaqërisht peshë në faktin se nuk ka patur avokat gjyqësor për përfaqësimin e interesave të viktimës. Edhe pse LPP RFJ parasheh për një rol aktiv për përfaqësimin ligjor të viktimës, shumica e viktimave të dhunës seksuale nuk duken të kenë mjete financiare apo përkrahje nga familja për të angazhuar avokat gjyqësor. Kjo është në kontrast me numrin e theksuar të rasteve të cilat nuk ndërlidhin raportimet për dhunë seksuale, të monitoruara nga SMSL, ku avokati i viktimës ka prezentuar dhe ka luajtur një rol aktiv në procedurë.

### **(a) Sjellja që Sygjeron Diskriminim Kundër Viktimave të Dhunës Seksuale**

#### **Prishtina**

Një mashkull ishte akuzuar në Prishtinë për, siq raportohet, dhunim të vajzës së vet kur ajo ishte 14 vjeqare. Ajo gjithashtu raportoi se ai tentoi të dhunonte sërish kur ajo ishte 15 vjeqare, gjë të cilën ajo e raportoi në polici. Në gjykim, nëna dhe motra e viktimës e shoqëruan në gjykatë, por ato u larguan nga gjykatorja gjatë dëshmimit të viktimës sepse ato ishin ftuar si dëshmitare. I vetmi anëtar i familjes i mbetur në gjykatore ishte babai i saj, i akuzuari. Nuk kishte avokat të viktimës prezent në gjykatore. I tërë gjykimi, përfshirë edhe deklaratën e viktimës, ishte e hapur për publikun.<sup>10</sup>

Viktima ishte dëgjuar përafërsisht dy orë, pa pushim. Ajo jepte deklaratën duke qëndruar 2 metra larg babait të saj. Ajo u thye dhe qante në një numër të pikave të dëshmisë së saj dhe dukej e shkatrruar dhe e thyer. Dukej se e kishte vështirë të qëndronte në këmbë.

Ajo dëshmoi se pas tentimit të dhunimit, ajo iku nga babai i saj dhe shkoi në shtëpinë e gjyshes së saj. Kryetari i kolegjit e pyeti viktimën “kur ke shkuar te gjyshja a e ke informuar babain tënd sepse sipas ligjeve (zakonore) Shqiptare është dashur ti tregosh babait?” Viktima iu përgjeggj “ Unë ika nga ai”. Kryetari i kolegjit e pyeste vazhdimisht viktimën lidhur për këtë pikë- se pse ajo nuk ka kërkuar lejen e babait para se të shkonte të gjyshja. Në një moment, viktima filloi ti tregonte gjykatësit se ajo çka ai thoshte nuk ishte e vërtetë, por gjykatësi e ndërpreu dhe i tha të mos fliste më. Pashpjegueshëm, kryetari i kolegjit e pyeste vajzën në një numër pyetjesh të bëra se “pse” babai e kishte dhunuar. Viktima përgjigjet “ Motrat e tij e dijnë për këtë por ato nuk thonë asgjë. Ato e dijnë se babai im e ka vendin në spital por ato nuk ndërmarrin asgjë.”

Njëri prej ekspertëve të mjekësisë që ishte prezent në gjykatore ishte lejuar nga kryetari i kolegjit ti bëjë asaj pyetje drejtpërdrejt lidhur me at se a e kishte rezistuar ajo babain e saj, dhe mbi gjendjen e saj gjinekologjike.

Gjatë pushimit të drekës, viktima ishte lënë në gjykatore, pa vëmendje të askujt, me të akuzuarin, babain e saj. Në përfundim të gjykimit, i akuzuari ishte liruar.

Pyetjet dhe komentet e kryetarit të kolegjit, toni i tij dhe qasja përballë viktimës në gjykatore, shtrojnë shumë brengosje serioze përkitazi me anshmërinë e tij para viktimës në këtë rast dhe cënon standardet vendore dhe ndërkombëtare në relacion me marrjen në pyetje të të miturit. Prokuri publik bëri shumë pak për preventimin e trajtimit të keq të viktimës. Asnjë sygjërim nuk është bërë për të përmbyllur procedurën për publikun gjatë dëshmimit të viktimës për mbrojtjen e privatizmit të saj. Ajo nuk kishte avokat prezent në gjykatore.

### **Mitrovica**

Në rastin e 7 të pandehurve të akuzuar për dhunim të të miturës, *Viktima M*, kryetari i kolegjit gjithashtu nuk kishte përjashtuar publikun nga dëgjimi i dëshmisë së viktimës. Viktima M që ishte 16 vjeqare respektivisht 15 në kohën e kryerjes së veprës, dëshmoi për rreth 3 orë në gjykatë të hapur me vëtem disa pushime të shkurtëra. Dëshmia e saj konsistonte në përshkrimin e rrahjes dhe marrëdhënjet e shumëfishta seksuale, të cilat, edhe pse pa pajtim, ajo nuk i luftoi për shkak të frikës. *Viktima M*, e cila qëndronte gjatë dëshmimit, ishte si dukej, shtatzanë prandaj kryetari i kolegjit e pyeti përkitazi me shtatzaninë. Viktima M deklaroi se shtatzania e saj ishte rezultat i martesës së shkurtër që përfundoi për shkak të raportimit të dhunimit.

Gjatë dëshmimit të saj të gjërësishëm, nga *Viktima M* kërkohej të qëndronte përafërsisht një metër e gjysmë larg nga 6 të akuzuarit në gjykim për dhunimin e saj. Marrja në pyetje e Viktimës M nga kryetari i kolegjit për 3 orë, ishte bërë në mënyrë të vrazhdë. Sjellja e kryetarit të kolegjit sygjëronte pandjeshmëri ndaj viktimës M dhe përmbajtjes së



deklaratës së saj dhe madje padurim, përkundër faktit se ajo ishte dëshmitar i mitur. Përkundrazi, kur njëri ndër të akuzuarit dëshmoi duke u referuar në impotencën e tij, gjykatësi shprehu një simpati të veçantë ndaj të akuzuarit dhe e siguroi se deklarata e tij do të jetë konfidenciale. Prokurori publik nuk intervenoi në emër të Viktimës M. Avokati i viktimës dhe as anëtarët e familjes së viktimës nuk ishin prezent në gjykim që ta përkrahnin.

Gjatë një pushimi në dëshmim, *Viktima M* dhe njëri ndër të akuzuarit filluan fjalosjen jashta gjykatores, përkundër faktit se gjykata ua tërhoqi vërejtjen të dy palëve që të mos inicojnë kontaktin njëri me tjetrin.<sup>11</sup>

Të akuzuarit u shpallën fajtorë. “Udhëheqësi” i të akuzuarve ishte dënuar më një vit e gjashtë muaj burgim. Të akuzuarit e tjerë ishin dënuar me nga një vit.

### **Prizren**

Në rastin e të *pandehurit M*, të akuzuar për Shtrëngim për Kontraktimin e Martesës<sup>12</sup> në relacion me sulmin dhe kidnapimin e një vajze 15 vjeqare, prokurori publik i Gjykatës Komunale dështoi të paraqitet në gjykim.

Me atë rast, viktima deklaroi se i akuzuari dhe dy shoqërues të tjerë e kan ndaluar automjetin e saj, e kan larguar dhunshëm vozitësin nga automjeti me kërcnime, e kan rrahur motrën e saj (gjithashtu udhëtare në automjet), dhunshëm e kan futur viktimën në automjetin tjetër dhe e kan marrë me vehte pa pëlqimin e saj apo pa njoftimin e familjes, për në Prishtinë. Ajo ishte mbajtur në Prishtinë për 3 ditë, gjatë së cilës kohë i akuzuari dhe familja e tij janë kërcnuar se do ta qojnë në Shqipëri nëse nuk pajtohet të martohet me të akuzuarin M. Më vonë ajo ishte liruar për të shkuar tek familja e saj, dhe ka parashtruar akuzë. Një ditë para gjykimit, policia e UNMIK-ut kërkoi nga SMSL të monitorojë gjykimin, duke pohuar se viktima ishte nën presionin e familjes së të pandehurit M, për hjekje dorë nga akuza.

Gjykimi ishte i mbyllur për publik. Prokurori publik nuk u paraqit dhe gjykimi u mbajt pa prezencën e tij. Babai i viktimës ishte prezent, por ajo nuk kishte avokat. Si pasojë e mungesës së prokurorit publik, detalet mbi llojin e forcës së përdorur kundër viktimës nuk ishin plotësisht të prezentuara. As viktima e as motra e saj nuk ishin marrur në pyetje lidhur me faktin se a e kishte përdorur ndonjëri prej të pandehurve armën gjatë kidnapimi, pa marrë parasysh se njëri prej të pandehurve kishte patur armë. Dëshmitari që ka mundur të vërtetojë dëshminë e viktimës –voztësi i automjetit –asnjëherë nuk është ftuar të dëshmoj. Në mungesën e prokurorit, viktima është pyetur se a dëshironte të ipte deklaratën përmbyllëse. Ajo deklaroi se e mbështeste aktakuzën. I pandehuri M ishte dënuar me 3 muaj burgim.

Pas gjykimit, prokurori publik i tregoi SMSL se ai nuk ishte paraqitur në gjykim për arsye se ishte i vetmi prokuror publik komunal për regjion përkatës dhe si i tillë fizikisht ishte i paaftë të udhëtoj në komuna të ndryshme për të përcjellur gjykimet.

Në rastin e të *pandehurit C*, i ngarkuar për tentim dhunimi të një vajze 15 vjeçare, kryetari i trupit gjykues e pyeti viktimën nëse dëshiron prezencën e babait të saj në sallën e gjykimit, që të mbes me të gjatë dëshmisë. Ajo tha “po”. Madje, kryetari i trupit gjykues, largoi babain nga vëzhgimi i gjykimit, e poashtu edhe publikun. Pasi që babai i saj braktisi dhomën e gjykatës, gjyqtari shpjegoi se ai dëshiroi që ajo të ndihet e lirë dhe të jetë plotësisht e besueshme me të. Kjo ishte përkundër faktit që Ligji i Procedurës Penale të Jugosllavisë siguron që gjersa publiku mund të përjashtohet nga gjykimi, kur i mituri është i involvuar, ky përjashtim “nuk përfshin edhe ..... palën e dëmtuar apo përfaqësuesit e tyre”. Viktima nuk kishte tjetër avokat.

Viktima më tej dëshmoi se gjatë tentimit të dhunimit, i pandehuri e rrahu atë dhe iu kanos se do ta vras atë. Në lidhje me këtë, prokurori publik argumentoi në fjalën përmbyllëse që, gjersa i pandehuri duhet të shpallet fajtor, ai nuk duhet të marrë dënim për arsye se ai me qëllim ka demonstruar “ndjenjat” e tij për viktimën, por nuk e ka përfunduar aktin. I pandehuri C ishte shpall fajtor dhe ishte dënuar me 3 muaj burgim.

## **b) Çështjet e kërcënimit të viktimës**

### **Prizren**

Më 26 Maj 2000, Viktima X, vajzë 16 vjeçare, raportoi tek KFOR – i se më 14 Shkurt 2000, i akuzuari e ka dhunuar në shtëpinë e tezes së tij. Ajo deklaroi se ai e ka ngrehur për flokësh, e ka grushtuar atë në kokë dhe abdomen, dhe ajo ka humbur vetëdijen. Kur u zgjua, ai e dhunoi atë dhe e djegu me cigare. Pas dhunimit, ajo shkoi në shtëpi, bëri dush, por i mbajti rrobat që i kishte veshur. Rrobat janë raportuar të kenë djegje cigaresh dhe njolla gjaku –për shkak të gjakderdhjes nga hunda.

Më 29 Maj 2000, gjyqtari hetues mori deklaratën preliminare nga i akuzuari, i cili nuk ndodhej në paraburgim. I akuzuari refuzoi të marrë avokatin dhe, në mes tjerash, theksoi se ai nuk ishte fajtor për dhunimin.

Një raport mjekësor shpreh se, viktima kaloi dozën e paraparë me pilula më 1 Qershor. Ajo ishte dërguar në spital dhe liruar më 5 Qershor 2000. Ditën e njëjtë, Viktima X dëshmoi para gjyqtarit hetues. Ajo shpjegoi dhunimin, në pajtueshmëri me deklaratën e dhënë tek KFOR-i. Ajo këshilloi gjyqtarin se, po të kishte KFOR-in, që ajo i kishte mbajtur teshat që i kishte veshur natën e dhunimit, do të vërtetonin thëniet e saj. Ajo u ankua se i akuzuari e kishte kërcënuar atë se do ta vriste atë dhe vëllanë e saj nëse ajo do të insistonte që ta vazhdonte ndjekjen. Ajo shpjegoi se ajo dëshiroi që të vazhdoj ndjekjen, por ishte e frikësuar, për arsye se nuk kishte përkrahje nga nëna e saj.

Më 16 Qershor, i akuzuari ishte pyetur përsëri nga gjyqtari hetues dhe vazhdoi që të vërtetoj pafajsinë. Ditën e njëjtë, *Viktima X* ishte pyetur përsëri dhe u ankua se i akuzuari i kishte thënë se nëse ajo nuk e tërheq deklaratën kundër tij, ai do ta dhunonte edhe më keq se sa herën e parë dhe do ta mbyste atë. Ajo tha se edhe nëse ai do të dërgohet në burgim, kur ai do të lirohet, do ta ndiqte dhe do ta dënonte atë, dhe se asnjëherë nuk do të mund që ti ikte atij. Ajo tha se nëna e saj është e frikësuar nga ai, dhe se ajo është duke e

këshilluar që të tërhiqet nga ndjekja. Ajo tha se një ditë më parë i akuzuari iu ka kercënuar asaj se do ta vriste dhe tha se do ta vriste gjyqtarin nëse ai do ta dërgonte në burg. Ajo theksoi se ajo do të dëshironte të ballafaqohej me të akuzuarin.

Ditën e njëjtë, 16 Qershor, 2000, i akuzuari ishte arrestuar dhe paraburgosur. Ai ishte ngarkuar për dhunim dhe për rrezikimin e sigurisë lidhur me kanosjen e gjyqtarit.

Raporti i KFOR-it thotë se dhjetë ditë më vonë, më 26 Qershor 2000, Viktima X arriti tek baza e KFOR-it në 23 : 15 ”në gjendje të keqe”. Rrobat e saj ishin të djegur në pjesë të ndryshme dhe ajo ishte mjaft e emocionuar. Ajo ishte kontrolluar nga mjeku i KFOR-it dhe ishte dërguar në spital. Raporti me tej thekson se vajza i kishte treguar KFOR-it italian se 3 persona e kidnapuan atë një ditë më parë. Ata persona e ndalën atë, e dërguan në fshat, e izoluan, e rrahën dhe e dogjën me cigare. Ata njerëz i thanë asaj se ajo ishte dashur që ta tërheq akuzën kundër të akuzuarit. Ajo ishte e liruar në ora 23:00 më 26 Qershor 2000, dhe menjëherë shkoi tek KFOR-i. Asaj i ishin prezentuar disa foto dhe ishte e aftë që të identifikoj dy nga personat të cilët e rrahën dhe e dogjën atë. Raporti medicinal i datës 27 Qershor 2000 paraqet lëndimet e viktimës në fytyrë dhe lëndimet e tjera. Ajo ishte dërguar në qendrën neuropsikiatrike dhe lirohet ditën vijuese. KFOR-i raporton se për arsye të sigurisë, ajo ishte vendosur në duart e një organizate humanitare.

Gjykimi ishte caktuar të fillonte më 18 Gusht 2000, dhe Viktima X ishte prezente. Gjykimi ishte shtyer deri më 25 Gusht 2000. Më 20 Gusht 2000, Viktima X braktisi mbrojtjen e shtëpisë së sigurt, pa e diskutuar këtë me stafin që ishte atje. Organizata jo qeveritare që i kishte siguruar asaj mbrojtjen për disa muaj, raportoi se ajo po mungonte. Më 24 Gusht 2000, viktimë arriti në OSBE – qendrën regjionale me policinë e UNMIK-ut, duke theksuar se ajo ishte kercënuar përsëri. Organizata humanitare që e kishte ndihmuar viktimën në të kaluarën, kishte marrë disa kërcënime dhe ishte e brengosur rreth dhënjes së banimit për viktimën. Policia e UNMIK e këshilloi OSBE-në se policia e UNMIK-ut do ta transportonte Viktimën X tek shtëpia e kusherirës së saj, me të cilën theksoi ajo, do të ndihet më e sigurt, dhe do ta dërgonte në gjykatë ditën tjetër.

Më 25 Gusht 2000, Viktima X nuk u paraqit në gjykim, dhe gjykimi u shtye deri më 1 Shtator 2000<sup>14</sup>. Atë mbrëmje, viktimë raportoi me telefon te organizata joqeveritare se ajo kishte tentuar të shkonte në gjykatë ( duke e refuzuar transportin e policisë), por kishte besuar se ishte nën përcjellje, dhe qëndroi në autobus derisa arriti KFOR-i italian. Përfaqësuesi i organizatës jo qeveritare raportoi se ai foli me vajzën, se vajza ishte e frikësuar, por dëshironte që të dëshmonte. Përfaqësuesi raportoi se vajza ishte nën ” kanosje të vazhduar” dhe vërtetoi se vajza kishte djegje në “ tërë trupin e saj”.

Më 1 Shtator 2000, SMSL u paraqit në gjykatën e qarkut që ta monitoroj gjykimin. Viktimë arriti në dhomën e gjykimit e shoqëruar me nënën e saj dhe *me vëllaun dhe motrën e të pandehurit*. Anëtarët tjerë të familjes së të pandehurit ishin jashtë dhomës së gjykimit, në korridor. Dy policë të UNMIK-ut dhe një oficer me KFOR-in italian ishin brenda në dhomën e gjykimit dhe e menjëherë e tërhoqën viktimën dhe pritën derisa ajo të ftohej që të dëshmonte.

Gjykimi ishte i mbyllur për publik. Gjatë gjykimit, Viktima X ishte mjaft e emocionuar. Kryetari i trupit gjykues e pyeti disa herë nëse ajo ndihej mirë që të vazhdoj, ajo ishte duke u sjellur në mënyrë të pakontrolluar; ishte përmbysur disa herë në karrigën e saj; shiqonte prapa krihëve të saj se kush ishte prezent në dhomën e gjykimit; kishte vështirësi gjatë të folurit, dhe e filloi rrëfimin e saj duke thënë se jeta e saj është shkatërruar. Ajo me tej pyeti për 5 minuta pushim dhe kjo iu lejua. Gjatë pushimit, SMSL e vëzhgoi viktimën e cila qëndronte ulur me policinë e UNMIK-ut dhe me avokatin e gjykatës në automjet, dhe shihej qartë se ishte mjaft e shqetësuar emocionalisht. Kur ajo u kthye në dhomën e gjykatës, ajo dëshmoi se ajo nuk kishte qenë e dhunuar dhe që edhe pse kishte qenë e rrahur nga tre persona, ata nuk i thanë asaj që ta tërhiqte akuzën kundër të akuzuarit.

Nuk kishte ndonjë përkrahje të vërtetë nga gjykata dhe nga prokurori publik në pyetjen se pse ajo e kishte ndryshuar pikat e ngjarjes. Rrobat që ajo thoshte se i kishte veshur natën e dhunimit- të cilat i dëshmoi gjatë hetimeve, tregojnë djegje nga cigaret dhe gjaku nga hunda e saj, dhe të cilat ajo tha se i kishte mbajtur- nuk ishin referuar nga prokurori gjatë gjykimit. Kolegji e tërhoqi aktakuzën. I pandehuri u lirua menjëherë nga paraburgimi.

## **Peja**

Rasti i të pandehurit R poashtu paraqet çështje të influencimit tek dëshmitarët/viktima. I pandehuri R, i cili ishte ish anëtar i UÇK, ishte i ngarkuar me dy pika të dhunimit dhe një pikë Akte jonatyrle seksuale me person nën moshën 14. Për secilin krim të raportuar, dënimi minimal është 3 vite.

Të tri viktimat (*Viktima A*, *Viktima B* dhe *Viktima C*- vajzë 14 vjeçare) janë Rome Kosovare. Në ditën e parë të gjykimit, më 21 Qershor 2000, *Viktima A* u paraqit që të dëshmoj por *Viktima B* dhe vajza e saj *Viktima C* nuk u paraqiten. *Viktima B* dhe *C* raportuan se ata tentuan që hyjnë në ndërtesën e gjykatës në një ditë tjetër të gjykimit të datës 30 Qershor 2000, që të japin dëshmitë e tyre, por hyrja e tyre ishte mohuar derisa gjykimi ishte përfunduar. Kryetari i trupit gjykues ishte informuar se ato ishin jashtë dhomës së gjykimit gjersa dëgjimet ishin duke u zhvilluar, por theksoi më vonë se ishte tepër vonë për ta që të dëshmojnë. Familja e viktimës *B* dhe *C* kërkuan që të flasin me kryetarin e trupit gjykues. Gjyqtari i takoi ata në zyrën e tij, hapi shkresat e lëndës, dhe mori dëshmitë e tyre, jashtë prezencës së të pandehurit dhe të avokatit. Sidoqoftë, anëtari i raportuar i UÇK –së ishte prezent gjatë dhënies së dëshmisë. *Viktima B* dëshmoi që ajo e kishte falur të pandehurin dhe “për hir të prindërve të tij, ai duhet të lirohet”.

I pandehuri ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me 4 vite e 6 muaj burgim. Ai ishte liruar në pritje të ankesës.

## **Gjilan**

Më 22 Qershor, është zhvilluar një gjykim kundër 5 Shqiptarëve Kosovar, të ngarkuar për dhunim. Në pajtim me aktakuzën, në natën e 4 Prillit 2000 dhe duke vazhduar në

mëngjesin e 5 Prillit 2000, 5 të pandehur e sollën viktimën në kafe, e morrën atë në dhomën e pasme, ku disa nga të pandehurit, siq raportohet, e kanë rrahur dhe ku disa e urdhërojnë që të zhvesh rrobat e saj. Njëri i thotë asaj “ mos qaj” ose do ta bësh me qejf ose me dhunë. Dy nga të pandehurit pastaj kryen marrdhënie seksuale në të.

Në deklaratën dhënë në polici i *pandehuri D*, të datës 5 Prill 2000, ai deklaroi se kishte qenë i informuar nga i *pandehuri T* se i *pandehuri T* do të sjell një vajzë në kafe dhe se planifikonte që ta dhunonte atje. Kur ajo arriti në kafe, i *pandehuri T*, siq raportohet, i tha të *pandehurit Z* “shko dhe dhunoje atë”. Deklarata e tij vazhdon më tej : kështu që i “*pandehuri Z*” hyri dhe filloi të bërtas në vajzën, ai ishte duke thënë, zhvishi rrobat, dhe ajo tha se me mund ta vrasin por nuk pranon që ti heq rrobat...Gjersa ajo bërtiste ( i *pandehuri T*) ishte duke e urdhëruar të (*pandehurin H*) që të hyjë, ta rraf dhe ta dhunoj atë”.

Viktima i tha policisë se fqiu i saj i kishte thënë asaj se, njëri nga të pandehurit e kishte kërcënuar që tja bënte të “njëjtën” vajzës së fqit, sikur ia kishte bërë viktimës. Disa ditë më vonë, viktima i kishte thënë policisë se babai i njërit nga të dyshuarit kishte kërkuar nga ajo që të tërhiqte akuzën e saj.

Në gjykim ( publiku ishte i përjashtuar), i *pandehuri D* dëshmoi- në papajtueshmëri me deklaratën e tij të mëparshme, duke deklaruar se kishte qenë i shtyrë nga policia e UNMIK-ut , që ta bënte deklaratën. Ai pranoi, sidoqoftë, se ka dhënë deklaratën e njëjtë që i kishte dhënë policisë, te gjyqtari hetues. Të pandehurit tjerë mohuan dhunimin apo sulmin. I *pandehuri T* dëshmoi se kishte patur më parë marrdhënie seksuale me viktimën.

Kur viktima u thirr që të dëshmonte, ajo deklaroi se dëshironte që tu kërkonte falje të 5 të pandehurve sepse ata ishin paraburgosur për “asgjë”. Ajo tha, me tej në gjykatë se “asgjë” nuk kishte ndodhur atë natë. Ajo thirrej në atë se kishte raportuar në polici ngase ishte e hidhëruar me të *pandehurin T* sepse ai e kishte lënë atë në rrugë në mbrëmjen e vonë. Ajo theksoi se ajo dhe i *pandehuri T* në të kaluarën, kishin pasur marrdhënie seksuale. Kjo ishte e papajtueshme me deklaratën dhënë në polici dhe me deklaratat e dhëna në gjykatë që ajo asnjëherë nuk kishte pasur marrdhënie seksuale me të *pandehurin T* para dhunimit.

Prokurori publik vazhdonte që ta përkrahte aktakuzën. Me kërkesë të prokurorit publik, kryetari i trupit gjykues e lexoi shkresën e viktimës dhënë para gjyqtarit hetues, e cila përputhej me të dhënat e parapara me aktakuzë. Të pesë të akuzuarit u liruan.

### III. Nevoja për Këshillim Adekuat/ Trajtim

Në rastin e të *pandehurit S*, i *pandehuri* pranoi se kishte pasur marrdhënie seksuale me viktimën, e mitur, por theksoi se ishte bërë me pëlqim. Viktima dëshmoi në gjykim se më 29 Qershor 2000, I *pandehuri* e kishin kërcënuar me vënie në shënjestër, duke e urdhëruar që të hyjë në veturë, duke i dhënë shuplaka fytyrës, shkukur flokët dhe duke e goditur me armë derisa ajo humbi vetëdijen. Kur ajo u zgjua, ata ishin duke vozitur dhe ajo i kishte pyetur se ku po e dërgonin, dhe ai i kishte thënë se “ kishte hapur mjaft gropa për gra”

atje. Ajo humbi vetëdijen përsëri. Viktima dëshmoi më tutje se i pandehuri e liroi atë dhe ajo eci vetëm në shtëpi. Kur nëna dhe motra e saj e kishin pyetur se çka kishte ndodhur, ajo humbi vetëdijen përsëri. Në atë çast, babai dhe vëllai e morën atë tek mjeku ku e humbi vetëdijen përsëri.

Gjatë dëshmisë, pasi që është pyetur nga avokati, viktima derdhi lot dhe ra në kollaps që dukej të ishte sulm. Gjykimi u suspendua; viktima nuk u sjell që të dëshmoi përsëri.

Në pajtim me raportin mjekësor në shkresat e lëndës, viktima ishte ekzaminuar të njëjtën ditë kur edhe ishte raportuar dhunimi. Raporti tregon se, gjatë kohës se ekzaminimeve, ajo kishte pasur një numër lëndimesh dhe në këtë drejtim, ishte duke vuajtur nga stresi post-traumatik dhe i duhej trajtimi i nevojshëm, të cilin nuk e kishte marrë<sup>15</sup>. Ajo nuk kishte avokat në dhomën e gjykimit. I pandehuri është gjetur fajtor dhe dënohet me 6 vjet burgim.

Nevoja e UNMIK-udhe i sistemit gjyqësor të Kosovës që të siguroj trajtim adekuat dhe këshillim shtrihet jo vetëm te viktimat e dhunës seksuale por poashtu edhe gratë e akuzuara të cilat llogariten në sistemin e drejtësis penale si rezultat i dhunës brenda-familjare. Edhe pse nuk është thellë i përfshirë në këtë raport, rastet e grave të akuzuara të ndriçuara në seksionet e mëparshme, si *Nazime Hamiti*, i ngrisin këto vërejtje. Rasti i *Kada Hazirit* sidoqoftë, siguron shembullin më serioz.

Më 31 Maj 2000, *Haziri*, 44 vjeç, ishte arrestuar për tentim vrasje të burrit të saj dhe u paraburgos në qendrën e burgut në Mitrovica/Mitrovicë. Në fillim të Qershorit 2000, komandanti i burgut informoi SMSL se ai besonte që *Haziri* i kishte shkaktuar vetes një rrezik serioz. Në burg, *Haziri* tentoi që të bëj vetëvrasje. Më 14 Gusht 2000, një raport për udhëheqësin regional për shëndetësi i UNMIK-ut konfirmoi një raport psikiatrik të KFOR-it që *Haziri* ishte në “ gjendje të psikozës” dhe se duhet të transferohet në spital psikiatrik. Edhe pse u bënë disa përpjekje, *Haziri* nuk ishte transferuar asnjëherë në spitalin e Prishtinës për kontroll. Gjatë intervistës me Komesarin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, *Haziri* raportoi se kishte qenë disa herë e rrahur nga buuri i saj. Më 18 Gusht 2000, oficeri administrativ i burgut informoi SMSL që shëndeti i *Hazirit* ishte keqësuar dhe se ajo do të duhej të dërgohej në një spital të posaqëm për sëmundje psikike, por meqenëse institucione të tilla nuk ekzistojnë në Kosovë, nuk ka vend tjetër për të përveç në qendrën e burgut. Më 22 Gusht 2000, gjyqtari hetues e liroi *Hazirin* nga qendra e burgut në mbikëqyrje familjare, dhe të burrit të saj. Tri ditë më vonë, *Kada Haziri* bëri vetëvrasje.

### **Rekomandimet e SMSL**

1. Raportimet e dhunës seksuale kundër femrave, posaqërisht rastet që ndërlidhin të miturit, të moshuarit, ose raportimet për dhunën seksuale brenda familjes, duhet shpejt dhe me dilijencë të hetohen. Ku ekzistojnë bazat e arsyeshme, këto raste duhet të ndjekën. Dështimi për tu hetuar në mënyrë dilijente dhe, ku është e

përshtatshme, për të bërë ndjekjen e rasteve të tilla, duhet të konsiderohet vepër disiplinore.

2. Një grup punues duhet të themelohet për të formuluar udhërrëfyesit për gjykatat përkitazi me trajtimin e viktimave në gjykatore, si dhe njoftimin përmes video lidhjeve apo ekranit.
3. Departamenti i Drejtësisë në koordinim me Policinë e UNMIK-ut duhet të zhvilloj programin për mbrojtjen e dëshmitarëve për të gjithë dëshmitarët vullnetar.
4. Duhet të konsiderohet vepër disiplinore për prokurorin mos prezencë në të gjitha gjykimet që janë në relacion me raportimet e dhunës seksuale, përfshirë tentativat për shtrëngimin me forcë të femrës për martesë.
5. Në bashkëpunim me OJQ-në e grave, UNMIK-u duhet të krijoj *Programin për Avokatët e Viktimave*, për sigurimin e ndihmës ligjore, psikologjike dhe sociale, për të gjitha viktimat e sulmit seksual.
6. UNMIK-u duhet të siguroj vendosje të sigurtë për çdo viktimë të dhunës seksuale apo familjare.
7. Së voni i konstituuar Instituti i Mjekësisë Ligjore duhet të krijoj, në lidhshmëri me policinë e UNMIK-ut, protokole për mbledhjen dhe ruajtjen e provave në rastet e dhunës seksuale.
8. Instituti Juridik i Kosovës duhet të siguroj trajnim të mëtejshëm për gjykatësa, prokuror publik, mbrojtës dhe organet zbatuese të ligjit për trajtimin e dhunës dhe marrjen në pyetje të viktimës/dëshmitarëve në rastet që ndërlidhin dhunën seksuale.

---

<sup>1</sup> Neni 2(c) KEDKF.

<sup>2</sup> Neni 2 (f) KEDKF.

<sup>3</sup> Nenet 148-151, LPP RFJ.

<sup>4</sup> Neni 18, LPP RFJ; shiko nenin 45(1), RFJ LPP, duke siguruar se “ndjekja e kryesve të krimeve është e drejtë themelore dhe detyrë themelore e prokurorit publik.”

<sup>5</sup> Neni 15(1)dhe (2) LPP RFJ.

<sup>6</sup> Neni 19(1) KDF.

<sup>7</sup> Neni 231 LPP RFJ.

<sup>8</sup> Neni 288 LPP RFJ.

<sup>9</sup> Shiko, për shembull, Nenin 16 KDF.

<sup>10</sup> Shiko, Nenin 288 LPP RFJ (I lejon gjykatësve që të përjashtojë publikun nga procedura për “mbrojtjen e interesave të të miturit.”)

<sup>11</sup> Për shkak të konfuzionit, ishte e paqartë se kontakti a ishte inicuar nga I akuzuari apo nga Viktima M, gjatë pushimit në procedurën gjyqësore.

<sup>12</sup> Shiko gjithashtu Nenin 16 (b) KEDKF, duke pranuar se femra ka “ të drejtë të zgjedhë bashkëshortin dhe të hyj në martesë vetëm me vullnetin e saj të lirë. “

<sup>14</sup> Gjatë rishqyrtimit të shkresave të lëndës SMSL ka vërejtur një letër të adresuar gjykatësit hetues nga një individ I cili kishte përdorur vetëm emrin, I cili deklaronte se, mes tjerash, se I pandehuri ishte I pafajshëm por se anëtarët e familjes së viktimës, po përpiqeshin të vrisnin.

<sup>15</sup> Neni 4 (g) I Deklaratës së KB siguron që “shtrirja maksimale në dritën e burimeve në dispozicion” shtetet duhet të themelojnë programe trajtimi dhe këshillimi për viktimat e dhunës seksuale.

## **PËRFUNDIMI**

Rastet e diskutuar në këtë raport ndriqojnë se në kërkim të themelimit të një sistemi gjyqësor funksional, të aftë për ndjekjen korrekte të rasteve serioze penale, ende ekzistojnë zbrazëtira në mes të kapaciteteve të kërkuara logjistike të gjykatave, eksperiencës dhe kompetencës së akterëve relevant gjyqësor, dhe realitetit në vend. Përderisa fokusi i vëmendjes ka qenë në trajtimin e minoriteteve në sistemin juridik, zbrazëtirat në sistemin ekzistues kanë influencuar mbi të gjithë individët, përfshirë viktimat dhe dëshmitarët.

Sa i përket ligjit të aplikueshëm, gjykatat kanë nevojë për udhërrëfyes të mëtejshëm përkitazi me mënyrën në të cilën të drejtat ndërkombëtare të njeriut mund të ndikojnë në procedurat penale, për garantimin e korrektësisë. Në kontekstin e arrestit dhe paraburgimit, është esenciale për organet zbatuese të ligjit dhe gjykatat të adoptojnë një qasje konsistente, posaqërisht përkitazi me paraburgimin, që është në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare dhe shënon natyrën përjashtimore të çfarëdo ndërhyrje me të drejtat e individit për liri. Kryesorja për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit është roli i mbrojtësit. Ky është një rol aktiv i cili aplikohet përgjatë tërë procedurës penale, dhe i cili kërkon mirëkuptim dhe lehtësira nga të gjithë akterët gjyqësor. Rastet që ndërlidhin krimet e luftës dhe ato etnikisht të motivuara kanë sjellur në fokus qështjen e anshmërisë, që ka nevojë për përpjekje më të mëdha për sigurimin e paanshmërisë. Ndjekja e raportimeve të dhunës seksuale ka ndriquar mungesën e lehtësirave për viktimat dhe dëshmitarët dhe mirëkuptimin në një pjesë gjykatash.

Një sistem gjyqësor efektiv dhe korrekt gjyqësor është fundamental për çdo shoqëri. Në kontekstin e Kosovës, kjo është e rëndësishë edhe më të madhe, në dritë të ekzistimit të klimës politike dhe sociale dhe natyrës vitale të sistemit të tillë për sukses të komponentave tjera të UNMIK-ut. Duke pasur parasysh faktin se nuk kishte sistem juridik në Kosovë menjëherë pas konfliktit, sistemi i tanishëm ka qenë i detyruar të përjetojë një evoluim të shpejtë dhe të ndërmarrë zhvillimin e një numri të madh të rasteve komplekse dhe serioze penale. Tani që sistemi juridik është konstituuar, burime adekuate dhe vëmendja duhet të përqëndrohet në mbushjen e zbrazëtirave, me dispozita për masa konkrete për sigurimin e korrektësisë së të gjitha procedurave.



### **SHKURTESAT**

OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
UNMIK	Kombet e Bashkuara Misioni në Kosovë
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SMSL	Sekcioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor
KB DPJ	Kombet e Bashkuara Departamenti i Punëve Juridike
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KNDCP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile
LPP RFJ	Ligji I Procedurës Penale të RFJ
LPK	Ligji Penal i Kosovës
SEGJ	Sistemi Emergjent Gjyqësor
KPK	Këshilli I Përbashkët Këshilldhënës
KKGJ	Komisioni Këshilldhënës Gjyqësor
NATO	Organizata Veri-Atlantike
COMKFOR	Komandiri i Forcave Nato të Kosovës
KFOR	Forcat e Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor I Kosovës
KEFDKF	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Femrave
KDF	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijut

## TABELA E PËRMBAJTJES

### Shkurtesat

<b>Përmbledhja Ekzekutive</b>	1
<b>Sekcioni 1: Monitorimi</b>	4
I. Mandati i Sekcionit të Monitorimit të Sistemit Ligjor	4
II. Relacioni me Shtyllat tjera	5
III. E drejta në Gjykim Korrekt	6
IV. Rastet Prioritare	7
V. Mbledhja e të Dhënave	7
VI. Raportimi i Sistemit të Monitorimit Ligjor	8
Vendimet e Rasteve në Gjykatat e Qarkut (1 Shkurt 2000-31 Korrik 2000)	9
<b>I. Sekcioni 2 : Sfondi</b>	11
Sistemi Emergjent Gjyqësor	11
Themelimi I Sistemit të Rregullt Gjyqësor	12
Gjykatat	13
<b>II. Sekcioni 3 : Ligji i Aplikueshëm</b>	15
I. Bazat e Ligjit të Aplikueshëm	15
II. Epërsia e Ligjeve	16
III. Aplikimi i Ligjeve për të Drejtat e Njeriut	16
IV. Aplikimi i Ligjit Ndaj të Gjitha Autoriteteve	19
V. Shembuj të Qasjes Inkonsistente të Ligjit nga Gjykatat e Qarkut	20
VI. Rekomandimet e SMSL	22
<b>III. Sekcioni 4 : Ndalesa e Arrestimit Arbitrar dhe Paraburgimit</b>	24
I. Paraburgimet Joligjore nga UNMIK-u dhe KFOR-i	24
II. E drejta për tu Sjellur Menjëherë Para Autoritetit Gjyqësor	26
III. Qasja Mbrojtësit Gjatë Paraburgimit dhe Informimi për të Drejtat	31
IV. Prezumimi i Pafajsisë dhe E drejta në Gjykim brenda kohës së arsyeshme apo Lirimi në Pritje të Gjykimit	32
V. Rekomandimet e SMSL	40
<b>IV. Sekcioni 5 : E Drejta në Mbrojtës</b>	45
I. Ligji Vendor	45
II. E drejta në Kohë Adekuate dhe Lehtësira për të Pregatitur Mbrojtjen	47
III. E Drejta në Përfaqësim Efektiv Ligjor	49

IV.	Trajnimi	54
V.	Rekomandimet e SMSL	55
<b>Sekcioni 6 : Krimet e Luftës Dhe ato Etnikisht të Motivuar:</b>		<b>58</b>
<b>Paanshmëria e Gjykatave</b>		
I.	Shtytja për Ekspedimin e Gjykatave	58
II.	E Drejta për një Gjykatë të Paanshme	58
III.	Aplikimi i Tanishëm: Dështimi në Testin Objektiv	60
IV.	Përpjekjet për të Siguruar të Drejtën për Gjykatë të Paanshme	69
V.	Gjykata për Krime Lufte Dhe Etnike e Kosovës	71
VI.	Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë	72
VII.	Rekomandimet e SMSL	75
<b>V.</b>	<b>Sekcioni 7 : Veprat Penale Seksuale</b>	<b>77</b>
I.	Detyra për Hetime dhe Ndjekje	78
II.	Nevoja për Avokatët Gjyqësor, Shtëpitë e Sigurta dhe Sigurimi Gjyqësor për Viktimat e Dhunës Seksuale	79
III.	Nevoja për Këshillim Adekuat/Trajtimi	85
IV.	Rekomandimet e SMSL	86
<b>VI.</b>	<b>Përfundimi</b>	<b>88</b>